

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 384 • Nëntor 2022



MJERIMI PËR DEVIJUESIT E SHPALLJES

KARRIERA E ISMAIL QEMAL BEJ VLORËS
NË SHTETIN OSMAN

"I GJALLË ME SHPIRT, PA DALË ME
LUFTUA NUK E LA!" - INTERVISTË

JASHARAJT

Atje ku takohen rrezet e diellit
Atje ku dielli gjithherë ndriçon
Atje ku atdhedashuria është parësore
Atje ku e ardhmja përkundej prore

Në Prekazin legjendar u përkund ardhmëria
Ademin dhe Hamzanë i udhëzonte Perëndia
Ngase ata çdo gjë ia falën atdheut
Edhe të jenë dëshmorë për lirinë e mëmëdheut

Pata fatin t'i takoj
Gjashtë net para se të binin dëshmorë
Sikur engjëj dukeshin, fytyrat iu shndrisnin nur
Në odën e madhe e bujare të bacës Shaban që
s'do ta harroj kurrë

Baca Shaban pinte kafe në ballë të oxhakut
Me plisin në kokë e mahramën e bardhë
Simboli i të qenit shqiptar dukej në atë shikim
burri
Sikur lëshonte kushtrimin e një qëndrese guri

Ademi i mbështetur afër dritares e fjalëpak
Në uniformë UÇK i shquhej, edhe në atë shikim
shqiponje
Rregullonte mjekrën, vështronte nga dritarja pa
pushim
Dëgjonte Babë Shabanin, e me kokë i bënte amin

Hamzai një burrë bujar
Gojëëmbël e krenar
Shkaun, thoshte, duhet larguar
Këto janë vatrat tonat, i kemi trashëguar

Nuk do të lëvizim nga shtëpia
Këmbëkryq e i vendosur na rrinte para
Do ta mbrojmë pragun e shtëpisë
Për t'i dhënë kuptim jetës dhe ardhmërisë

Si zakon që e ka shqiptari
Për të na përcjellë Hamzai doli i pari
Nga fabrika lart armiqtë, na tha, na vëzhgojnë
Por këtu kemi lindur, pa le të urdhërojnë

Këto ishin fjalët e Hamzait
Teksa u përshëndetem dhe u ndamë
Nga familja Jashari po dilnim, ku me gjak do t'
shkruhej historia
Në atë vatër të pastër ku kalitej ardhmëria

Ademi e Hamzai në uniforma ushtrie
Emblemë e UÇK-së, sa mirë u rri mbi krye
Shtonte edhe më dashurinë çdokush, ashtu po t'i
ketë parë
Kurrë s'do t'i harroj, për sa të jem gjallë

Naim Tërnavë
Qershor, 2001



EDITORIAL

- 4 Kthesat historike të shqiptarëve në dy shekujt e fundit

SHKENCË & FE

- 5 Komentimi i sures Muhamed – (8)
Sabri Bajgora
- 8 Kaptina Kehf dhe metodat e edukimit që burojnë prej saj (1)
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 11 Mjerimi për devijuesit e shpalljes
Jusuf ef. Zimeri



- 15 Kurani, burim themelor në drejtën islame
Xhuma Emin Abdul Aziz

- 18 Veprimet e urryera (mekruh) gjatë ngrënies
Dr. Ilmije Kuqi

- 21 Mjetet më të rëndësishme në predikimin e thirrjes
Prof. ass. dr. Rexhep Suma



- 24 Burrëria dhe besa e myslimanit
Isa Tershani

INTERVISTË

- 27 "I gjallë me shpirt, pa dalë me luftua nuk e la!"



HISTORI

- 30 Karriera e Ismail Qemal Bej Vlorës në shtetin osman...
Prof. ass. dr. Agron Islami



KULTURË

- 33 Alfabeti i gjuhës shqipe
Sevdie Arifi – Osmani
- 36 "BARDHËSITË E ATDHEUT"-
Gjeneral Rustem Berisha
- 38 Libri në qytetërimin islam
Haki Sahitaj

EDUKIM

- 41 E drejta për shkollim dhe shama
Mr. Lulzim Kastrati
- 45 Si të sillemi në rrjetet sociale?
Hfz. Mehas Alija
- 49 Fenomeni i bullizmit në mjediset shkollore në Kosovë
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi
- 52 Laiciteti i institucioneve publike arsimore
Mimoza Sinani



- 54 Kampionati Botëror "Qatar 2022"

AKTIVITETE

- 56 Myftiu Tërnava i ftuar nga presidenti Begaj për Festën e Flamurit



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 384 • viti 36 • nëntor 2022
• Xhumadel Ula 1444
• çmimi 1 €

Boton:
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnava,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: dituriaislame@hotmail.com
dituriaislame@yahoo.com
www.bislame.net
Shtypi:
Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë



*“Ndërsa për
dhuntitë
e Zotit tënd,
ti (vazhdimisht)
shprehu e fol.”*

(Ed Duha, 11).

Kthesat historike të shqiptarëve në dy shekujt e fundit

Ende pa u mbushur një shekull nga lindja e shtetit të parë shqiptar, përcaktimet hyjnore të Zotit Fuqplotë, kishin fshehur për kombin tonë sihariqin e lindjes së dytë, po aq të vështirë sa edhe e para - mëvetësinë e shtetit të Kosovës. Dy shtete shqiptare të formuara në truallin e kthesave historike, për këdo ishin thjesht një ëndërr, e cila nuk imagjinohej se një ditë do të mund të bëhej realitet.

Dy fillimshekujt e fundit, ishin ata që nuk na lanë të pllakosur në pengun tragjik të historisë sonë. Si njëra prej epokave më jetike të historisë sonë, ky shekull solli në jetë për ne dy dhurata gjatë kohë të aspiruara. Dy shtete shqiptare janë dhe do të mbesin “kapitali” më me vlerë që gëzojnë sot shqiptarët, ndonëse të tkurrura nga tabloja ideale që ndoshta nga të gjithë ne ishte aspiruar.

Është anakronike, veçse, shumë popuj evropianë, tash e sa dekada flasin për të drejtat e njeriut dhe lirinë në formatin e përsosur të tyre, ndërkaq ne shqiptarët deri në fund të shekullit të kaluar u desh të flasim për lirinë në trajtën e saj më tragjike, e në kuptimin e saj më parimor - lirinë nga robëria. Edhe kur të tjerët flisnin për të drejtat më “luksoze” ne ende flisnim për të drejtën më themelore humane, atë të ekzistencës. Kjo, nëse nuk ishte një stigmë që njolloste padrejtësisht faqen e historisë sonë, doemos ishte një fakt i hidhur që nga ne duhej pranuar.

E më së paku, çfarë na duhet është se kur ne kalojmë nëpër muajt e datat e shënuara historike (nëntorët tanë të lavdishëm), e të cilat na rrëfejnë përpjekjen dhe kurorëzimin e popullit tonë me liri e pavarësi, është që ne t'i flasim me pietet vetvetes dhe brezit që po rritet, për këto arritje. Kjo, sepse disi është një garancë, që na siguron se atë që e fituam me vetëmohim të pashembullt në histori do ta ruajmë e do ta përjetësojmë për të gjithë brezat e rinj.

S'do mend se për një rikëndellje dhe rikujtim të këtyre begative edhe Zoti i Madhërishëm na porositi në një citat kuranor e na tha: “Ndërsa për dhuntitë e Zotit tënd, ti (vazhdimisht) shprehu e fol.” (Ed Duha, 11). Mbase liria, është ajo dhuntia madhore e Zotit, çmimin e së cilës ne edhe e dimë se sa shtrenjtë e kemi paguar.

T'iu rrëfejme atyre që fatmirësisht nuk përjetuan asgjë nga mynxyra e sakrificat e epokave të vështira, se plejada e patriotëve e atdhedashësve të denjë që vunë themelet e shtetit shqiptar, janë njerëz që emrat e tyre nuk janë gjendur në memoaret e lavdishme të atdheut aksidentalisht. Ata e deshën tokën dhe truallin tonë më shumë se jetën e gjakun e tyre.

Megjithatë, përpjekja për të mirën e atdheut, nuk është thjesht një manifest politik me afat të shkurtë skadence, apo moto, vlera e së cilës na u zhbëka ditën që e kemi nxjerrë jashtë pinjollin e fundit të pushtuesit nga toka jonë. Ajo, për më tepër është një mision jetik që mban gjallë fibrën e rezistencës dhe forcon sa s'bën më shumë, gatishmërinë për të tretur aspiratat e kujtdo që synon të kthejë thundrën e pushtimit mbi truallin tonë.

Dikur, ta duash atdheun ka nënkuptuar që të jesh i gatshëm që flijohesh që ai të mbijetojë, të sakrifkohet që ai të triumfojë. E sot, ta duash atdheun do të thotë që të derdhësh djersën e fundit për avancimin e tij, të mos tundohesh nga lakmia e shturur njerëzore për të përvetësuar padrejtësisht diç nga asetet e tij. E mbi të gjitha, atdhedashuri është edhe të zgjedhësh të jetosh në gjirin e tij, e të mos e braktisësh edhe atëherë kur mërgimi të premton parajsën dhe të shtrenjtën lumturi.

Mesazhe të tilla, do të përçonin edhe idealistët e atdhetarët tanë të shquar ani pse ata jetuan në epoka të ngrysurat historike. I tillë ishte, Hafiz Ali Korqa që na kujtonte se: “Vullneti i përbashkët i vazhdueshëm, bashkimi vëllazëror, ideali i vërtetë kombëtar, në pak kohë shtetin e bënë lulishte diturie e trëndafilishtë qytetërimi.”

Shtetin e bëjmë lulishte diturie, më së paku duke mos e braktisur atë, e në fund edhe duke lënë lëkurën e eshtrat në dheun dhe truallin e tij.

Mr. Driton Arifi

Komentimi i sures Muhamed – (8)

SPROVAT E BESIMDREJTËVE DHE MJERIMI I JOBESIMTARËVE

Sabri Bajgora

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ حَتَّىٰ نَعْلَمَ الْمُجَاهِدِينَ مِنْكُمْ وَالصَّابِرِينَ وَنَبْلُوَ أَخْبَارَكُمْ ﴿١٣﴾
إِنَّ الدِّينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَشَاقُّوا الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ
لَهُمُ الْهُدَىٰ لَنْ يَضُرُّوا اللَّهَ شَيْئًا وَسَيُحِطُّ أَعْمَالُهُمْ ﴿٢٣﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ
آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَلَا تُبْطِلُوا أَعْمَالَكُمْ ﴿٣٣﴾ إِنَّ الدِّينَ
كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ثُمَّ مَاتُوا وَهُمْ كُفَّارٌ فَلَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَهُمْ ﴿٤٣﴾

“Ne do t’ju vëmë në provë derisa t’i njohim ndër ju, luftëtarët (muxhahidët) dhe të qëndrueshmit, dhe derisa t’i vërtetojmë të bëmat tuaja. Ata që nuk besojnë, që pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe që kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është bërë i qartë udhëzimi i vërtetë, ata nuk mund ta dëmtojnë aspak Allahun. Ai do t’i zhvlerësojë veprat e tyre. O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit, e mos i çoni dëm veprat tuaja! Pa dyshim, ata që nuk besojnë, dhe pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut pastaj vdesin si jobesimtarë, Allahu nuk do t’i falë kurrë”. (Muhamed, 31-34)

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT TË 33-TË

Transmetojnë Ibn Ebi Hatimi dhe Muhamed bin Nasr el Mervezij, nga Ebul Alijeh të ketë thënë: As’habët e Resulullahut s.a.v.s. ishin të bindur se një mëkat nuk e dëmton dëshminë: “La ilahe il-la Allah”, ashtu siç mendonin se nuk ka vlerë as vepra e mirë, kur njeriu bën shirk.

E pasi që kur zbriti ky ajet “O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit, e mos i çoni dëm veprat tuaja!”, ata filluan të frikësoheshin që mëkatet të mos ua zhvlerësonin (dëmtonin) veprat e tyre.¹

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT TË 34-TË

- Imam Hazini thotë se ky ajet: “Pa dyshim, ata që nuk besojnë, dhe pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut pastaj vdesin si jobesimtarë, Allahu nuk do t’i falë kurrë”, ka zbritur për parinë e kufrit të varrosur në gropën e Bedrit në krye me Ebu Xhehlin, të cilët kishin mbetur të vrarë në betejën e njohur të Bedrit, e pastaj ishin hedhur në një gropë të madhe në atë vend.²

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, shihen qartë tendencat armiqësore të mynafikëve, të cilët tashmë kishin lidhur një aleancë të fshehtë edhe me jobesimtarët nga radhët e Ehli Kitabit (hebrenjtë), prandaj i Madhërishmi ia tregon qartë mynafikët të Dërguarit a.s., duke ia dëftuar mënyrën e njohjes së tyre, madje edhe nga zëri, për ta përfunduar me një mesazh shumë domethënës: “Allahu i di mirë veprat tuaja”. Kjo pjesë e ajetit i përfshin të gjitha krijesat, dhe nënkupton se të Lartmadhërishmit nuk mund t’i fshihet asnjë vepër e krijesave, dhe ndërlidhet fuqishëm me ajetet në vazhdim, ku tash Allahu xh.sh. iu drejtohet besimtarëve me njoftimin se do të sprovohen në këtë botë, derisa të dallohen qartë ata me besim të pastër e të paluhatshëm në Allahun Fuqiplotë, e njëkohësisht duke ua bërë me dije jobesimtarëve të cilët pengojnë nga rruga e Allahut dhe, vdesin si jobesimtarë, veprat e tyre do t’u asgjësohen dhe do të jenë banorë të Xhehenemit.

KOMENT:

31. Ne do t'ju vëmë në provë derisa t'i njohim ndër ju, luftëtarët (muxhahidët) dhe të qëndrueshmit, dhe derisa t'i vërtetojmë të bëmat tuaja...

Nëpërmjet këtij ajeti, Allahu i Gjithëpushtetshëm proklamon programin jetësor që duhet ndjekur besimtari gjatë jetës në këtë botë, sidomos nga aspekti i obligimeve shariatike, duke ia bërë me dije krijesës njerëzore se kjo dynja është vend i sprovave të mëdha. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartmadhërishëm na ka dhënë shenjë edhe në shumë ajete të tjera kuranore, sepse vetëm nëpërmjet sprovave, do të dallohen njerëzit që besimin e kanë vërtet të sinkertë, nga ata që e kanë sa për sy e faqe. Prandaj, edhe ky ajet kuranor, synon të shpërfaq besimtarët e vërtetë, të cilët zbatojnë urdhrat e Allahut në çdo sferë të jetës, e ndër to edhe luftën në rrugën e Allahut, e cila nuk nënkupton doemos vetëm luftën në kuptimin klasik të fjalës, por luftën me nefsën, me egot, me epshin etj. Vetëm kështu do të dallohen besimdrejtët dhe durimtarët nga mynafikët, të cilët iu bishtnojnë detyrimeve fetare sapo t'u jepet mundësia, duke i shkaktuar dëme shoqërisë islame por edhe kauzës së besimit në përgjithësi.

Pjesa e fundit e ajetit, “dhe derisa t'i vërtetojmë të bëmat tuaja”, nënkupton se Allahu Fuqiplotë do t'ia shfaqë secilit njeri veprat që ai i bën, qofshin ato të mira apo të këqija, në mënyrë që të dihet e të shihet puna e tij dhe që secili ta shohë veten se ku është në raport me Krijuesin e tij.

Në lidhje me këtë sprovim të shfaqjes së veprave nga ana e të Lartmadhërishmit, Ibrahim ibn Esh'ath ka thënë: “Kur Fudajl ibn Ajadi e lexonte këtë ajet, qante dhe thoshte: “O Allah, mos na sprovo, sepse po na sprovove, do të na dalin në shesh të këqijat tona, dhe do të na grisët perdja e mbulesës Sate.”³

32. Ata që nuk besojnë, që pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe që kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është bërë i qartë udhëzimi i vërtetë, ata nuk mund ta dëmtojnë aspak Allahun. Ai do t'i zhvlerësojë veprat e tyre.

Në këtë ajet, shohim një kërcënim të hapët nga ana e të Plotfuqishmit ndaj jobesimtarëve, në këtë rast ndaj hebrenjve të Medinës, përkatësisht pjesëtarëve të dy fiseve të tyre, Benu

Katadeja r.a. ka thënë: “Allahu e mëshiroftë atë rob që nuk e shkatërron veprën e tij të mirë me ndonjë punë të keqe”


Kurejdha dhe Benu Nadiir,⁴ të cilët përveçqë mohuan Njeshmërinë e Allahut, u pozicionuan haptazi kundër fesë dhe rrugës së drejtë, duke i penguar njerëzit me metoda të ndryshme, vetëm e vetëm t'i prapësojnë ata nga drita e Islamit. Ata mbanin një qëndrim armiqësor ndaj të Dërguarit të Allahut, i cili po i ftonte në besimin e pastër, larg besimit të kotë e të devijuar të tyre. Kjo armiqësi e tyre ishte shkak i inatit dhe i ngurtësisë së zemrave të tyre. Ata, si pjesëtarë të Ehli Kitabit, kishin njohuri se ishte afruar ardhja e Profetit të fundit, i kishin dëgjuar fjalët e Pejgamberit a.s., kishin qenë dëshmitarët të mrekullive të tij, por prapëseprapë, në zemrat e tyre të ndryshkura me kufër, nuk po arrinte të depërtonte drita e besimit. Me gjithë këtë vrazhdësi të tyre që po e

shfaqnin haptazi dhe kudo, megjithatë ata nuk mund ta dëmtojnë Allahun aspak, sepse Ai është i Larti, Madhështori dhe i Gjithëpushtetshmi. Në Dorën e Tij është çdo gjë. Ai mban rregullin e kësaj gjithësie dhe para Tij do të bëhet Llogaria e fundit. Jobesimtarët, në këtë rast hebrenjtë e Medinës, me këto veprime të tyre armiqësore, shkaktuan hidhërimin e Allahut ndaj tyre, e Ai, do t'ua zhvlerësojë çdo vepër të tyre të mirë që e kanë punuar në këtë botë. Në Mizanin e Allahut, atyre nuk do t'u peshohet asnjë vepër e mirë, por Libri i tyre pas një gjykimi të drejtë hyjnor do të mbyllet me verdiktin final, me destinacionin e fundit - zjarrin e Xhehenemit.

33. O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit, e mos i çoni dëm veprat tuaja!

Në ajetin paraprak, pamë se jobesimtarëve do t'u zhvlerësohen veprat, tash i Lartmadhërishmi, iu drejtohet besimtarëve, të cilët e besuan Allahun, të Dërguarin dhe Ditën e Gjykimit, që t'i bindeshin Allahut dhe të Dërguarit të Tij, duke i respektuar urdhrat hyjnorë, në mënyrë që të mos u zhvlerësoheshin edhe atyre veprat, nga ndonjë vepër e shëmtuara siç janë mëkatet e mëdha, syfaqësia, mendjemadhësia dhe veprimet e tjera të këqija që të shtyjnë drejt greminave të mëkatimit.⁵

Siç pamë nga shkaku i zbritjes, as'habët e Resulullahut s.a.v.s. ishin të bindur se kur njeriu thotë “La ilahe il-la Allah”, këtë dëshmi imanore nuk e dëmton ndonjë mëkat, ashtu siç mendonin se nuk ka vlerë as ndonjë vepër e mirë, kur njeriu bën shirk – d.t.th. është idhujtar. Por pasi që zbriti ky ajet,



besimtarët filluan të kishin frikë që të mos binin në ndonjë mëkat të madh, që do t'ua zhvlerësonte punët e tyre të mira.

Transmetohet nga Katadeja r.a. të ketë thënë: “Allahu e mëshiroftë atë rob që nuk e shkatërron veprën e tij të mirë me ndonjë punë të keqe”, ndërsa nga Ibn Abasi është transmetuar të ketë thënë: “Mos i shkatërroni (asgjësoni) veprat tuaja të mira me syfaqësi, mendjemadhësi, dyshim a hipokrizi.”⁶

34. Pa dyshim, ata që nuk besojnë, dhe pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut pastaj vdesin si jobesimtarë, Allahu nuk do t'i falë kurrë.”

Ashtu siç pamë edhe nga shkaku i zbritjes, ky ajet ka zbritur për jobesimtarët e vrarë në luftën e Bedrit, e në krye të tyre, Ebu Xhehli. Këta idhujtarë-jobesimtarë jo vetëm që nuk e pranuan dritën e udhëzimit, por përveç kësaj, edhe i penguan edhe të tjerët që të përudheshin në rrugën e së vërtetës, prandaj, atyre që vdiqën në kufër, pa u penduar, Allahu nuk do t'ua falë kurrë.⁷ Dispozita e këtij ajeti është e përgjithshme për krejt jobesimtarët, në çdo vend dhe kohë. Ndëshkimi i tyre do të jetë i tmerrshëm. Dita e Gjykimit do të jetë dita kur

ata do të përballen me drejtësinë hyjnore, dhe do ta shijojnë dënimin e merituar.

I Gjithëmëshirshmi, ka treguar qartë në Kuranin fisnik, se Allahu i fal të gjitha gjynahet përveç shirkut: “Vërtet, Allahu nuk e fal (gjynahun) që të adhurohet dikush tjetër veç Tij, ndërsa gjynahet e tjera ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të madh.” - (En-Nisaë, 48).

Nga kjo shihet se mohimi i Allahut apo adhurimi i dikujt tjetër në vend të Tij, i mbyll të gjitha dyert për jobesimtarët. Për ta nuk do të ketë mëshirë e as dhembshuri. Skëterra do të jetë vendqëndrim i tyre i përjetshëm.

POROSIA E AJETEVE (31-34)

- Besimdrejtët, Allahu xh.sh. do t'i vë në sprovë në këtë botë, derisa të dallohen luftëtarët në rrugën e Allahut. E këtë mirësi, mund ta arrijnë vetëm ata që janë të qëndrueshëm dhe durimtar në prova.

- Jobesimtarët e të gjitha ngjyimeve ideologjike, përkundër mllëfit që mbajnë në zemra ndaj besimtarëve, do të jenë të humbur. Allahu do t'ua zhvlerësojë edhe ndonjë vepër të mirë që e kanë bërë në këtë botë, në mënyrë që dënim i zjarrit të jetë meritë për ta. Kufri apo mosbesimi i tyre, në asnjë mënyrë nuk mund ta dëmtojë Allahun, sepse Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe po ashtu Mbikëqyrësi i kësaj ekzistence.

- Bindja dhe nënshtrimi ndaj urdhrave të Allahut dhe respektimi i porosive të Pejgamberit a.s., është cilësia që i veçon besimtarët nga të tjerët. Këta, duke iu bindur Krijuesit të tyre dhe duke pasuar Pejgamberin a.s., e ndjejnë në zemër e në shpirt kënaqësinë dhe ëmbëlsinë e besimit-imanit. E vetmja brengë e tyre është që Allahu dhe i Dërguari i Tij, të jenë të kënaqur ndaj tyre, dhe që të ruhen nga rënia në mëkate të mëdha, qoftë edhe nga mosdija, të cilat pastaj mund t'ua dëmtojnë veprat e tyre të mira.

- Ata njerëz që vdesin si jobesimtarë, duke mohuar Allahun si krijues të tyre, për ta nuk ka falje e as mëshirë. Ata do të jenë përjetësisht banorë të Zjarrit, sepse dera e pendimit sa ishin në këtë botë, ka qenë gjithmonë e hapur për ta.

- vijon -

1 Imam Sujuti, *Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli*, ff. 234-235.

2 Hazini, *Lubabu-t-te'vil fi meani-t-tenzil*, Bejrut, 2004, vëll. 4, f. 150.

3 *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 26, f. 450.

4 Ibn Adil ed-Dimeshkij el-Hanbelij, *El-Lubab fi ulumi-l Kitab*, Bejrut, 1998, vëll. 17, f. 68.

5 Shih më gjerësisht: Ebu Bekr el-Xhezairij, *Ejserut-t-tefasir li kelami-l Alijji-l Kebir*, Medinë, 1997, vëll. 5, ff. 90-91.

6 *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 26, f. 456.

7 Mufti Mahmud bin Muhamed Nesib el Hamzavi el Hanefij, *Durru-l esrar fi tefsiri-l Kurani bil hurufi-l muhmeleti*, Bejrut, 2011, vëll. II, f. 409.

Kaptina Kehf dhe metodat e edukimit që burojnë prej saj (1)

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Në transmetimet në lidhje me shkakun e shpalljes së kësaj sureje, përmendet se jehudët u kërkuar politeistëve që t'i bënin pyetje të Dërguarit a.s. për tri çështje: shpirtin, "As'habul Kehf" (banuesit e shpellës) dhe Dhul-Karnejnin.

Kaptina Kehf, me karakteristikat e sureve mekase, e përbërë nga 110 ajete, ngërthen në vetveten e saj tematika të larmishme nga të cilat mund të nxirren mësimet të vlefshme. Padyshim, ndër tematikat më të rëndësishme dhe që vihet në pah pothuajse në çdo pjesë të kaptinës, është çështja e besimit, me theks të veçantë, besimin në botën e ardhshme (Ahiretin), parime në lidhje me profetësinë, përshkrimi i tri tregimeve të bukura të Kuranit, përmes së cilave paraqitet fuqia e pakufishme e Zotit të Madhëruar. Po ashtu, kjo kaptinë vë në pah natyrën e jetës së kësaj bote duke e përshkruar si të shkurtër e kalimtare, pra një ditë do të marrë fund. Një nga mesazhet kryesore që jepet në këtë kaptinë është edhe rëndësia e modestisë. Në shumë vargje theksohet se si mendjemadhësia i çon njerëzit në zhgënjim dhe duke dhënë shembuj theksohet se mendjemadhësia është cilësi shkatërruese e individit dhe shoqërisë. Pra kaptina Kehf, me gjithë këto tematika të larmishme në aspektin edukativ, ofron mjaft mësimet dhe këshilla të dobishme.

Ajo hedh dritë mbi shumë çështje që lidhen me edukimin, si metodat që duhen ndjekur në edukim, mendjen, shpirtin dhe zemrën e edukimit.

LIDHSHMËRIA E KËSAJ KAPTINË ME KAPTINAT E TJERA

Kaptina Kehf, e cila në renditjen kuranore zë vendin e nëntëmbëdhjetë, është një prej atyre pesë kaptinave të Kuranit, që fillojnë me "Elhamdulillah...", e që janë: Fatiha, En'am, Sebe, Fatir, dhe kjo paraqet lidhshmërinë që kjo sure përmban me kaptinat në fjalë.

Secila nga tri kaptinat, të cilat pasojnë njëra-tjetrën, tregon për ndodhitë e situatave interesante që rrallë shihen në këtë botë. Kaptina e cila në Kuran zë vend para kaptinës Kehf, parashtrohet mrekullinë e Israsë - udhëtimit të Muhamedit a.s., me ndihmën e Zotit prej Mekës në Jerusalem dhe kjo brenda një pjese të kohës së natës. Ndërsa kaptina Kehf, në tregimin e parë flet për "as'habul kehfi", për banorët e shpellës, të cilët flijuan jetën për hir të besimit të drejtë. Kaptina Merjem, e cila gjendet në vijim, parashtrohet çështjen e Merjemes virgjëreshë, e cila e lindi djalin, Isain, pa baba, e kjo është një ngjarje edhe më e çuditshme. Prandaj, është mjaft domethënëse që të gjitha këto gjendje të mrekullueshme të përmenden në këto tri sure që pasojnë njëra-tjetrën.¹

Kaptina Kehf ashtu si kaptina Isra, thekson rëndësinë e Kuranit dhe tërheq vëmendjen për lavdinë e tij. Kaptina Isra



fillon me: “Pa të meta është Lartmadhëria e Atij...”² lartësimin e Zotit xh.sh., ndërsa kjo fillon me shprehjen: “E tërë lavdia i takon vetëm Allahut...”³, e cila nënkupton lavdërimin e Zotit ndaj vetes së Tij të Madhëruar. Lartësimi dhe lavdërimi (hamdi), nga ana tjetër, shfaqen së bashku (në vazhdimësi), si në Kuran ashtu edhe në hadithe të Pejgamberit a.s., në të cilat lartësimi vjen gjithmonë para hamdit. F.v. në kaptinën Hixhr thuhet: “Andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar”⁴, ndërsa në hadithe të shumta përmendet: هلل الحمد و هلا سبحان. E gjithë kjo për të tërhequr vëmendjen për faktin se lartësimi është fillimi dhe lavdërimi (hamdi) është rezultati, fillimisht vjen tesbih dhe më pas tahmid. Kaptina Isra përfundon me lavdërim dhe me ajetin që dëshmon për Zotin Një, të pa fëmijë dhe të pashoq, të panevojshëm për asgjë, Fuqiplotë dhe të Pavarur. Po ashtu, kaptina Kehf fillon duke përsëritur të njëjtën të vërtetë. Kështu, ekziston një harmoni unike midis fillimeve të dy kaptinave, fundit të kaptinës Isra, që paraqet faktin për Zotin Një, të pa fëmijë dhe të pashoq dhe lartësimin e Tij dhe fillimit të kaptinës Kehf, e cila gjithashtu dokumenton për Zotin Një dha lavdërimin që i takon Atij.⁵ Në transmetimet në lidhje me shkakun e shpalljes së kësaj sureje, përmendet se jehudët u kërkuan politeistëve që t’i bënin pyetje të Dërguarit a.s. për tri çështje: Shpirtin, As’habul Kehf (banorët e shpellës) dhe Dhul-Karnejin. Përgjigja për të parën prej tyre jepet në fund të kaptinës Isra. Kurse, përgjigjet e dy pyetjeve të tjera janë dhënë në këtë kaptinë. Në këtë këndvështrim, është mjaft e përshtatshme të jenë këto kaptina të renditura njëra pas tjetrës. Ibën Ashuri kur flet për lidhshmërinë mes këtyre dy kaptinave në aspektin e shkakut të zbritjes, shprehet se është më së e përshtatshme që përgjigja

për shpirtin të vijë paralelisht në kaptinën Isra, ngase pyetja për shpirtin i referohet dijes së Zoti xh.sh. dhe nuk është dhënë një përgjigje e detajuar. Për shkak se ka një ngjashmëri mes shpirtit dhe Israsë, kaptina Isra, u zgjodh për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Ngjashmëria është paaftësia e mendjes për të kuptuar plotësisht natyrën e të dyjave.⁶ Natyrisht, lidhshmëria e kësaj kaptine me kaptinat e tjera nuk kufizohet vetëm me këto gjëra. Nuk duhet harruar se mund të ketë lidhshmëri të ndryshme për sa i përket fillimeve dhe përfundimeve të kapitujve, përmbajtjes dhe aspekteve të tjera.

METODAT E EDUKIMIT BRENDA MESAZHEVE TË KAPTINËS EL KEHF

Qëllimi i Kuranit në edukimin e njerëzve është t’i largojë ata nga politeizmi duke i ftuar në besimin e njëshmërisë së Zotit, të përforcojë besimin në botën tjetër dhe të tregojë realitetin e kësaj bote kalimtare, duke theksuar se stolia dhe bukuria e saj është e përkohshme. Po ashtu një ndër objektivat e tij është për të mësuar se ngjarjet e hasura në jetë, kanë një botë të brendshme, ndaj është e nevojshme që njeriu të pajiset me durim. Edhe në kaptinën Kehf, vihet në pah fakti se njerëzit janë të thirrur në drejtim të këtyre qëllimeve kuranore dhe se janë aplikuar metoda të ndryshme edukimi në përputhje me natyrën e qenies njerëzore.

METODA E MËSIMDHËNIES BAZUAR NË LIBËR DHE NJOHURI TË SAKTA

Libri zë një vend të rëndësishëm në mësimdhënie (arsim), ngase në mësimdhënie, përpunimi i informacionit të librit është i pashmangshëm dhe natyra e informacionit të

përdorur është gjithashtu e rëndësishme. Po ashtu është e një rëndësie të madhe që njohuria që u jepet njerëzve të jetë pa komplekse dhe kontradikta, të jetë e qartë dhe të shprehë siguri. Kjo metodë është edhe metoda e edukimit e aplikuar nga Kurani. Njohuritë e shpallura nga Kurani përçojnë veçorinë e të qenit njohuri e saktë në të cilin nuk ka asnjë kontradiktë apo kompleksitet. Kjo e vërtetë madje shprehet edhe në kaptinën Kehf në të cilën thuhet: “E tërë lavdia i takon vetëm Allahut, që ia zbriti robit të vet librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërtënie. (Ia zbriti) Të saktë (pa shmangie)...”⁷

Ndërsa, ata të cilët nuk kanë njohuri të sakta dhe një libër të vërtetë për t’u mbështetur, në kaptinën Kehf qortohen dhe thuhet: “Dhe për t’ua tërhequr vërejtjen atyre që thanë, se Allahu ka fëmijë. Dhe për atë (fëmijë), as ata, e as të parët e tyre nuk kanë kurrfarë dije. Sa e madhe është ajo fjalë që del nga gojët e tyre, e ata nuk thonë tjetër vetëm se gënjeshtër.”⁸ Siç shihet, në kaptinë, synohet edukimi i njerëzve për këtë çështje duke vënë në dukje rëndësinë e njohurisë së saktë. Në ajete theksohet fakti se njëra nga metodat e edukimit

"Është e një rëndësie të madhe që njohuria që u jepet njerëzve të jetë pa komplekse dhe kontradikta, të jetë e qartë dhe të shprehë siguri. Kjo metodë është edhe metoda e edukimit e aplikuar nga Kurani".

është njohuria e saktë e cila duhet të bazohet në libër të vërtetë apo prova të qarta, përndryshe një njohuri që nuk posedon këto nuk mund të posedojë asnjë vlerë të vetme.

Kaptina Kehf gjithashtu thekson faktin që është i gabuar diskutimi mbi çështje për të cilat nuk gjenden njohuri të caktuara, duke sjellë si shembull diskutimet rreth numrit të atyre që qëndruan në shpellë dhe theksoi panevojshmërinë e këtij diskutimi si vijon: “Ata (që bisedonin për këtë) do të thonë: “Ishin tre... Ishin pesë... kjo ishte hamendje, po edhe thonë: “Ishin shtatë... Thuaj: “Zoti im e di më së miri për numrin e tyre, përveç një pakice nuk di kush për ta, e ti (Muhamed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm ashtu në tërësi, dhe mos pyet askënd për ta.”⁹ Sejid Kutbi, (v. 1969) në lidhje me

këtë ajet kuranor thekson që diskutimi për të rinjtë në fjalë është i kotë. Mund të nxirren mësimë prej tyre, qofshin ata në numër të paktë apo shumë. Për këtë arsye, Zoti i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e Tij që të mos debatojë për këtë dhe të mos kërkojë asgjë nga ata që polemizojnë. Kjo është në përputhje me metodën e sistemit islam të mbrojtjes së energjisë mendore nga harxhimi në gjëra të padobishme dhe parandalimi i myslimanit që të mos ngelet prapa gjërave për të cilat nuk ka njohuri të caktuara. Kjo ngjarje, e cila ka mbetur në thellësi të kohës, është një nga ngjarjet e padukshme që duhet referuar në njohjen e Allahut. Pra, diskutimi për këtë çështje duhet të lihet mënjë. ¹⁰ Këta shembuj në kaptinë theksuan rëndësinë e njohjes së librit të vërtetë dhe faktin që informacioni i dhënë gjatë edukimit të njerëzve duhet të jetë i bazuar në të ose në prova të qarta.

1 Fahrudin err Razi,, Mefatihul-l-Gajb, v. XXI, Bejrut, Daru'l-Kutubi'Ilmiyye, v. XXI, f. 113-114.

2 Isra, 17/1.

3 Kehf, 18/1.

4 Hixhr, 15/98.

5 Es-Sekafi, el-Burhan fi Tenasubi Suveril-Kur'an, Bejrut: Daru Ibnul-Xhevzi, 1438, f. 162. Razi, v. XXI, f. 73-74; Vehbe Zuhejli, Et-Tefsiru'lMunir, v. XV, Bejrut, Daru'l-Fikr, 1991, f. 196.


6 Ibën Ashur, Muhamed Tahir, Tefsiru't-Tahrir ve't-Tenvir, Tunus, Daru'tTunusije li'n-Neshr, f. 244.

7 Kehf, 19/1-2, po ashtu shiko, Kehf, 18/110.

8 Kehf, 18/3-4, po ashtu shiko, Kehf, 18/15.

9 Kehf, 18/22.

10 Sejjid Kutub, Fi Dhilali'l-Kur'an, v. VII, Stamboll, Shtëpia Botuese Emir, 1993, f. 401.



Mjerimi për devijuesit e shpalljes

Jusuf ef. Zimeri

Allahu xh.sh. thotë: “Mjerë për ata që me duart e tyre shkruajnë librin (e rrejshëm), e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut”,- që për këtë të kenë ndonjë dobi (fitim) të vogël! Dhe mjerë për atë që shkruajnë me duart e tyre, dhe mjerë ata për atë që e fitojnë në këtë mënyrë!” Ata (hebrenjtë) thanë: “Ne nuk do të na prekë zjarri, përveç disa ditë.” Thuaj (o Muhamed): “A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim, e Allahu nuk e thyen premtimin e vet, ose ju jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini?!” (El Bekare, 79-80).

Ajeti kuranor që synojmë ta shpjegojmë fillon me nocionin “ar. vejlun”, që në kuptimin gjuhësor do të thotë: mjerim, fatkeqësi, dënim, ndëshkim, hakmarrje, vuajtje, shqetësim, kurse nocioni “ar. vejletun”, do të thotë mjerim, skandal dhe fatkeqësi, pikëllim. Ky nocion, në kuptimin terminologjik islam është një shprehje që reflekton kërcënimin e merituar për një veprim, dhe reflekton një shkatërrim, një turp, mundim apo thyerje të zemrës. Kjo shprehje, që në Kuranin fisnik paraqitet me dhjetëra herë, vjen në kuptimin e kërcënimit, mjerimit e psherëtimës. Po ashtu vjen edhe si kërcënim prej Allahut xh.sh. për kryerësit e disa veprave të veçanta, mirëpo vjen edhe si kërcënim në relacionin njeri-njeri, e edhe si psherëtimë ndaj vetes, pra që e bën njeriu.

KUJT I DEDIKOHET VEJLIMJERIMI?

Mjerimi që në Kuranin famëlartë paraqitet me nocionin “ar. el vejlun”, është një formë e kërcënimit që i dedikohet disa

kategorive të njerëzve, të cilët në një formë apo tjetër kanë refuzuar apo kanë kontestuar urdhrat e Allahut xh.sh., ose që kanë kryer veprime të ndaluara ndaj shoqërisë njerëzore, në përgjithësi ose në veçanti. Pra, kjo masë sanksionuese e kërcënimit, në argumentet autentike paraqitet për disa prej vepruesve apo mosvepruesve të disa veprimeve, sepse, sipas Islamit mosveprimi i urdhrit për veprim është mëkat që meriton sanksionim, ashtu sikurse që është mëkat edhe veprimi i urdhrit për mosveprim.

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETEVE

Shkaku i zbritjes së ajetit të 79-të, të sures El Bekare, siç shpjegon dr. Vehbi Zuhejli, në tefsirin e tij¹, janë ithtarët e librit të shpallur, respektivisht rabinët hebrenj. Rabinët hebrenj, siç transmeton Ibën Abasi r.a.: “I ndryshuan cilësitë e Pejgamberit, a.s., dhe e ndryshuan epitelin e tij. Përshkrimi i cilësive të Muhamedit a.s., në Tevrat ishte se ai ishte me sy të zinj, me sy të mëdhenj, me shtat mesatar, flokët me kaçurrela, me fytyrë të bukur, ndërkaq rabinët çifutë, të nxitur nga smira dhe urrejtja, i kishin shlyer këto cilësi, dhe kishin thënë se ai do të ishte i gjatë, i mavijosur dhe me flokë të drejta.² Prandaj, Allahu xh.sh., e zbriti ajetin e lartpërmendur, për t’i informuar njerëzit se këto janë devijime dhe ndryshime prej rabinëve çifutë, për të cilët do të pasojë dënim i rëndë për atë që e kanë bërë.

Prej Abdurrahman bin Alkame transmetohet se ka thënë: “Një herë e

Sipas Islamit, mos kryerja e urdhrit për veprim është mëkat që meriton sanksionim, ashtu sikurse që është mëkat edhe veprimi i ndalesës.



pyeta Ibën Abasin r.a., për ajetin “Mjerë për ata që me duart e tyre e shkruajnë librin!”, - e ai më tha: “Ky ajet ka zbritur për idhujtarët, si dhe për ithtarët e librave të shpallur (Ehlul Kitabët).”³

Kurse, shkaku i zbritjes së ajetit të 80-të të kësaj sureje, sikurse transmeton Ibën Abasi r.a., është thënia e çifutëve, siç tregohet në këtë version: “Kur Pejgamberi a.s. erdhi në Medine, çifutët thoshin se jeta e kësaj bote do të zgjatë shtatë mijë vjet. Për çdo një mijë vjet nga jeta e kësaj bote dënim në zjarr të Xhehenemit në botën tjetër do të ketë vetëm një ditë. Pra, dënimi me zjarr të Xhehenemit do të jetë vetëm shtatë ditë, e pastaj përfundon ndëshkimi apo dënimi.” Në përgjigje të këtyre pretendimeve të tyre të kota Allahu, xh.sh., e zbriti ajetin tetëdhjetë të kësaj sureje, ku thotë: “Ata (hebrenjtë) thanë: “Ne nuk do të na prekë zjarri, përveçse disa ditë.” Thuaj (o Muhamed): “A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim?! E, Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, ose, ju jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini!”⁴

Imam Taberiu, në tefsirin e tij, regjistron transmetimin po ashtu prej Ibën Abasit r.a., se çifutët thoshin: “Ne nuk do të hyjmë në zjarr të Xhehenemit më shumë sesa dyzet ditë, aq

sa i besuam vëçit në rastin kur Musai a.s., kishte shkuar për ta marrë librin e shenjtë, Tevratin, e pasi të përfundojnë këto dyzetë ditë, ndërpritet prej nesh dënimi, dhe lirohemi nga zjarri i Xhehenemit.”

Prandaj, Allahu xh.sh., si përgjigje ndaj fjalëve të tyre e zbriti ajetin e lartpërmendur.⁵ Prandaj, duke u mbështetur në mendimin e Ibën Abasit r.a., se ky ajet ka zbritur për ithtarët e librave të shpallur, ne mund të kuptojmë se në këtë lloj të dënimit përfshihen edhe ithtarët e shpalljes së fundit, pra Kuranit fisnik, apo ata që tentojnë ta devijojnë të vërtetën kuranore, pavarësisht formës dhe mënyrës së devijimit. Kështu vlerësohet në përgjithësi, ngase ajeti shpjegohet sipas asaj që përfshin shprehja, e jo sipas specifikës së shkakut të zbritjes.

SHPIJEGIMI I PËRGJITHSHËM I AJETEVE

Që në fillim të ajetit, vërejmë se ajeti fillon me formën kërcënuese “ar. vejlun”, mjerë për ata që i kryejnë veprat, pra të cilat do të përmenden më pas. Imam Kurtubiu në tefsirin e tij “El Xhamiu li Ahkamil Kuran”, tregon se dijetarët islamë kanë kundërthënë mes vete rreth kuptimit të fjalës “el vejlu”. Prej Othman bin Afanit r.a., transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë se “vejlu” është emër i një kodrine të zjarrit të Xhehenemit. Imam Taberiu thotë se nocioni “vejlu” është emër i një lugine në Xhehenem, në të cilën rrjedh qelbi dhe mbeturinat e banorëve të Xhehenemit. Në një hadith tjetër, që transmetohet prej Ebu Seid el Hudriut r.a., thuhet se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Vejlun është një luginë në Xhehenem, ku në të rrëshqet jobsimtari dyzetë vjeshta para se të arrijë në greminën e saj.”

Si rrjedhojë e kësaj, Imam Taberiu, thotë se në bazë të asaj që kuptohet nga ajeti, dhe në bazë të asaj që transmetohet, atëherë mund të nënkuptohet se dënimi i çifutëve dhe i atyre që e ndryshuan librin hyjnor me shkrimet e shenjta, dhe që thanë se ajo është e Allahut, do të jetë sanksionimi i tyre me ushqim nga qelbi dhe mbeturina, pra si banorë të Xhehenemit mu në fundin e tij.

Në një transmetim tjetër prej Sufjanit dhe Ata bin Jesarit, thuhet se kuptimi i shprehjes “vejlu” në këtë ajet është emri i një lugine në fund të Xhehenemit, e cila është e mbushur me qelb të banorëve të Xhehenemit. Zehraviu tregon, prej të tjerëve, se “vejlu” është derë nga dyert e Xhehenemit, kurse Ibën Abasi r.a., thotë se kjo shprehje paraqet vështirësi dhe dënim.⁶

Këtë lloj të dënimit Allahu xh.sh., do t’ua shqiptojë çifutëve dhe të gjithë atyre që e devijojnë shpalljen e Allahut, pavarësisht se për cilin lloj të shpalljes bëhet fjalë dhe për cilin

popull bëhet fjalë, sepse çifutët e devijuan librin e shenjtë Tevratin, duke shtuar në të tekst sipas dëshirës së tyre. Ata shlyen çdo gjë që nuk i favorizonte dhe që e urrenin, dhe çdo gjë nuk u shkonte për shtati. Ata e shlyen edhe emrin e Muhamedit a.s., nga Tevrati, prandaj kjo shkaktoi hidhërimin e Allahut xh.sh., kështu që për ta ka për ta zbritur këtë lloj dënimi dhe këtë lloj mjerimi.

Nga këto dy ajete kuranore vërejmë se Allahu i Plotfuqishëm i kërcënon ata që e shtrembërojnë librin e Allahut, duke e zëvendësuar me shkrime nga duart e tyre, dhe që me këtë i ndryshojnë dhe i devijojnë ligjet e Allahut xh.sh., pra për interesa mediokre personale. Ata e shtrembërojnë librin e Allahut, duke shtuar apo duke hequr diçka nga ai. Ata e tradhtojnë amanetin dhe integritetin e diturisë dhe të fesë, prandaj edhe kërcënohen me mjerim, ndëshkim, mundim dhe me shkatërrim në Ditën e Kiametit.

Ibën Kethiri në shpjegimin e këtij ajeti thotë se kjo është një kategori tjetër e çifutëve, e ata janë rabinët, të cilët ftojnë në lajthitje përmes falsifikimit dhe gënjeshtërs që e bëjnë ndaj Allahut xh.sh., ftesë kjo që ata e bëjnë me qëllim të pasurimit të tyre përmes haramit, prandaj edhe dënimi i tyre është i tmerrshëm.

Imam Es Sudiju,⁷ thotë se disa prej rabinëve çifutë kishin shkruar disa shkrime (libra), përmes së cilave shkresa e devijonin librin e tyre të shpallur (Tevratin), e më pas ato shkresa-ata libra, ua shpjegonin dhe nisën t'i shesin tek arabët, duke u thënë atyre se librat ishin të zbritura prej Allahut xh.sh..

Ajo që i nxiste rabinët çifutë që të merren me këtë veprimtarie destruktive e devijuese ishte pikërisht besimi i tyre i lajthitur dhe i devijuar, sepse ata do të kenë mundësi të qëndrojnë në zjarr të Xhehenemit ose vetëm shtatë ditë, ose vetëm dyzet ditë, aq sa e kishin adhuruar viçin në rastin kur Musai a.s., kishte shkruar në Turi Sina për ta

Një herë e pyeta
Ibën Abasin, r.a.,
për ajetin “Mjerë
për ata që me duart
e tyre e shkruajnë
librin!”, - e ai më
tha: “Ky ajete ka
zbritur për
idhujtarët, si dhe
për ithtarët e
librave të shpallur
(Ehlul Kitabët).”[

marrë Tevratin. Prandaj, sipas llogarisë së tyre, për ta ruajtur pushtetin dhe pasurinë, ia vlen të merren me çfarëdolloj veprimtarie që ua siguron pushtetin dhe pasurinë në jetën e kësaj bote, qoftë ajo veprimtari edhe devijimi apo falsifikimi i fjalëve të Allahut xh.sh..

Nëse e shohim ajetin e lartpërmendur me vëmendje më të thellë, do ta vërejmë se nocioni “vejlun” përmendet tri herë në një ajete: një herë se mjerimi i tyre është për besimin e tyre të gabuar, pastaj se mjerimi tjetër është për devijimin dhe falsifikimin që tentojnë t’ia bëjnë fjalës së Allahut, dhe mjerimi i tretë është për pasurinë e haramit që e fitojnë dhe e grumbullojnë në jetën e kësaj bote, duke përhapur gënjeshtër dhe shpifje. Profesori Vehbi Zuhejli, në shpjegimin e këtij ajeti, thotë: “Me veprimtarinë e tyre ata bënë tri vepra penale të përnjëhershme, e që janë; ndërrimi i cilësive të Pejgamberit a.s., shpifja ndaj Allahut xh.sh., si dhe marrja e mitos dhe e ryshfetit, prandaj edhe u kërcënuan tri herë me mjerim “vejlun”, pra për çdo veprim veç e veç.”⁸

Ata ishin të motivuar për këtë veprimtari, sepse dëshironin t’i ruanin pozitat e larta që i gëzonin rabinët, sepse po ta pranonin realitetin, atëherë do ta pranonin dhe do ta besonin edhe Islamin, dhe do ta kishin njohur Muhamedin a.s., dhe do të ishin nën udhëheqjen e tij. Prandaj, ata tentuan që me arrogancën e tyre t’i ikin këtij realiteti përmes shtrembërimit të fjalëve të Allahut xh.sh..

Të gjitha pretendimeve të tyre, se ata më së shumti do të mund të qëndrojnë në zjarr të Xhehenemit shtatë ditë, ose dyzet ditë, ose se ata janë bijtë e Zotit, Allahu xh.sh., u përgjigjet duke u thënë: “Thuaj (o Muhamed): a mos e keni marrë prej Allahut ndonjë premtim?! E, Allahu nuk e thyen premtimin e Vet.



Ose ju jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini?!” (El Bekare, 80).

Imam Sharaviu, gjatë shpjegimit të këtij ajeti, thotë se me këtë ajetsikurAllahu xh.sh., e urdhëron Pejgamberin a.s., që t’u thotë atyre se nuk janë ata që do të gjykojnë dhe që do të vendosin se çka do të bëjë Allahu xh.sh., me ta në Ditën e Gjykimit, por është Ai që e vendos, pra është Allahu xh.sh.. E, nëse kanë ndonjë premtim prej Tij, atëherë Ai nuk e ndryshon premtimin, mirëpo një gjë e tillë nuk ekziston.

Çifutët, meqë nuk i bënin ballë të vërtetës që e shpaloste Pejgamberi a.s., pra përmes shpalljes, e kishin formuar një bindje armiqësie të madhe ndaj Pejgamberit a.s., dhe atë që nga koha kur Muhamedi a.s., ishte shpallur për Pejgamber, sa ishte në Mekë. Dhe, kjo armiqësi u shtua edhe më shumë pasi Pejgamberi a.s., migroi në Medine. Ata disa herë edhe kishin tentuar me dinakëri që ta likuidonin Pejgamberin a.s. në Medine, mirëpo asnjëherë nuk ia kishin arritur qëllimit. Kur Pejgamberi a.s. kishte emigruar në Medine, çifutët ishin koncentruar në një fshat të quajtur Hajber, i cili ishte rreth 150km në veri të Medinës, rrugës për në Sham.

Për ngjarjen e Hajberit që ka ndodhur në vitin e shtatë të hixhretit, transmeton edhe Ebu Hurejreja r.a., i cili thotë se, pasi u çlirua Hajberi, një grua, e cila quhej Zejneb bint Harith, gruaja e Selam bin Mishkemit, e cila e kishte vëllain e saj rabin, dhe i cili ishte vrarë gjatë çlirimit të Hajberit, ia dhuroi Pejgamberit a.s., një dele të cilën e kishte helmuar. Ajo kishte pyetur se cilën pjesë të mishin nga delja e kishte të preferuar Pejgamberi a.s., dhe pasi i kishin thënë se e kishte shpatullën, ajo atëherë në atë pjesë të shpatullës shtoi edhe më shumë helm! Dhe, pasi iu soll delja e pjekur, Pejgamberi a.s., mori një kafshatë nga shpatulla, e futi në gojë, mirëpo nuk e gëlltiti. Në transmetimin që e bëu Ebu Davudi, prej Ebu Hurejres r.a., thuhet se Bishër bin Berrai r.a., kishte ngrënë me Pejgamberin a.s., nga ajo dele, dhe e kishte gëlltitur një kafshatë, dhe kishte

vdekur. Kur Pejgamberi a.s. mori vesh, menjëherë i urdhëroishokët që ta ndërprisnin ushqimin. Pastaj Pejgamberi a.s. tha: “M’i mblidhni të gjithë çifutët që janë këtu!” Ata u mblodhën te Pejgamberi a.s., e ai u tha: “Unë do t’ju pyes ju për diçka, e ju a do të jeni të drejtë dhe të sinqertë në përgjigjen tuja?!” Ata thanë: “Po, do të jemi të sinqertë.” Pejgamberi, a.s., i pyeti disa pyetje, për ta zbuluar gënjeshtren e tyre, dhe ua tha këto fjalë: “Kush është babai juaj?” Thanë: “Filani (për një njeri që nuk ishte babai i tyre).” Pejgamberi a.s. tha: “Gënjet, sepse babai juaj është filani (pejgamberi i Allahut, Jakubi, i biri i Ibrahimit).” Ata thanë: “Të vërtetën e the.” Pejgamberi, a.s., përsëri i pyeti përsinqeritetin e tyre në përgjigje, duke ua thënë këto fjalë: “Nëse ju pyes diçka?!” - mirëpo edhe ata thanë: “Po, do të jemi të drejtë dhe të sinqertë, o Ebul Kasim. Ne, edhe nëse të gënjejmë, ti e di ashtu siç e dite për babanë tonë!” Pejgamberi, a.s., i pyeti: “Kush janë banorët e Xhehenemit?” Ata thanë: “Ne do të jemi për një kohë të shkurtë, e pastaj ju do të na zëvendësoni (pasi të dalim ne nga zjarri)!” Pejgamberi a.s. tha: “Turp të keni! Ndaluni këtu me gënjeshttrat tuaja, se pasha Allahun nuk do të ju zëvendësojmë asnjëherë!” Pejgamberi a.s. u tha: “A do të jeni të sinqertë nëse ju pyes për diçka?” Thanë: “Po, o Ebu Kasim!” Pejgamberi a.s. tha: “A keni vendosur në këtë dele helm?” Thanë: “Po.” Pejgamberi a.s., i pyeti: “Cili është shkakuivendosjesshelmit?” Thanë: “Deshëmtavërtetojmë pejgamberinë tënde, nëse je gënjeshtar do të kishe vdekur nga ky helm, dhe do të kishim pushuar prej teje dhe nga ajo që po fton ti, e nëse je i vërtetë në pejgamberinë tënde, ky helm nuk të të dëmtonte sepse Allahu do të mbrojë.”

Me këtë veprim, Pejgamberi a.s., ua bëri me dije çifutëve se çështjet nuk qëndrojnë ashtu si pretendojnë ata, ngase ata do të qëndrojnë në zjarr të Xhehenemit të përhershëm, sepse kanë bërë krime, e kanë shpalosur kufrin (mosbesimin), dhe pastaj njerëzit e kanë ndryshuar dhe e kanë devijuar fjalën e Allahut xh.sh., keni vrarë të dërguar, prandaj edhe dënimi i tyre do të jetë i përhershëm, e jo siç pretendojnë disa, se ai do të jetë vetëm disa.

1 Dr. Vehbe Zuhejli, Tefsirul Munir fil Akideti ve Sheriati vel Menhexh, 1/203, Darul Fikër, Damask, botimi 1991.

2 Po aty, f. 203.

3 Seid Havva, El Esasu fi Tefsir, 1/169, Daru Selam li Tibaa, botimi i dytë, 1989.

4 Po aty, f. 203.

5 Vehbe Zuhejli, Tefsirul Munir, 1/303, Ibën Alij El Vahidij En Nisaburi, Esbabu Nuzul, f. 14, Tefsirul Xhelalejn, f. 17-18, prej Imam Sujutiut, Tefsiri i Taberiut, 1/302.

6 Kurtubiu, El Xhamiu li Ahkamil Kuran, 2/8.

7 Ismail bin Abdurrahman Es Sudij Ebu Muhamed El Kureshij El Kufij, ka vdekur vitin 127 hixhrij. Sudiu i takon gjeneratës së tabiinjeve. Ai ishte dijetar i famshëm i kohës, muhadith dhe mufesir, i cili ka edhe një tefsir të vetin, i cili është titulluar “Tefsiru Es Sudij”.

8 Dr. Vehbe Zuhejli, Tefsirul Munir, 1/202-203.

9 Buhariu, Ahmedi, Ebu Davudi etj.

Kurani, burim themelor në të Drejtën Islame

Khuma Emin Abdul Aziz

“Kurani fisnik dhe Suneti i Pejgamberit a.s. janë burimet që çdo mysliman të njoh dispozitat e Islamit. Kurani kuptohet sipas rregullave të gjuhës arabe pa kurrfarë vështirësie dhe mundimi. Kuptimi i Sunetit bëhet me ndihmën e dijetarëve të sinqertë të hadithit.”

Kurani dhe Suneti janë dy burimet kryesore të Sheriatit, janë dy burime në të cilat gjenden tekstet e Sheriatit që i përcaktojnë dispozitat e përgjithshme. Sa u përket burimeve të tjera të Sheriatit, ato nuk sjellin dispozita të reja në Sheriat, porse ato ndihmojnë në nxjerrjen e normave të Sheriatit nga Kurani dhe Suneti, dhe se me këto burime nuk mund të vendoset diçka që është në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, ngase këto burime bazohen dhe mbështeten në tekstet e burimeve themelore.¹

CILI ËSHTË BURIMI I PARË?

Kurani është burimi i parë. Ai është fjalë e Allahut që është e pa konkurrencë, e shpallur te Pejgamberi i Tij, Muhamedi a.s., i shkruar në mus'haf, i transmetuar me besnikëri (tavaturen) dhe që me leximin e tij bëhet ibadet. Të gjithë myslimanët janë unanim se Kurani është prej Allahut dhe se i Lartësuari kërkon që doemos t'i nënshtrohem i Atij. Andaj, Kurani është argument për çdo mysliman dhe myslimane dhe se ndjekja dhe zbatimi i dispozitave të tij është obligim pavarësisht llojin e dispozitës.

DISPOZITAT E KURANIT

Dispozitat e Kuranit janë dy lloje:

1. Dispozitat që kanë të bëjnë me çështjet e fesë. Në këto dispozita përfshihen dispozitat që kanë të bëjnë me çështjet e besimit dhe të ibadeteve (adhurimeve).

2. Dispozitat që kanë të bëjnë me çështjet e sistemimit të shtetit, shoqërisë, sistemimin e marrëdhënieve të njerëzve ndërmjet vete. Në këto dispozita përfshihen dispozitat që kanë të bëjnë me veprimet për koekzistencë (muamelat), për ndëshkimet (ukubat), për kurorëzim dhe shkurorëzim, për kushtetutën shtetërore, madje, në këto dispozita përfshihen dispozitat që kanë të bëjnë me veprimet e ndërsjella ndërmjet njerëzve (shkëmbimet-muamelat), për çështjet familjare (kurorëzim dhe shkurorëzim), për të drejtën penale (ukubat), për të drejtën ndërkombëtare (ligjet dhe diplomacinë) etj..

Këto dispozita janë zbritur me qëllim të futjes së lumturisë të njerëzve në këtë botë dhe në botën tjetër (Ahiret). Ai i cili u përmbahet ajeleve që kanë të bëjnë me dispozitat i ka dy shpërblime: shpërblim në këtë botë dhe shpërblim në botën tjetër (Ahiret).

Nuk janë përcaktuar kot ajetet që flasin për dispozitat, e të cilat kanë të bëjnë me çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër. Logjika e Sheriatit është se kjo botë konsiderohet si kalimtare dhe sprovë, ndërsa Ahireti konsiderohet i përhershëm dhe vend shpërblimi apo ndëshkimi. Njeriu konsiderohet përgjegjës për veprat e tija në këtë botë dhe se do të shpërblehet apo ndëshkohet në botën tjetër. Nëse njeriu vepron mirë, ai me këtë i bënë mirë vetes, e po që se vepron keq, e bënë kundër vetes dhe

Dispozitat e Sheriatit nuk pranojnë ndarje që disa të zbatohen e disa të braktisen.

se ndëshkimi në këtë botë nuk e pengon ndëshkimin e botës tjetër, përveç nëse njeriu pendohet dhe kthehet kah rruga e Allahut.

DISPOZITAT E KURANIT JANË NJË DHE TË PANDASHME

Dispozitat e Sheriatit nuk pranojnë ndarje, në mënyrë që disa të zbatohen e disa të braktisen, ngase tekstet (ajetet dhe hadithet) nuk lejojnë që disa dispozita të zbatohen e disa të braktisen, po ashtu është e ndaluar që disa dispozita të besohen e disa të mohohen dhe se zbatimi i të gjitha dispozitave dhe besimi i tërësishëm në to është detyrim. “A besoni një pjesë të Librit, e tjetrën e mohoni?! Ç’mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që punon ashtu prej jush, pos poshtërim në jetën e kësaj bote, e në Ditën e Gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni ju.” (El Bekare, 85).

Sheriati islam dallohet nga ligjet njerëzore me veçori të mëdha, siç janë dispozitat e Sheriatit që kanë të bëjnë me çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër (Ahiretit), sikur që kemi thënë edhe më herët. Ky është njëri ndër shkaqet e vetëm, i cili ndikon që myslimani t’i nënshtrohet dhe ta zbatojë Sheriatin kur është në vetmi apo para të tjerëve, në begati apo në fatkeqësi. Arsyeja është se të tillët besojnë se nënshtimi ndaj Allahut është një lloj ibadeti-adhurimi me të cilin afrohen tek Ai, dhe që do të arrijnë shpërblimin për shkak të nënshtimit-adhurimit. Nëse ndonjëri prej këtyre ka mundësi ta bëjë ndonjë krim dhe po ashtu pas krimit ka mundësi të shpëtojë nga dënimi në këtë botë, i tilli nuk do të bëjë krim nga frika që ka ndaj Allahut dhe pezmi i Tij.²

Për këtë arsye, Sheriati islam, e obligon myslimanin që të pajiset me moral fisnik, ai i cili pajiset me moral fisnik, rrallëherë bën ndonjë krim. Tjetra është se myslimanët e dinë se Allahu është Ai i Cili i mbikëqyr dhe e di se çka veprojnë ata. Të tillët e dinë se sado që të jenë të fshehur prej njerëzve, nuk mund të fshihen prej Allahut dhe se Ai është me ta kudo që të jenë ata. Mu për këtë arsye, krimet janë të pakta, ruhet siguria, mbrohet shoqëria dhe i jepet përparësi interesave të përgjithshme

shoqërore. E kundërta ndodhë në ligjet të cilat janë të vendosura nga njerëzit, ngase në shpirtin e këtyre personave nuk ekziston ndjenja e nënshtimit real ndaj këtyre ligjeve. Andaj, ai i cili ka mundësi të bëjë ndonjë krim dhe se është i sigurt se ligji nuk do ta kapë, atëherë të tillin s’ka gjë që e ndal në bërjen e krimit. Për këtë arsye, vijnë duke u shtuar krimet në ato shtete në të cilat sundon ligji njerëzor dhe ku morali është i ulët. Vjen duke u shtuar numri i kriminelëve për arsye të mungesës së moralit dhe mundësisë së shpëtimit nga dënimi i ligjeve njerëzore. Sheriati islam është prej Allahut, është sistemi më i mirë, më i përsosur, më i drejt dhe gjithëpërfshirës.

Sheriati islam është i arsyeshëm dhe i pranueshëm për çdo kohë dhe hapësirë, i cili dallohet me veçorinë e gjithëpërfshirjes, si për çështjet e njeriut, ashtu edhe për ato të kozmosit dhe të jetës. Besimi islam është i tillë nga i cili del në shesh uniteti i ndjenjave, ibadetet zbatohen me rituale unike. Sistemi i Sheriatit është unifikues i të gjitha ligjeve. Bashkëdyzimi i dispozitave të Sheriatit që kanë të bëjnë me këtë botë, me çështjet e fesë dhe të besimit të myslimanëve është për arsye se Sheriati është i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm, dhe në mesin e besimtarëve myslimanë ka përhapur shpirtin e nënshtueshmërisë dhe kënaqësisë. Po ashtu, Sheriati islam i thërret pjesëtarët e vet që të pajisen me moralin fisnik. Sheriati islam ka forcë për vetëpërmbytje, që asnjë ligj tjetër njerëzor, pavarësisht se sa është i mirë, nuk e ka një forcë të tillë.³

DISPOZITAT QË I PËRFSHIN KURANI

Kurani fisnik i përfshin në vete të gjitha bazat dhe rregullat e Sheriatit që kanë të bëjnë me hallallin dhe haramin. Shumica e dispozitave kuranore janë të pa detajuara e të cilat

japin sinjal për qëllimet e sheriatit. Nga këto dispozita të pa detajuara, dijetarët dhe muxhtehidët nxjerrin rregulla dhe dispozita me qëllim që t’i zgjidhin problemet dhe çështjet që paraqiten në çdo kohë dhe vend. Në këtë qëndron fshehtësia e përhershmërisë së Sheriatit dhe veçoria e gjithëpërfshirjes se të gjitha rregullave me të



cilat i zgjidh problemet e njerëzve sa herë që paraqiten në mesin e tyre.

Kurani i ka sjellë disa dispozita në mënyrë hollësisht të detajuar, për arsye që të mos ketë divergjenca dhe polemika rreth disa çështjeve si p.sh. çështjet e besimit (akides) dhe adhurimit (ibadetit). Këtë e ka bërë për arsye se këto çështje nuk i nënshtrohen ndryshimeve të kohës dhe vendit. Si dispozita të këtilla, mund të përmenden edhe dispozitat që kanë të bëjnë me trashëgimin (mirathin), ndalesat e martesës dhe ndëshkimi i disa krimeve.⁴

Kurani në vete përfshin ajetet mekase dhe ajetet medinase; ajetet me kuptim të përgjithshëm dhe me kuptim të specifikuar; ajetet që janë të qarta në përcaktimin e normës dhe ato që janë të paqarta; ajetet deroguese dhe të deroguara; ajetet që janë të pa detajuara dhe të vështira për t'u kuptuar; ajetet të cilat kanë shkaqe të zbritjes dhe shumë rregulla të tjera të cilat i njohin dijetarët e shkencave kuranore. Për këtë arsye, komentuesi i Kuranit, patjetër duhet t'i njoh disa shkenca, si më të rëndësishmet janë:

1. Gjuhën arabe dhe gjinitë e saj. Për këtë shkak, disa sekte të devijuara islame i kanë ndryshuar kuptimet e ajeteve, duke i komentuar pa u bazuar në rregullat dhe kuptimet gjuhësore, si p.sh. ata të cilët e kanë komentuar Kuranin duke u thelluar në kuptimin e brendshëm dhe atë sipërfaqësor. Të vërtetën e ka thënë Umeri r.a. kur ka thënë: "Përmabajuni divanit (rregullave gjuhësore) nuk do të devijoni." Muxhahidi ka thënë: "Nuk i lejohet atij që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit, që të flet për librin e Allahut nëse nuk e njeh gjuhën e arabëve";

2. Morfologjinë dhe sintaksën;

3. Letërsinë arabe dhe shkencat e elokuencës;

4. Shkencat kuranore;

5. Shkencën që merret me çështjet e besimit (akiden);

6. Shkencën e cila merret me bazat dhe metodologjinë e jurisprudencës islame (usuli fikh);

7. Hadithin e Pejgamberit a.s., jurisprudencën islame dhe historinë e Pejgamberit a.s.;

8. Shkencat e tjera si: sociologjia, historia, gjeografia etj..

Për këtë arsye, shokët e Pejgamberit a.s. janë dalluar rreth kuptimit të Kuranit, varësisht nga aftësitë e tyre rreth gjuhës dhe letërsisë dhe rreth njohjes së shkaqeve të zbritjes së ajeteve.

Ibën Abasi r.a., komentatori i Kuranit, shprehet kështu: "Unë nuk e kam ditur kuptimin e ajetit *فاطر السموات*. Ai i Cili u ka vënë zanafillën qiejve), përderisa erdhën tek unë dy

nomadë arab, që ishin në grindje për një pus, ku njëri prej tyre tha: *أنا أفطرتها* - Unë e kam filluar për herë të parë hapjen e pusit".

Përmendet në një transmetim se Ebu Bekri r.a. nuk e ka ditur kuptimin e fjalës kuranore *أب*. E në këtë rast ka thënë: "Cili qiell më bënë hije dhe cila tokë më mbanë nëse u flas rreth Kuranit sipas mendimit tim."⁵

Atë që duam ta potencojmë kalimthi është çështje e disave të cilët pretendojnë se Kurani është i mjaftueshëm dhe në të njëjtën kohë e refuzojnë Sunetin e Pejgamberit a.s.. Imam Shatibiu për të tillët shprehet kështu: "Mendimi se duhet të përqendrohemi vetëm në Kuran është mendim i disave, të cilët nuk e pranojnë Sunetin. Këta janë mbështetur në atë se Kurani është sqarues i çdo çështje, dhe i ka hedhur dispozitat e dala nga Suneti. Ky veprim, ata i ka shpije nga largimi i rrugës së shumicës myslimane dhe deri të komentimi i Kuranit në mënyrë të devijuar."⁶

Nga e gjithë kjo shihet se Kurani është burimi themelor i fesë, burimi kryesor i Sheriatit dhe argumenti më i fortë i Allahut për çdo kohë dhe vend, e të cilin ua ka transmetuar Pejgamberi a.s. ymetit të tij, e i cili e ka zbatuar urdhrin e Zotit të tij: "O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon." (El Maide, 67). Neve na ka urdhëruar Zoti ynë që këtë ta ndjekim (Kuranin). "Përvetësoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos zini miq (përkrahës) pos Tij. Pak është ajo që po merrni përvojë." (El Araf, 3). Kryejeni atë që është hallall, ndalojuni prej asaj që është haram, veproni sipas dispozitave të tij, besoni në ajetet të cilat krejtësisht nuk janë të qarta, dhe merreni mësim nga shembujt që u sjell Kurani.

Dijeni se Pejgamberit a.s. i ka ardhur Kurani dhe ai që është i ngjashëm më të (Suneti), e që është burimi i dytë i Sheriatit.

Përktheu nga gjuha arabe: dr. Flamur Sofiu

1 Abdul Kadir Aude "Et-Teshriul Xhinaiju" vol. I. fq.165.

2 Abdul Kadir Aude "Et-Teshriul Xhinaiju" vol. I. fq.171.

3 Abdul Kadir Aude "Et-Teshriul Xhinaiju" vol. I. fq.173.

4 Mennaul Kutun "Et-Teshriu vel Fikhu fil Islami tarihan ve minhaxhen" fq. 48.

5 Sujutiu "El-Itkan" vol. I. fq. 113, Zerkeshiu "El-Burhan" vol. II. fq. 162.

6 Shatibiju "El-Muvafekat" vol. I. fq. 120.

Veprimet e urryera (mekruhet) gjatë ngrënies

Dr. Ilmiye Kuqi

Një ndër qëllimet e Islamit është udhëzimi i njerëzve drejt disiplinës në sjelljet e tyre, si dhe ngritja e tyre në gjitha aspektet. Prandaj, ai e bëri qëllimin e ekzistencës së tyre më të nderuar sesa të kufizohej në dëshirat materiale dhe tekat e trupit.

Islami e ngriti sjelljen e njeriut në të gjitha aspektet e jetës së tij, dhe nga kjo nuk përjashtoi asnjë aspekt të jetës së njeriut, sado i thjeshtë dhe i parëndësishëm të duket. Kështu, ai për ne ligjësoi etikën e ushqimit dhe pijes, me të cilat ne ruajmë shëndetin e trupit tonë, nëse ato i zbatojmë.

Islami në fushën e të ushqyerit erdhi mesatar, pa anuar nga privimi ndaj ushqimit e as ndaj të ngrënit të pakontrolluar e të tepërt. Në këtë kontekst vuri një rregull të mahnitshme në pak fjalë, kur Allahu tha: “Hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (Allahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).” (El Araf, 31). Ai po ashtu, urdhëroi me agjërimin e një muaji të plotë, një herë në vit, mes tjerash edhe për ta ruajtur shëndetin dhe entitetin e organeve të trupit.

Gjithashtu, udhëzimi i Profetit a.s. erdhi me etikën morale, me të cilën myslimani menaxhon ushqimin dhe pijen e tij, gjë që ajo i shton jetës së tij shoqërore një nuancë të mrekullueshme estetike të sjelljes.

Fokusi i trajtimit tonë këtu, do të jenë gjërat e qortueshme gjatë ngrënies. E pa dyshim se ndër to janë:

Heshtja gjatë ngrënies, sepse kjo i ngjason zjarrputistëve. Prandaj, për t’iu shmangur këtij qortimi, gjatë ngrënies flitet, por, duhet pasur kujdes që mos flitet përveçse mirë dhe të mos flitet diçka nga e cila neveritet apo frikësohet njeriu, siç është përmendja e vdekjes, sëmundjes, etj..¹

Edhe fryrja e ushqimit të nxehtë, në rast se nxirret zë, si: uf, është e qortuar, ndërsa fryrja pa zë nuk është e qortueshme. Se kjo është e qortueshme, e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Ibën Abasi r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. e ndaloi fryrjen në ushqim dhe pije.”²

Ndalimi i përmendur në hadith ka për qëllim qortimin, për shkak të transmetimeve të haditheve të tjera, të cilat e shpjegojnë këtë, ku njëra ndër to është hadithi, të cilin e transmeton Xhujejrih r.a., e cila thotë: “Pejgamberi a.s. e urrente që ushqimi të hahej derisa të hiqej vlimi i avullit.”³

Se i Dërguari i Allahut a.s. nuk e hante ushqimin e nxehtë, por priste derisa largohej të nxehtit e lartë të tij, e dëshmon edhe hadithi, të cilin e transmeton Esma bint Ebi Bekër r.a., e cila kur përgatiste bukë të përzier me çorbë mishi, e mbulonte atë me diçka derisa të largohej të nxehtit e lartë, pastaj thoshte: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Zotit a.s. të thotë: “Ajo është më e bereqetshme.”⁴

Në lidhje me fryrjen në ushqim, Ibën Bettali, citon nga El-Muhel-lebiu, të ketë thënë: “Ndalimi i të Dërguarit të Allahut a.s. nga fryrja në ushqim dhe pije, nuk është se pështyma që fluturon në të është e papastër, por është nga frika se ngrënësia do të neveritet, prandaj urdhëroi mirësjelljen në këtë.”⁵

Përpos neverisë, ajo është edhe e dëmshme për shëndetin, siç shprehet El-Hatabiu, i cili thotë: “Ai (Pejgamberi a.s.) e ndaloi fryrjen në enë për dy arsye. Njëra prej tyre është se në të fryhet për shkak të nxehtësisë së saj të madhe, ndërsa ushqimi shumë i nxehtë është i dëmshëm, mandej është një nga shenjat e lakmisë dhe mungesës së vetëpërmbytjes. Arsyeja tjetër është sepse ai nuk mund të sigurojë se nuk do t’i bjerë diçka nga pështyma dhe kështu do ta neveritë atë që

ha. Meqenëse, neveria në çështjen e ushqimit dhe pastërtisë, është natyrë e shumicës së njerëzve, Pejgamberi a.s. e ndaloi atë që të mos prishej ushqimi për ata që duan të hanë dhe për këtë kuptim, Zoti e urren frymëmarrjen në të.”⁶

Është e qortuar gjithashtu ngrënia e pjesës së jashtme të bukës, apo vetëm e pjesës së brendshme të saj dhe hedhja e pjesës tjetër, në rast se bëhet pa arsye, sepse kjo është nënçmim i bukës, ndërsa nënvlerësimi i saj sjell uri dhe thatësi.⁷ Nga kjo bën përjashtim nëse ajo pjesë e lënë e bukës hahet nga dikush tjetër, si dhe në rast se është zgjedhur që është më e butë për shkak të mungesës së dhëmbëve.

Gjithashtu, është e qortuar fshirja e gishtërinjve dhe thikës me bukë, siç veprojnë shumë njerëz, në qoftë se ajo kafshatë me të cilën është fshirë nuk hahet, por disa dijetarë, këtë e kanë konsideruar të qortueshme absolutisht, pra në të gjitha rastet.⁸

Po ashtu është e qortuar edhe shkundja e duarve mbi enë, për shkak se të tjerët e urrejnë një gjë të tillë dhe çdo gjë që tjetri e urren, ajo është e ndaluar në ushqim.

Prej shprehive të qortueshme, që juristët kanë cekur dhe që kanë këshilluar që të shmangemi gjatë ngrënies, është hapja e gojës

gjatë ngrënies,⁹ në prani të të tjerëve, gjë që si rezultat i saj vjen deri te nxjerrja e zërit gjatë përtypjes. Tekste të shumta nga suneti kanë ardhur për të ndaluar ngjashmërinë me kafshët në grykësi dhe lakmi gjatë ngrënies dhe pirjes. Prej tyre, hadithi, të cilin e transmeton Ibën Abasi r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos pini një herë si pirja e devesë,¹⁰ por pini dy dhe tre herë (me ndërprerje) dhe thoni Bismilah kur ia filloni të pini, ndërsa thoni Elhamdulillah kur e lini.”¹¹

Gjithashtu, në një transmetim tjetër nga Ibën ebi Husejni r.a., Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush pi, le të gëlltitë pak nga pak dhe mos gllabërojë (pa marrë frymë).”¹²

Ajo që nënkuptohet me këtë udhëzim profetik është udhëzimi për të pirë ngadalëngadalë, dhe mos të gllabërohet siç bëjnë kafshët, të cilat nxjerrin zhurmë me këtë, shtu këtu edhe dëmtimit që i sjell kjo pirësit dhe shqetësimi i atyre që e rrethojnë. Prandaj, themi se prej mirësjelljes së të ngrënit është mbyllja e buzëve gjatë përtypjes, shmangia e tingullit kur përtypet dhe pihet dhe shmangia e të folurit kur goja është plot me ushqim, për ruajtjen e ndjenjave të të tjerëve.

Ngrënia e pjesës se jashtme të bukës, apo vetëm e pjesës se brendshme të saj dhe hedhja e pjesës tjetër, është e qortuar gjithashtu, -në rast se bëhet pa arsye-, sepse kjo është nënçmim i bukës, ndërsa nënvlerësimi i saj sjell uri dhe thatësi



Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kur ndonjëri prej jush pi, le të gëlltitë pak nga pak dhe mos të gllabërojë (pa marrë frymë)"



Edhe vendosja e enës apo diçkaje tjetër mbi bukë është e qortuar, sepse të tjerët e urrejnë këtë, dhe sepse ne jemi urdhëruar ta nderojmë bukën, ndërsa në këtë ka fyerje të saj. Po ashtu, është e qortuar e kundërta e kësaj, e që është vendosja e bukës anash enës, në mënyrë që ajo të qëndroj drejt, sepse në këtë ka fyerje të bukës, ndërsa ne jemi urdhëruar ta nderojmë atë. Gjithashtu është e qortuar hedhja e bukës në tokë, sepse Islami e ka obliguar myslimanin që t'i respektojë dhuntitë e Zotit dhe t'i trajtojë ato me mirësjellje dhe në krye të këtyre dhuntive që na ka urdhëruar t'i respektojmë është dhuntia e ushqimit. Ajo që kërkohet nga myslimani është të sillet mirë me ushqimin dhe t'i përmbahet mirësjelljes që Islami nxit në ruajtjen dhe ngrënien e tij, qoftë vetëm, apo në shoqërinë e të tjerëve. Prandaj, nëse mblidhen copa buke dhe personi nuk dëshiron t'i hajë ato, me to mund t'i ushqejë kafshët dhe nuk duhet t'i hedhë në rrugë, apo diku tjetër, përveç nëse vendosen për t'i ngrënë milingonat apo diç tjetër. Prandaj, nëse njeriu gjen bukë, ose diçka tjetër të ngjashme, në ndonjë vend të papastër, atë duhet ta largojë dhe ta vendosë në ndonjë vend të pastër. Është me rëndësi të

theksohet se është e qortuar edhe ngrënia në rrugë, duke qëndruar në këmbë apo duke ecur, për shkak se kjo bie ndesh me virtytet morale, e në veçanti për pronarët me pozita të larta, ku nga ky veprim ulet prestigji i tyre dhe bie nga syri i njerëzve. Kjo ndryshe nga ajo, nëse fshihet prej tyre pas ndonjë perdeje, mbyllje ose muri, e në këto raste nuk është e qortueshme.

Po ashtu, është e qortuar ngrënia nëpër varreza, për shkak të neglizhencës në respektimin e varrezave të besimtarëve dhe marrjes së mësimi për të cilin edhe vizitohen varret.

Përveç rasteve të lartpërmendura, mund të themi se është detyrë e çdo myslimani që të kujdeset për gjithçka që mishëron i vlerat, parimet dhe etikën e fesë së tij. Ai duhet të ketë sjellje të mirë dhe cilësi fisnike, që e bëjnë atë një imazh të bukur të fesë dhe kombit të tij. Ai gjithashtu, duhet të marrë parasysh etiketën e shijes publike që miratohet nga zakonet dhe normat shoqërore, përderisa ato nuk bien ndesh me Sheriatin islam, dhe të shmanget nga veprimet dhe sjelljet që mund të shkaktojnë shqetësim dhe neveri tek ata që e rrethojnë. Imam Jakub ibën es-Sejidi, në lidhje me këtë, ka thënë: "Ai nuk duhet të bëjë diçka që neverit të tjerët"¹³, që do të thotë se njeriu gjatë ngrënies duhet të shmanget nga çdo gjë, nga e cila neveriten të tjerët nga ajo.

1 Ed-Durrer el-Mubaha, fq.34; Mefatihu el-Xhinan, fq.300.

2 Ahmedî, nr: 2817, 5/27, Shejh Shuajbi thotë: "Senedi i tij është sipas kritereve të dy shejhëve".

3 El-Mu'xhem el-Kebir, nr: 172, 24/66. El-Hejthemî, në Mexhma ezZevaid, 5/19, thotë: "E transmeton Taberani dhe në të ka një transmetues të pa emërtuar, ndërsa pjesa tjetër e senedit të tij është i mirë". ElMenavi, në Et-Tejsiru bishërhi el-Xhami es-sagir, 2/283, thotë: "Senedi i tij është i mirë".

4 Ahmedî, nr: 26958, 44/521; Ibën Hibani, nr: 5207, 12/67-, Shejh Shuajbi thotë: "Hadithi është i mirë"; El-Mustedrek, nr: 7124, 4/131, El-Hakimi thotë: "Ky hadith është sahih sipas kritereve të Muslimit". Këtë e miraton edhe Dhehebiu.

5 Sherh Sahih el-Buhari i Ibën Bettalit, 1/291.

6 Garibu el-Hadith, 1/631.

7 Mefatihu el-Xhinan, fq.293.

8 El-Muhit, 5/353; El-Bahru err-Raik, 8/210.

9 Shih: Ed-Durrer el-Mubaha, fq.49; Mefatihu el-Xhinan, fq.293. Ibën Mulekkin esh-Shafii, në et-Tevdih li sherhi el-Xhami es-Sahih, 26/94, thotë: "Nëse ngrënësi është mysafir, le t'i shmanget njëzet e nëntë të metave, që i kemi transmetuar në librin "Fe'vaid el-Mevaid" - në mesin e tyre e ka përmendur - dhe nuk e bën kafshatën në gojë në atë formë të përthithjes e të dëgjohet zë nga ajo." Në lidhje me këtë, edhe Ibën el-Imad esh-Shafii, në Adabu el-Ekel, fq.28, thotë: "Ngrënësi duhet t'i bashkojë buzët kur ha për dy kuptime: e para është se ai sigurohet nga ajo që del nga pështyma në rast të përtypjes dhe kjo mund të bjerë në ushqim, dhe e dyta nëse ai i bashkon buzët në gojë e tij nuk ka mbetur hapësirë."

10 Siç pi deveja menjëherë, sepse ajo merr frymë në enë. Mirkatu el-Mefatih, 7/2752.

11 Et-Tirmidhi, nr: 1885, 3/366, dhe thotë: "Ky hadith është i vetmuar"; ElMu'xhem el-Kebir, nr: 11378, 11/166.

12 Es-Sunen el-Kubra i Bejhekiut, nr: 14659, 7/464 dhe thotë: "Ky është muresel (i tejkaluar)."

13 Mefatihu el-Xhinan, fq.294.

Mjetet më të rëndësishme në predikimin e thirrjes

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

Predikimi i vlerave fetare të masa kërkon që të përdoren edhe mjetet e shpikura materiale dhe metodat e ndryshme organizative, të cilat do të ndihmonin dhe lehtësonin që të shpërndahet mesazhi i Islamit të të ftuarit. Sigurisht që mjetet të cilat janë përdorur në të kaluarën kanë pasur efektin e vet dhe si të tilla kanë luajtur rolin kryesor në thirrjen islame. Por, sot, kur jetojmë në epokën e globalizmit apo post-globalizmit, në të cilin bota po përgatitet të futet në të, kërkohet nga predikuesit që formën e ligjërimit të përshtatin me formimin, përgatitjen dhe aftësinë e shijen e çdo ambienti në të cilin jetojnë. Këtu, sigurisht që kultura, tradita dhe ambienti, luajnë rolë të rëndësishëm në përgatitjen dhe të folurin në publik, duke mos lënë vend për keqkuptime e keqinterpretime, të cilat më pas do të na shpijnë në situata që nuk i dëshirojmë asnjë.

Sigurisht se më herët, pjesa më e madhe e përcimit të mesazhit nga profetët dhe më pas edhe nga dijetarët e thirrësit është bërë nëpërmjet fjalës, këshillës, urdhrit për të mirë apo ndalimit nga e keqja, leksioneve, derseve-mësimeve etj.. Thirrësi apo predikuesi në kohën në të cilën po jetojmë, nuk mund të paramendojë misionin e tij pa e përdorur penën dhe shkrimin. Për nga lehtësia e përdorimit, përhapja, ndikimi dhe dobia, ky është edhe mjeti i dytë pas fjalës, veç kësaj, ky mjet është më i sigurt në ruajtjen e njohurive. Ky është mjeti i parë që ka krijuar Allahu. Me të, Ai shkroi Levhi mahfudhin (pllaka e ruajtur). Allahu i Lartësuar thotë: “Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Levhi mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.” (El Enbija, 105).

Ky mjet përfshin çdo gjë që shkruhet, libra, broshura, fletushka etj.

Objekti i daves është komunikimi i mesazhit të Islamit ashtu siç e përmend edhe Kurani: “O ti i dërguar! Komunikoj

atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon.” (El Maide, 67).

Që nga e kaluara e dimë se shtylla e komunikimit të fesë është fjala e shprehur dhe e shkruar: “Ti (Muhamed) mos shqipto atë (Kuranin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij! E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. Dhe pastaj është obligim i yni që ta shkoqisim atë.” (El Kijame, 16-19).

Kurani i drejtohet të gjithë njerëzimit: “O ju njerëz! Në te vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai, i cili i frikësohet më shumë Atij.” (El Huxhurat, 13).

Në këtë ajet kuranor, konfirmohet barazia e përgjithshme ndërmjet të gjithë njerëzve, mirëpo kjo nuk hedh poshtë specifikat e popujve. Kurani konfirmon se Allahu xh.sh. i ka bërë “popuj e fise”, me qëllim që të njihen dhe jo të urrejnë njëri-tjetrin.

Islami e pranon diversitetin e popujve, të drejtën e çdo populli për ekzistencë, madje këtë të drejtë ua njeh edhe kafshëve. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Sikur qentë të mos ishin lloje krijesash si gjithë të tjerat, do të urdhëroja t’i vrisja.” Në këtë hadith theksohet ajo që përmendet edhe te fjala e Allahut xh.sh.: “Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju.” (El En’am, 38).

Përderisa ky është qëndrimi i Islamit për botën e kafshëve, atëherë çfarë mund të thuhet për popujt dhe njerëzit?! Ne dimë raste, kur popuj me dëshirën e tyre janë shkrirë me një

popull tjetër, për shkak të fesë, mesazhit dhe gjuhës. Të tillë janë Egjipti, shtetet e veriut të Afrikës, etj., të cilët zgjodhën Islamin për fe dhe arabishten për gjuhë, duke u bërë anëtare të rëndësishëm në trupin e ymetit islam, madje duke pasur shpeshherë rol lidhës.

Pra, fjala, vazhdon të jetë deri më sot çështja esenciale e komunikimit të thirrjes islame edhe pse ka pësuar ndryshime në forma dhe publikime, por fjala e thënë, e shkruar, e fotografuar e gdhendur është shpirti e gurthemeli i daves dhe predikimit.

Mbi këtë sqarim, kuptojmë se njeriu me anë të kësaj çështje të paraqitur mbetet objektiv në thirrjen islame. Andaj mund të themi se mjetet e informimit dhe daveja bashkohen në mjete për komunikim dhe synim.

XHAMITË, QENDRA TË SHKENCËS DHE TË INFORMIMIT

Përgjatë shekujve, një shoqëri islame nuk ka mbetur asnjëherë pa ekzistencën e fukahave (juristëve islamë), dijetarëve, predikuesve dhe mjeteve të edukimit. Thirrja islame, me risitë dhe mjetet e saj, deri vonë ka qenë shtylla e edukimit islam për gjeneratat e njëpasnjëshme të të rinjve në çdo shoqëri islame. Po ashtu, strategjia e daves nuk ka qenë e ndarë nga mjetet e informimit në asnjë prej shoqërive islame gjatë shekujve, por ftesa islame ka qenë gjithmonë burimi dhe shtylla e mjeteve të informimit. Dëshmia më e besueshme për këtë është se xhamitë në çdo shoqëri islame ishin vatra të shkencës, informimit, edukimit, ndërgjegjësimi dhe udhëzimit dhe se xhamia vazhdon t'i kryejë këto funksione. Roli i xhamisë ende ekziston në çdo shoqëri islame si një fener për predikim, shkencë dhe udhëzim.

MJETET E INFORMIMIT

Kur diskutojmë pozicionin e daves në mjetet e informimit bashkëkohore dhe se si duhet të jetë raporti i medias me davetin, themi se natyra e shoqërisë islame kërkon themelimin e një "media islame" mbi baza të shëndosha. Në kuptimin që prania e mediave joislame në shoqërinë islame paraqet një kontradiktë të madhe, efektet negative të së cilës reflektohen në shoqëri, veçanërisht në fushën edukative dhe morale, e më pas edhe në strukturën shoqërore, gjë që është vërtetuar nga përvojat e ndryshme, në disa shoqëri myslimane që u transmetuan nga mediat perëndimore dhe u hapën

Mjetet e informimit janë motor kryesor me anë të cilit rrotullohen karvani i daves dhe me anë të saj funksionalizohen shumë objektiva të daves

dyert mundësive të saj gjatë këtij shekulli.

Kur struktura e mjeteve të informimit dhe komunikimit të daves në komunitetin mysliman të ngritët mbi bazën e saj të saktë dhe të qëndrueshme, atëherë procesi i informimit në tërësinë e tij dhe sekondaren e tij, duhet të frymëzohet nga mendimi i thirrjes islame që të jetë në harmoni me qasjen e tij, në mënyrë që mediat të janë një rrjetë e pastër islame që kontribuojnë në fuqizimin e vlerave islame dhe moralit islam. Ato luajnë rolin e saj në formulimin e mendimit të përgjithshëm të komunitetit dhe në rritjen dhe

formimin e brezave, duke dhënë kështu një edukim korrekt e besim të fortë.

Po ashtu, lidhjen ndërmjet mjeteve të informimit dhe daves duhet kuptuar si një lidhje e fuqishme mes mjeteve të komunikimit sot si shkencë dhe art, dhe nga ana tjetër daves, sot si urdhër për të mirë dhe ndalim nga e keqja, këshillim e komunikim të mesazhit islam.

Abdulhalim Muhjiddin, mendon se lidhjet ndërmjet daves dhe mjeteve të informimit janë lidhje të dallueshme. Mjetet e informimit janë motor kryesor, me anë të cilit rrotullohen karvani i daves dhe me anë të saj funksionalizohen shumë objektiva të daves.²

Kjo kërkon një sërë çështjesh të cilat duhet të përmbushen, në mënyrë që të finalizohet planifikimi informativ i daves, ku mes tjerave të bëhet:

1. Studim praktik për orientimin e opinionit të synuar, apo edhe atyre që mendohet të kihet ndikim mbi ta dhe t'u përgjigjemi në nevojat dhe kërkesat e tyre;

2. Funksionalizimi i këtij hulumtimi në hartimin e programeve të komunikimit me anë të projekteve të plota varësisht nga mundësitë.³

Nuk ka dyshim se mjetet e komunikimit masiv dhe artet e saj moderne mund të japin një kontribut të madh në zhvillimin e mjeteve të davetit dhe përhapjen e tij brenda dhe jashtë shoqërive islame, që bota dhe njerëzimi kanë nevojë jetike për një informim të drejtë larg ngjyrosjes së informatave dhe shpërndarjen e lajmeve të rrejshme, që janë shndërruar në kancer të shoqërisë post-moderne.

Rëndësi tejet të madhe në komunikimin e mesazhit të Islamit në mjetet e informimit ka edhe forma e përdorimit të gjuhës së të folurit dhe komunikimit në një mënyrë që u



përshtatet të ftuarve (masës). Gjuha e përdorur duhet të jetë ajo që kuptojnë masat, pasi thirrja jonë përfaqësohet nga fjalë të mira në diskutime, seminare, mësimet kuptimplota, fjalime atraktive dhe ligjërata interesante, me qëllime të mira. Mesazhet duhet të jenë me përmbajtje butësie e mëshire, dhe ka disa baza që duhet të jenë të disponueshme në të folur dhe ligjërime, në mënyrë që ai të jetë efektiv tek adresuesit.

Në botën e sotme të drejtuar (orientuar) nga informatat, shpesh është e pamundur që të arrijmë deri te publiku me porosinë tonë pa ndihmën e mediumeve. Në vend që të presim krizën të na i mbulojë të gjitha çështjet tona, do të ishte punë e mençur të ndërmarrim një nismë për ta ngacmuar interesimin e mediumeve. Një porosi e qartë dhe informatë korrekte, e njoftuar me integritet, ndershmëri dhe vullnet për të bashkëpunuar, do të na ndihmonte të komunikojmë nëpërmjet mediumeve. Për komunikim në baza të rregullta, duhet të kemi informata themelore për atë se kush na përfaqëson në mediume. Kjo mund të bëhet duke kontaktuar me qendrat e mediumeve lokale që na interesojnë. Këtë duhet ndjekur me dërgesa për korrespondentë të zgjedhur, si dhe me ftesën për paraqitjen tonë si burim informatash të vlefshme për shtyp në të ardhmen.⁴

ROLI I INFORMIMIT NË PREDIKIM

Vlen të përkufizohet funksioni i medias në fushën e thirrjes islame, i cili mund të duket kështu:

-Përballja me fushatat keqdashëse dhe helmet mediatike të përhapura nga kundërshtarët e Islamit dhe ata që nuk e njohin atë, dhe puna e vazhdueshme për të nxjerrë në pah të vërtetën e Islamit përmes një qasjeje të avancuar mediatike që përgatitet, studiohet dhe koordinohet ndërmjet agjencive dhe institucioneve të ndryshme mediatike të jashtme.

-Kontribuon në konsolidimin e vlerave islame dhe metodologjisë islame ndaj jetës shoqërore përmes përkushtimit të materialit mediatik ndaj mendimit islam.

-Vëmendje ndaj zhvillimit të mesazheve mediatike drejtuar pakicave myslimane në shoqëritë jomyslimane, në mënyrë që ndikimi dhe niveli i tyre mediatik të jetë më i madh se niveli i mediave në ato shoqëri, veçanërisht në fushën e publikimeve dhe radiove të drejtuara.

-Informimi për Islamin duke përdorur metoda dhe mjete të avancuara dhe efektive që sigurojnë furnizimin e anëtarëve të shoqërisë të të gjitha kategorive, moshave dhe niveleve intelektuale, që të pajisen me sasinë e duhur të kulturës islame dhe shkencave fetare.⁵ Në mendjet e shumë njerëzve, koncepti i daveetit mund të lidhet me kuptimin e “medias fetare”, por duhet kuptuar se media fetare është pjesë e “medias së thirrjes islame”, që duhet të jetë në shoqërinë islame, dhe se koncepti i daveetit zgjerohet dhe zgjatet për të përfshirë çdo vepër mediatike që thërret në të mirë ose urdhëron për të mirë ose ndalon nga e keqja ose kontribuon në arritjen e dobisë dhe të mirës për myslimanët. Thirrja, në kuptimin e saj gjithëpërfshirës, është thirrje për në rrugën e Zotit të Madhëruar dhe për realizimin e qasjes islame ndaj jetës në fusha të ndryshme të saj, si në besim, mendim, punë dhe transaksione, si dhe në edukim e ndërtim shoqërore dhe deri në fusha të ndryshme të jetës njerëzore.

1 Jusuf Kardavi, “Islami për tek i cili ne ftojmë”, Furkan, Shkup, 2022, f. 184.

2 Abdulhalim Muhjiddin, “Ishkal fil amel el islami bejne ethevabit vel mutajat el asrije”, Katar, 1419, f. 64.


3 Ahmed Hadad, “Ed-da’vetu vel islah- Menahixhu ve esalibu”, bot. i 4, Darul kalem, Bejrut, 2014, f. 342.

4 Hisham Jahja Talib, “Udhëzues për punonjësit islamikë”, Logos-A, 1998, Shkup, f. 265.

5 Tevfik el Vai, “Ed-da’vetu ile-ll-ah, Darul jekin”, Botim i dytë, 1995, Mensure, f. 427

Burrëria dhe besa e myslimanit

Isa Tershani



Abdullah bin Mes'udi r.a., thotë: “Që nga momenti kur Omeri e përqafoi fenë Islame, ne e ndjenim veten krenarë”

Prej cilësive me të cilat duhet të karakterizohet morali dhe personaliteti i besimtarit mysliman janë burrëria dhe besa. Burrëria është një koncept që kohëve të fundit po zbehet, madje edhe po i ndërrohet kuptimi me atë të kundërtën e tij. Kurani përdori shprehjen *burrë* për t'i treguar vetitë e plota të besimit dhe sakrificës.

Burrat e përmendur në Kuran janë ata të cilët kanë besim të thellë dhe çështjet e dynjasë nuk i nëpërkëmbin në favor të botës së ardhshme. Përdorimi tjetër i termit *burrë* tregon për vendosmërinë burrërore për ta ndihmuar dhe publikuar të vërtetën.

“PREJ BESIMTARËVE KISHTE BURRA QË VËRTETUAN BESËN E DHËNË ALLAHUT...”

Po kështu, edhe Muhamedi a.s., i vetëdijshëm për rëndësinë që ka, i kushtonte një interesim të veçantë burrërisë, e cila do ta përkrahte dhe forconte atë në misionin me të cilin ishte i ngarkuar.

Pejgamberi a.s. lutej shpesh me lutjen e njohur: “O Zot, forcoje fenë islame me Omer *ibnu'l- Hatabin*.” Si dhe në *hadithin* tjetër është transmetuar të ketë thënë: “O Zot, forcoje Islamin me njërin nga dy burrat që është më i dashur te Ti, Ebu Xhehlin ose Omer *ibnul Hatabin*. Më i dashur tek Allahu ishte Omeri.”

Kështu, vetëm pasi ai futet në radhët e besimtarëve, u bë e mundur që ata të dilnin e ta shprehnin haptas besimin e tyre. Abdullah bin Mesudi r.a. ka thënë: “Që nga momenti kur Omeri e përqafoi fenë islame, ne e ndjenim veten krenarë.”¹

SI MATET BURRËRIA?

Te njerëzit, në përgjithësi, burrëria matet dhe shikohet vetëm nga pamja e jashtme. Nëse ndonjëri është i pashëm, i fortë, pasanik, atëherë në sytë e njerëzve paraqet njeriun e mirë, burrin e vërtetë. Por në vlerësimin që i jep feja islame, burrat e vërtetë janë ata që kryejnë vepra të lëvdueshme dhe që i karakterizon morali (sjellja) e mirë.

Një ditë, një njeri po kalonte pranë Pejgamberit a.s., i cili ishte duke ndenjur me shokë. Pejgamberi a.s. i pyeti shokët që kishte pranë: “Çfarë mendoni për këtë njeri?” Ata i thanë: “E ka hak (e meriton) të martohet po qe se kërkon, t'i pranohet ndërmjetësimi nëse ndërmjetëson dhe t'i dëgjohet fjala nëse flet.” Pejgamberi a.s. heshti disa çaste. Pas pak, pranë tyre kaloi një mysliman i varfër. Edhe për këtë, Pejgamberi a.s., i pyeti: “Çfarë mendoni për këtë njeri?” I thanë: “Nëse kërkon të martohet nuk e meriton, nëse ndërmjetëson nuk i takon (pranohet), e nëse flet nuk meriton të dëgjohet.” Pejgamberi a.s. tha: “Ky është më

i mirë sesa të gjithë ata që mban toka mbi shpinë si puna e atij të parit.”

Burrëria është ajo që bart përgjegjësinë e nënshtrimit ndaj Allahut xh.sh., si dhe këshillimit për hir të Tij. Burrëria e vërtetë është forca e fjalës, paraqitja e së vërtetës, tërheqja e vërejtjes nga përçarjet dhe kundërshtimet, duke ruajtur gjakftohtësinë dhe zgjuarsinë.

Burra të vërtetë janë ata që flasin drejtë, i mbajnë premtimet dhe qëndrojnë të patundur në rrugën e drejtë dhe të vërtetë. Omeri r.a., njëherë kaloi pranë disa fëmijëve, kur ata e panë atë u larguan me shpejtësi, ndërsa vetëm njëri prej tyre mbeti, ai ishte Abdullah ibën Zubejri. Omeri e pyeti pse nuk ike si shokët. Ai iu përgjigj: “O prijës i besimtarëve! Nuk kam bërë ndonjë mëkat që të të frikësohem, po ashtu edhe rruga nuk ishte e ngushtë që të ta zgjeroj.”

Sa e sa fëmijë e të rinj janë të vjetër në moshë! Sa e sa të vjetër janë fëmijë! Burrëria nuk vlerësohet me moshë, me trup e pasuri, por me fuqinë shpirtërore, që e ngre nga gjërat e ulëta në të larta.

Në kohën kur Omeri (Zoti qoftë i kënaqur me të!), ishte udhëheqës i besimtarëve, dy të rinj erdhën tek ai. Për krahësh mbanin një burrë të panjohur nga shkretëtira. Me të dalë para Omerit r.a., ky i fundit i pyeti: “Kush është ky? Pse e mbani për krahësh?” Ata u përgjigjën: “Ky ka vlarë babanë tonë o prijës i besimtarëve.” Omeri e pyeti burrin: “A është e vërtetë që u ke vlarë babanë?!” Burri u përgjigj: “Po, e kam vlarë.” Omeri e pyeti: “Si e ke vlarë?” Burri tha: “Kishte hyrë me devenë e tij në parcelën time. I kërkova të dalë, por ai refuzoi. Kështu, e gjuajta me një gurë, i cili e goditi në kokë,

e për rrjedhojë ra i vdekur përtokë.” Omeri tha: “Dënohesh me vdekje.” Ishte një ligj që nuk mund të tolerohej dhe të vihej në diskutim. Omeri, (Zoti qoftë i kënaqur me të!), nuk e pyeti mbi familjen e tij, as nga cili fis rridhte, as nëse i përkiste një familjeje të njohur, fisnike dhe të fuqishme, as cili ishte statusi i tij në shoqëri. Të gjitha këto nuk i interesonin aspak Omerit, i cili nuk merrte parasysh askënd kur flitej për ligjet e Zotit. Askush sqëndronte mbi forcën e ligjeve hyjnore, edhe sikur vrasësi të ishte vetë djali i Omerit. I zënë ngushtë nga ajo që i dëgjuan veshët, burri i tha: “O prijës i besimtarëve! Të kërkoj që për hatër të Atij që ka krijuar qiej e tokë, të më japësh leje vetëm një natë. Dua të shkoj tek ime shoqe dhe te fëmijët në shkretëtirë dhe t’u tregoj se do të dënohem me vdekje për shkak të vrasjes. Pasha Zotin ata s’kanë njeri tjetër që kujdeset për ta përveç meje.” Omeri e pyeti: “E kush del garant për ty që do të kthehesh nga shkretëtira?!” Burri uli kokën, sakaq të gjithë të pranishmit mbajtën frymën. Askush nuk e njihte atë person, as emrin, as ku e ka ngritur çadrën në shkretëtirë, as shtëpinë dhe as farefisin. Si mund të dilnin garant për të? Këtu nuk bëhej fjalë për garanci për një grusht parash, as për një copë toke, as për një deve, por garanci për jetën. Nga ana tjetër, askush nuk kishte guxim t’i kërkonte Omerit ta tolerojë, aq më tepër që bëhej fjalë për dispozitat hyjnore. Kush ishte ai burrë që të ndërhyjë në një rast si ky? Askush nuk fliste. Omeri dukej i prekur nga ajo që po ndodhte, por nuk e lëshonte veten. Ai uli kokën dhe më pas iu kthye dy të rinjve, bijve të viktimës: “A pranoni ta falni vrasësin e babait tuaj?” Njëzëri u përgjigjën: “Jo. Kush ka vlarë babanë tonë, duhet të vritet para syve tanë o prijës i



besimtarëve.” Mandej, Omeri iu kthye të pranishmëve: “Kush del garant për këtë të mjerë?” Të gjithë ulën kokat dhe nuk folën, përveç Ebu Dherrit, i cili, me kokën plot thinja e me trupin e ligsht tha: “Unë o prijës i besimtarëve. Unë dal garant për të.” Omeri, si për t’ia kujtuar, i tha: “Por, a e di se është vrasës!” Ebu Dherri: “Edhe pse është vrasës.” Omeri e pyeti: “Mos e njeh?” Ebu Dherri: “Jo, aspak.” Omeri: “E si del garant për të atëherë?!” Ebu Dherri: “Vërejtja tek ai cilësitë e një besimtari dhe besoj se nuk do të gënjejë. Në dashtë Zoti, ka për të ardhur dhe do e mbajë besën.” Omeri i tha: “O Ebu Dherri! Mos mendon se nëse vonohet mbi tri ditë, do të heqim dorë dhe do të shpëtosh?!” Ebu Dherri iu përgjigj: “Më ndihmoftë Zoti o prijës i besimtarëve!” Kështu, burri vrasës u la i lirë, pasi i kishte dhënë leje Omeri vetëm tre ditë, gjatë të cilave do t’u jepte lamtumirën fëmijëve dhe familjes, si dhe do t’ua linte amanet dikujt nga të afërmit. Tre ditë më pas, Omeri i rikthehet çështjes. S’bëhej fjalë që ai të toleronte në gjëra të tilla. Ai i numëronte ditët një e nga një. Ditën e tretë, pas namazit të ikindisë, ai mblodhi burrat në xhami. Pasi kërkoi Ebu Dherrin dhe ai doli para njerëzve, i tha: “Ku e ke personin për të cilin dole garant o Ebu Dherri?” Ebu Dherri u përgjigj: “Nuk e di o prijës i besimtarëve.” Mandej hodhi sytë nga dielli, i cili iu duk se e shtoi shpejtësinë e vet drejt perëndimit. Të gjithë myslimanët dhe shokët e Pejgamberit a.s., kishin ulur kokat dhe askush nuk pëshpëriste. Veç Zoti e dinte sa të prekur ishin nga ajo që po ndodhte. Të gjithë e dinin dashurinë dhe respektin e Omerit për Ebu Dherrin, saqë ishte gati t’i japë një organ të trupit të tij po t’i nevojitej. Por këtu fjala bëhej për çështje të Sheriatit dhe drejtësisë, ishin dispozita hyjnore dhe nuk i shkonte mendja ndokujt t’i shkelë. Askush nuk i jepte të drejtë vetes të hapë një debat lidhur me vlefshmërinë e tyre, apo se duhen zbatuar në disa rrethana dhe nuk duhen zbatuar në rrethana të tjera, se duhen ekzekutuar me disa njerëz e jo me të tjerë. Disa çaste para perëndimit të diellit, dallohet nga larg pluhuri që ngrinte galopi i një kali. Omerit i çeli fytyra dhe thirri: “Zoti është më i madhi!” gjë e cila u pasua edhe nga myslimanët e tjerë. Me të mbërritur burri, Omeri e pyeti: “Pash Zotin, më thuaj çfarë

Burrëria nuk vlerësohet me moshë, me trup e pasuri; por me fuqinë shpirtërore, që e ngre nga gjërat e ulëta në të larta



të solli të vritesh! Shumë mirë mund të kishe qëndruar në shkretëtirën tënde, e askush nuk do të gjente dot kurrë.” Burri ia ktheu: “Pasha Zotin o prijës i besimtarëve, nuk erdha as për ty dhe as për ndonjë tjetër. Erdha vetëm për hir të Atij që di çdo të fshehtë. Kisha frikë se do të thonë njerëzit pas meje: “Ka humbur besa mes myslimanëve. Pasha Zotin, i kam lënë fëmijët si zogj të vegjël në shkretëtirë dhe erdha të marr dënimin që meritoj.” Mandej, Omeri iu drejtua Ebu Dherrit: “Po ti more i mjerë, ç’të bëri të pranosh e të hysh garant në një çështje kaq delikate dhe të rrezikshme?!” Ebu Dherri ia ktheu: “Pata frikë se do të flitet anembanë për këtë ndodhi dhe do të thonë

njerëzit: “Myslimanët nuk i zënë besë njëri-tjetrit.” Omeri u drejtua nga dy djemtë të cilëve u ishte vlarë i ati. Me lot në sy, ata thirrën: “E kemi falë, e kemi falë o prijës i besimtarëve.” Omeri i pyeti: “E keni falë?! Po pse pikërisht tani dhe jo më parë?!” Dy djemtë i thanë: “Kemi frikë se do flasin njerëzit e do thonë se mes myslimanëve ka humbur morali i faljes dhe dhembshurisë.” Me lotët që i lagnin mjekrën, Omeri u tha: “Zoti ua shpërbleftë me të mira për aktin!” Mandej iu drejtua Ebu Dherrit: “Zoti ta shpërbleftë me të mira edhe ty o Ebu Dherri! I hoqe një barrë të rëndë këtij burri.” Pastaj, iu drejtua burrit: “Edhe ty Zoti ta shpërbleftë me të mira, për besën dhe fjalën e mbajtur!” Ne dhe çdo brez i kaluar e lusim Zotin që edhe ty o prijës i besimtarëve, të të shpërblejë me të mira për drejtësinë që vendose mes njerëzve.²

Burrëria kultivohet vetëm me ujitjen e besimit dhe rritet me dritën e imanit. Askush nuk dëshiron të cilësohet si jo burrë. Çdonjëri mburret dhe krenohet kur cilësohet si burrë. Po ashtu edhe prindërit dëshirojnë që fëmijët të cilësohen me tiparet burrërore. Në fund, lusim Zotin Fuqiplotë që të na bëjë prej atyre të cilëve ju beson dikush dhe i besojmë dikujt, e nuk na bënë prej atyre të cilëve as nuk ju beson askush e as nuk i besojnë askujt. O Zot i Madhëruar na bëjë të jemi në shërbim të fesë në çdo aspekt të jetës tonë! Amin!

1 Buhariu 3684.

2 Ky tregim është përmendur në librin Nevadirul Hulefa, E përmend edhe Amr Halid.

“I gjallë me shpirt, pa dalë me luftua nuk e la!”

RRËFIMI I NËNËS SË DËSHMORIT MEDRESIST

Selim Selimi, medresist në vitin e tretë dhe myezin i xhamisë, la gjithçka duke përfshirë edhe nënën, babanë, vëllezërit, motrat dhe jetën e tij për çlirimin e vendit. Ai nuk kurseu asgjë! 24 vjet pas rënies, nëna e tij e përshkruan mençurinë, trimërinë, vendosmërinë dhe dashurinë e djalit të saj për vendin, mbi të gjitha, atë e cilëson si një njeri që e dashuronte fenë dhe Medresenë “Alauddin”.

“Në ballkon qetu keçjke, çka ki djali jem, i thojsha. Më thoshte ‘që shokët e mi në UÇK po i shoh nëpër lluga, e inshallah mori nanë shkoj ma shpejt te ta’”, kështu e përshkruan nëna e tij, Hatixhja, dëshirën e madhe të djalit të saj më të madh, Selim Selimit për

t’iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

24 vjet pas vdekjes së djalit të saj më të madh, Selimit, që atë kohë ishte vetëm 20 vjet, nëna e tij Hatixhja, e mban mend çdo sjellje të tij kur bëhej fjalë për çlirimin e vendit.

Me një buzëqeshje të lehtë, teksa shikimin e ka të ngulitur, ajo para syve ka djalin e saj, duke i kujtuar momentet kur ai po këmbëngulte se Kosova duhej të çlirohej dhe për këtë gjë nuk ka rrugë tjetër përveç luftës.

Ajo me saktësi kujton 7 marsin e vitin 1998, kur në odën e shtëpisë po ndiqnin lajmet përmes televizionit dhe po kuptonin

“Sikur sot më kujtohet që janë kanë në televizor, na në odë shkonim mi këqyrë lajmet edhe patë thanë ‘a i gjallë me shpirt, pa dal në mal me luftua kurrë se la’





se kryekomandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari me 56 anëtarët e tij të familjes dhanë jetën për liri të vendit.

Nëna Hatixhe tregon se nga ky moment, Selim Selimi, kishte ndarë mendjen se ai duhej t'i bashkohej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e vendit.

“Sikur sot më kujtohet që janë kanë në televizor, na në odë shkonim mi këqyrë lajmet edhe patë thanë ‘a, i gjallë me shpirt, pa dal në mal me luftua kurrë se la’, veç nime shtirë u kanë me i pa ato xhenaze, sot kur më kujtohet. Inshallah Zoti i paguan, s’di çka me thanë tjetër. Krejt ushtarët e krejt dëshmorët, kush ka ra për këtë vend, Allahu i shpërbleftë dhe i pagoftë”, thotë ajo.

Selim Selimi, përveçse ishte nxënës i vitit të tretë i Medresesë “Alauddin”, ishte angazhuar edhe si myezin i xhamisë në Shtime. Ai kishte paralajmëruar shpeshherë familjarët e tij se do t'i bashkohej luftës për çlirim. Ai largohej nga shtëpia për të falur kohët e namazit, por që nuk ishte i sigurt nëse do të kthehej në shtëpi, apo do të shkonte në luftë.

“Unë kurrë si kam thanë mos shko, se u kanë shumë i vendosur, prej që ka krisë lufta te Adem Jashari në Prekaz, ai tjetër sen nuk ka thanë, veç kam me u vesh edhe kam me dalë edhe unë me luftu, tjetër fjalë s’ka pas prej tij. Edhe dine thoshte,

“Unë kurrë si kam thanë mos shko se u kanë shumë i vendosur, prej që ka krisë lufta te Adem Jashari në Prekaz, ai tjetër sen nuk ka thanë, veç kam me u vesh edhe kam me dalë edhe unë me luftu, tjetër fjalë s’ka pas prej tij”.

ndoshta sot shkoj, dalke e falke drekën ose akshamin edhe thoshte se së bashku me naj kon shkoj në luftë, mos u boni marak”, vazhdon rrëfimin nëna e tij.

Sipas saj, Selim Selimi, fliste shumë për UÇK-në, kjo edhe për shkak të ushtarëve që kalonin shpesh afër shtëpisë së tij, që gjendej në Belincë të komunës së Shtimes. Madje ajo përshkruan gëzimin e tij sa herë që i shinte ata.

“Ka fol shumë, e ka thanë para se me marrë pushkën, qe a po e sheh shpatin qetu përpara, plot ushtarë të UÇK-së ne jshin, te ballkoni qetu kcejke, çka ki djali jem i thojsha. Thojke ‘qe shokët e mi po i shoh nëpër lluga, e inshallah mori nanë shkoj ma shpejt te ta.’ Kështu i përshkruan nëna Hatixhe bisedat e shpeshta me djalin e saj më të madh para se ai t'i bashkohej UÇK-së.

Ajo mes tjerash e përshkruan djalin e saj të vendosur për t'iu bashkuar luftës për çlirimin e vendit, por edhe si një njeri të pjekur, ani pse kishte vetëm 20 vjet.

“Po vallahin, ai u kanë i rritur, po bile as i rritur nuk u kanë se 20 vjet, ai u kanë ma i madhi prej djemve edhe ai vendosi me shku, nuk u kanë aq i madh me vjet, ama u kanë i pjekun shumë”, thotë më tutje ajo.

Nga dita kur iu bashku Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nëna e tij nuk e pa asnjëherë më djalin e saj më të madh. Përgjatë gjithë kësaj kohe kishte biseduar vetëm një herë me të përmes telefonit, madje një bisedë tejet të shkurt.

“Prej që ka shku në ushtri kurrë ma nuk u ardhur që të na vizitoi. Prej që ka shku kurrë s’ka ardh, se ai i është bashku UÇK-së në qershor që u vesh, edhe prej që janë ra në kufi kurrë se kemi pa ma djalin. Na jemi kanë në Ferizaj, ai u shku atje, ka nejt sa ka nejt atje, tu u kthy ka ra në kufi edhe kurrë ma se kemi pa djalin, një herë kam fol në telefon nja dy-tri fjalë se kurrë hiç.”

Ajo thotë se me t'u nisur për në luftë, ka qenë e vetëdijshme se djalin e saj të madh nuk do ta shihte më, por që asnjëherë nuk është penduar që i dha leje t'i bashkohej UÇK-së.

“Gjithkah shkonte kah kish ushtri. I thosha djali jem, masi ke vendos edhe po ki kaq shumë qejf, shko djali jem se nuk të ndali. Po shyqyr me faqe të bardh ka shku, kishim pas djem trima shumë për këtë Kosovë e djem azgana, lum Kosova për këta djem që i kish pas, na jemi krenarë edhe lavdi atyre ju qoftë. Çka me ba, ka pas shumë qejf, po edhe u kanë i vendosur për me ju bashkëngjijtë UÇK-së, shyqyr bile them që shkoi. Qatë ditë që ka shku e kam mendu se ma 99% s’kthehet, 1% mundet me u kthy. Jam pajtu me këtë punë ma, çka kam me ba”, thotë nëna e dëshmorit Selim Selimi, 24 vjet pas rënies së tij.

DASHURIA PËR MEDRESENË “ALAUDDIN” DHE FENË ISLAME

Selim Selimi kalonte net të tëra pa gjumë, atij i mjaftonin vetëm pak orë për të fjetur. Natën ai e kalonte duke lexuar dhe duke mësuar për fenë islame. Me këto fjalë bindëse, e përshkruan dashurinë e Selimit për Medresenë “Alauddin”, ku ishte nxënës i saj.

Ajo thotë se djali i saj ishte i dashuruar në dije për Islam dhe në punën e tij të myezinit që e bënte në xhaminë e qytetit të Shtimes.

“Kish qejf shumë me shku edhe shkoi, ka pas shumë qejf me shku në Medrese me u ba hoxhë. Vallahin shumë e ka dashtë, tepër diçka. Zot bone mirë, beso a i bënte dy orë gjumë, veç lexonte gjithë natën e lume.”

“Më dilte gjumi ndonjëherë natën edhe e pyetsha ‘o djali jem a po don diçka me hëngër a me pi’, më thoje ‘jo jo, veç nja dy molla afromi qetu’ rahmet shpirti i pastë edhe thoshte fleni ju se po kam qejf me lexu edhe qashtu lexonte. Shumë u kanë merak me mës, diçka tepër, se kur të hyn në gjak ajo punë tani s’ka kush qe ta heq”, tregon ajo.

Nëna e tij thotë se Selimi nuk iu largua kurrë prej mendjes.

Mes tjerash ajo rrëfen merakun e saj që kishte për djalin e saj nga i ftohti i madhi, ani pse armiku kryesor i tyre ishte një ushtri që me kapacitete ishte ndoshta edhe mijëra herë më e përgatitur se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe trimat e saj që po jepnin jetën për liri.

“Një merak e kam pas të tyre se shumë ftohtë u kanë, mu patën dhimbtë se mraz [acar v.j] i madh u kanë. Na afër shporetit s’mujshmi me nejt ata në mal në bjeshkë, po Allahu i pagoftë, nuk kish njeri çka bën, lufta qeto i ka pas”, thotë ajo.

Babai i Selim Selimit, Shaipi, nëna e tij Hatixhja dhe vëllezërit e motrat e tij morën vesh vetëm përmes gazetës se djali dhe vëllai i tyre kishte rënë dëshmor në luftën për çlirimin e vendit.

Por, për dallim nga të rënë e tjerë, Selim Selimit dhe ushtarët e tjerë që ishin me të po e kishin të vështirë të gjenin trupat e tyre.

“Prej kufirit t’u hi në Kosovë kanë ra, prej gazetës morëm vesh se na ka ra djali dëshmor. Na jemi kanë në Ferizaj, kemi

qëndruar nëntë muaj dhe prej aty jemi shku në Maqedoni se prej Ferizajt na hiqen, tani prej aty jemi shku në Norvegji. Na nuk jemi kanë këtu hiç, krejt i kishin pas gjet, veç Selimin edhe nja gjashtë apo shtatë shokë të tij nuk mundën me i gjet, thoshin janë të zhdukur”, rrëfen nëna e Selimit.

Por, nëna e Selimit ishte e bindur se po të ishte ai gjallë, do t’i lajmëronte në çfarëdo mënyre.

“Po çfarë të zhdukuri se vetmeveti veç një damar me i pas rreh se e kam pas djalin të mençur, thosha kurrë pa më lajmru se kishte lanë. Na si kemi gjet trupat gati tetë muaj, në Pashtrik ishin pas mbet në njëfarë vendi”, thotë ajo.

JETA E SELIM SELIMIT

Selim Selimi lindi më 7 gusht të vitit 1978 në Belincë të komunës së Shtimes, ndërsa ishte vetëm 20-vjecar kur kishte kapur pushkën në dorë dhe kishte dhënë jetën duke luftuar për çlirimin e atdheut. Shkollën e mesme e përfundoi në shkollën “Naim Frashëri” në Shtime, ndërkohë që do t’u nënshtrohej provimeve me korrespondencë të medresesë së mesme “Alauddin” në Prishtinë gjatë viteve 1993 deri më 1997. Selim Selimi nga viti 1997 – 1998 kishte punuar myezin i xhamisë së Shtimes.

Ai ishte nxënës i vitit të tretë kur në Zbroc të Carralevës ishin krijuar njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nga qershori ai iu bashku UÇK-së, në Krojmir, ku ndodhej një bazë e tillë. Duke parë moshën e tij të re, ai ishte sistemuar në shtabin lokal të Krojmirit me disa bashkëmoshatarë të tij, që punonin në kuzhinën ushtarake dhe ndihmonin për hapjen e istikameve. Gjatë muajve shtator – tetor 1998, Selimi hyri në radhët e UÇK-së në batalionin “Ruzhdi Salihut” të brigadës 121 “Ismet Jashari - Kumanova”.

Ai kishte depërtuar disa herë në zonën Operative të Nerodimës përmes shtabit të Rrancës, prej nga kontaktonte me të vëllanë, Ramizin. Më 2 nëntor, Selimi, së bashku me Ramadan Elshanin, Bashkim Krasniqin, Isa Ademollurin, Enver Ademollurin dhe dhjetëra luftëtarë të tjerë të batalionit “Ruzhdi Salihu” nga Krojmiri u nisën për në Shqipëri.

Selimi kishte rënë shëhid më 14 dhjetor 1998 në Gorozhup, me grupin e Mujë Krasniqit. Trupi i tij është gjetur tre muaj pas rënies, në fillim të marsit 1999, dhe qe varrosur po aty. Është rivarrosur në gusht 1999 në vendlindjen e tij, në Belincë, ku është ngritur lapidari i përbashkët i të rënëve të luftës së UÇK-së, në të cilin, bashkëluftëtarët e tyre kanë shkruar:

“Ne luftëtarët e UÇK-së nuk kursyem as jetën për lirinë e Kosovës. Gjaku jonë nderoi faqet e historisë kombëtare. Lavdi dëshmorëve të lirisë! Nga bashkëluftëtarët, Belincë.”

Autor: M.Sc. Agron Canolli



Karriera e Ismail Qemal Bej Vlorës në shtetin osman dhe qasja e medias osmane ndaj shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

Prof. ass. dr. Agron Islami

PËRGATITJA EDUKATIVO-ARSIMORE E ISMAIL QEMAL BEJ VLORËS

Të dhënat zyrtare osmane përshkruajnë në detaje biografinë dhe përgatitjen edukativo-arsimore të Ismail Qemalit.¹ Sipas regjistrit civil osman, Ismail Qemali lindi më 04 shkurt 1847.² Ishte i biri i kryeportierit të Sarajit Osman, Mahmud Nedim Beut, i cili vinte nga soji i Sinan Pashës. Mësimet fillestare të shkencave islame i kishte marrë në mejtepet fillore në Selanik dhe Vlorë. Njëherësh, gjatë kësaj periudhe, mësoi edhe gjuhën arabe dhe perse nga një mësues privat, të cilin e kishte angazhuar familja. Formimin e tij intelektual e vazhdoi në gjimnazin “Zosimea”, ku mori mësim mbi morfologjinë dhe sintaksën e greqishtes së vjetër, latinishtes dhe frëngjishtes. Në kuadër të skemës programore të gjimnazit në fjalë, Ismail Qemali, kishte ndjekur edhe lëndët: letërsi, aritmetikë, algjebër, gjeometri, trigonometri, fizikë, kimi, astronomi, psikologji, anatomi e njeriut, gjeografi dhe histori e botës. Regjistri osman vë në pah, se Ismail Qemali, shkruante gjuhën turke, greke dhe frënge, fliste gjuhën shqipe dhe lexonte latinishten. Sipas këtyre të dhënave, ai ka edhe një vepër të botuar me titull “*Aplikimi i ideve*”, i cili trajton çështje të filozofisë dhe shkencës.

KARRIERA BUROKRATIKE NË SHTETIN OSMAN

Sa u përket të dhënave për kontributin e Ismail Qemalit në administratën osmane, shohim se, ai qysh në moshën 16 vjeçare, respektivisht nga muaji maj i vitit 1860, u caktua nëpunës në Zyrën e Përkthimit të Portës së Lartë Osmane.

Një vit më pas, (mars 1861), u emërua atashe i Ambasadës Osmane në Paris, por për shkaqe të panjohura (në regjistrin osman thuhet, për arsye personale) nuk u paraqit në detyrën e përcaktuar. Një vit më vonë, (gusht 1862), u emërua në Sekretariatit e Korrespondencës me Jashtë pranë Vilajetit të Janinës. Ndërsa pas 18 muajve, iu besua posti i kryetarit të bashkisë të sapoformuar të Janinës. Rreth një viti më vonë, (shtator 1864), kontributin e tij e vazhdoi në cilësinë e asistentit të Guvernatorit të Tërhallës, Ismail Rahmi Pashës nga Tepelena. Më 1865, rikthehet në Stamboll, ku punon në zyrën e Përkthimit të Portës së Lartë. Pas një viti, (maj 1866), emërohet sekretar i Byrosë së Korrespondencës së Vilajetit të Danubit me rrogë prej 2.500 groshësh. Nga cilësia e sekretarit të Byrosë, për dy muaj me radhë mbuloi edhe detyrën e kolumnistit në gazetën zyrtare të Vilajetit, po ashtu si punë shtesë iu besua edhe posti i drejtorit të punëve të jashtme në Vilajetin në fjalë. Njëherësh, nga muaji mars i vitit 1868, u caktua edhe në postin e kryesekretarit të Kuvendit Administrativ të Vilajetit të Tërhallës.

Nga detyrat e shumta në Vilajetin e Tërhallës, Ismail Qemali, në qershor 1868, ushtroi detyrën e kryendihmësit të Zyrës Juridike të Këshillit Shtetëror, me një rrogë prej 4.000 groshësh. Pas 16 muajve, (tetor 1869), do të ngritët në postin e mytesarifit të Varnës në Bullgari, me një rrogë prej 12.200 groshësh. Ndërsa në muajin shkurt 1870, iu bashkua Kryesisë së Komisionit Evropian të Danubit dhe u emërua Mytesarrëf i Tullxhës në Rumani, me rrogë prej 14.000 groshësh. Në këtë pozitë qëndroi plot 3 vjet.


Sixhili osman nuk jep informacion mbi aktivitetin e Ismail Qemalit gjatë periudhës 1873-1876, respektivisht deri në

muajin gusht të vitit 1876, kur emërohet në Sekretarinë e Ministrisë së Jashtme. Megjithatë është i njohur fakti se, që nga viti 1873, së bashku me konsullin anglez, Mr. Majers, kishin në pronësi një minierë linjiti. Ndërsa në vitin 1875, për dy muaj qëndroi në Angli, ku zhvilloi takime me ministrin e Jashtëm dhe atë të Financave, si dhe pa nga afër politikat fiskale dhe qeverisjen lokale britanike. Këto kontakte erdhën si rezultat i raporteve të gjata që kishte mbajtur me përfaqësuesit e parlamentit britanik, ku përmes letërkëmbimeve me Mr. York, Wyndham dhe Bruce, shkëmbeu ide për gjendjen në Ballkan. Ndërsa nga muaji shtator i vitit 1876, emërohet anëtar i Komisionit të Jashtëzakonshëm të Plovdivit në Bullgari dhe kryetar i Komisionit të Jashtëzakonshëm në Slivenit të Bullgarisë, po ashtu.

Etapa 1877-1912 karakterizohet me vitet e disidencës së Ismail Qemalit karshi sistemit klasik osman. Respektivisht, Ismail Qemali, do të qëndroi krah për krah me Mithat Pashën, i cili njihej për qëndrime reformiste të Perandorisë Osmane. Në kuadër të kësaj qasje, I. Qemali nga pozita e sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme organizonte takime me Mithat Pashën, sidomos gjatë muajve kur Sulltan Murati V ishte i sëmurë dhe nuk ishte në gjendje të drejtonte shtetin.

Me shpalljen e konstitucionit më 1876, Mithat Pasha erdhi në pozitën e sadriazamit (kryeministrit) dhe Ismail Qemali ruajti pozitën e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ai u qëndronte besnik ideve të Mithat Pashës, të cilat parashihnin reformë të thellë nëpër njësitë administrative osmane dhe ku parashihej që Vilajetet e banuara me shqiptarë të bashkohen në një njësi administrative të vetme, të quajtura Vilajeti Shqiptar. Besnikërinë ndaj Mithat Pashës do ta shprehte edhe në organizimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga 40 deputetë të parlamentit osman, që kërkonin zhbërjen e vendimit të Abdylhamitit II për syrgjynosjen e Mithat Pashës.

Depërtimi i ushtrive ruse deri në Ardahan krijoi një realitet të ri në qendrën e Perandorisë Osmane, i cili u përcoll me protesta të grupacioneve, të cilët dhunuan edhe hapësirat e parlamentit osman. Si pretekst i kësaj gjendjeje, Sulltani mbylli parlamentin, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe syrgjynosi Ismail Qemal Beun në Kytahja. Në vitin 1884, Sulltani shpalli amnisti për Mithat Pashën dhe Ismail Qemalin po ashtu. Këtij të fundit ia riktheu të gjitha gradat dhe e ngarkoi me detyrën e mytesarifit në Mardin dhe Bollu (të Turqisë së sotme).



Bashkëpunimi i Ismail Qemal Beut me Portën e Lartë dhe Sulltan Abdylhamitin II shihet edhe në raportet që ky hartonte me tematikë gjendjen politike dhe administrative të perandorisë. Këto raporte i bënte herë me kërkesën e Sulltanit e herë me iniciativë personale. Njëherësh është i njohur fakti se, me lejen e Sulltanit, Ismail Qemali, kishte qenë njëri nga aksionaret e dy kompanive që kryenin punimet e hekurudhës osmane. Nga këtu, më 14 dhjetor 1891, ai emërohet vali (gubernator) në Bejrut (Liban) me një rrogë prej 20.000 groshësh. Ismail Qemali nga data 12 prill 1900 deri me 20 qershor 1900 kishte qenë në detyrën e valiut (gubernatorit) të Tripolit.³

Ismail Qemali kishte ndjekur lëndët: letërsi, aritmetikë, algjebër, gjeometri, Trigonometri, fizikë, kimi, astronomi, psikologji, anatomi e njeriut, gjeografi dhe histori e botës.

BASHKËPUNIMI ME XHONTURQIT DHE SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË SIPAS MEDIËS OSMANE TË KOHËS

Edhe pse studiuesit e ndryshëm kanë konstatuar se emërimi i Ismail Qemalit, në postin e guvernatorit në Tripol, u bë shkak që ky të rreshtohet me krahun e xhonturqve, ngase këtë emërim e konsideronte si një lloje syrgjynosje që i ishte bërë nga ana e Sulltanit, aktiviteti i tij politik dhe simpatia e madhe që ndjente ndaj Mithat Pashës na çon te shpirti i tij reformist dhe interesi kombëtar. Njëherësh, një personalitet me karrierë të gjatë politike në ujërat e shekullit më të gjatë osman, siç ishte Ismail Qemali, veçse e kishte shumë të qartë faktin që, Perandorisë Osmane po i vinte fundi dhe ishte mundësia e fundit po ashtu, që të ruhej identiteti shqiptar dhe kjo mund të bëhej vetëm nëpërmjet rrugëve juridike, respektivisht krijimit të një njësie të veçantë administrative që do të përfshinte gjithë hapësirën shqiptare. Mbi këtë bazë, ai doli kundër Sulltanit dhe u rreshtua me xhonturqit. Meqë, këta të fundit, me qëllim të tërheqjes së intelektualëve shqiptarë, në fillim kishin proklamuar reformën administrative dhe shihej një dritë në fund të tunelit për themelimin e Vilajetit Shqiptar. Por që, siç do të shihet më vonë, politikat qeverisëse të xhonturqve ishin kryekëput nacionaliste dhe si të tilla, ato dëmtonin edhe më shumë idealin e Ismail Qemalit dhe të intelektualëve të tjerë shqiptarë. Për rezultat, Ismail Qemali, i ndau rrugët njëherë e përgjithmonë nga Porta e Lartë dhe filloi së kërkuari ndihmën e shteteve të fuqishme evropiane për themelimin e shtetit shqiptar.

Duke qenë se Vilajetet Shqiptare luanin rolin e fortifikatës së fundit në Rumelinë Osmane (Ballkanin e Sotëm), çështja e fatit të Shqipërisë dhe shqiptarëve zënë një vend të rëndësishëm në gazetatat osmane të kohës. Sikur vije fjala me njërën ndër gazetatat më të njohura osmane “*Tercuman-i hakikat*”, e cila ndër tjera theksonte se: “Kërkesa për pavarësimin e Shqipërisë është mjaft e rrezikshme për vetë popullin. Meqë, Shqipëria është e rrethuar me popuj të ndryshëm, të cilët ushqejnë armiqësi ndaj shqiptarëve dhe ndarja nga shteti osman do t’i shkatërronte ata.”⁴ Ndërsa gazeta “*İkdam*”, në numrin e datës 2 dhjetor 1912, ndër të tjera i jepte hapësirë një interviste të një intelektual shqiptar. Në intervistën në fjalë, ndër të tjera thuhet: “Çështja e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë është më se e vërtetë dhe është (një) risi. Përveç Ismail Qemalit, edhe intelektualët e tjerë shqiptarë e kanë mbështetur dhe përkrahur pavarësinë e Shqipërisë. Madje, kjo ka marrë mbështetjen edhe të intelektualëve që veprojnë jashtë hapësirave të Shqipërisë. (Njëherësh) përveç



shumicës myslimane, edhe të krishterët katolikë dhe ortodoksë kanë qenë pjesë e evenimentit të shpalljes së pavarësisë.”⁵ Gazeta “*Sabah*”, në numrin e datës 1 dhjetor 1912, në një kolumn me titull “*Shqipëria dhe Serbia*”, ndër të tjera shkruante: “Pavarësia e Shqipërisë është mjaft e dyshimtë. Një qeverie të pavarur i duhen shumë para për të mbijetuar. Andaj, është një pikëpyetje e madhe se si do të sigurohen këto para për të mbijetuar kjo qeveri shqiptare. Njëherësh, edhe qeveritë e tjera të Ballkanit, të cilat sapo kanë dalë nga lufta për pavarësi, nuk do e shohin me sy të mirë themelimin e një shteti të ri. Nuk mund as të mendohet për një marrëveshje paraprake të Ismail Qemalit me Malin e Zi dhe Serbinë. Atëherë, akti i shpalljes së pavarësisë do të jetë shumë ngacmues (luftënxitës) për serbët dhe grekët. Shqiptarët kërkojnë të gjithë hapësirat e banuara me shqiptarë. Por që, edhe serbët edhe grekët do të kenë kërkesa të njëjta për disa vendbanime.”⁶

1 BOA. DH.SAID.d, D:26 G:471.

2 Me rastin e emërimit në pozitën e guvernatorit (Valiut) në Tripol, jetëshkrimi i Ismail Qemal Bej Vlorës, i ishte paraqitur organeve të parlamentit osman. Në këto të dhëna zyrtare, si vit i lindjes është dhënë 1847, ndërsa në kujtimet e veta, Ismail Qemali, si datë lindjeje jep vitin 1844.

3 Për biografi më të detajuar shih. Dritan Egro, “Jetëshkrimi i Ismail Qemalit”, *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2012, f. 303-306.

4 Ferit Vakkas, “Arnavudluğa Dair”, *Tercüman-ı Hakikat*, fq. 2.

5 *İkdam*, 2 Aralık 1912.

6 *Sabah*, 1 Aralık, 1912.

Alfabeti i gjuhës shqipe

Kongresi i Manastirit

Mbi përpjekjet historike të intelektualëve shqiptarë rreth krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe

Sevdie Arifi – Osmani

Nevoja dhe kërkesa për të pasur një alfabet të gjuhës sonë ka qenë e kahershme. Edhe pse gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra indoevropiane, e për këtë flasin shumë studiues shqiptarë dhe të huaj, megjithatë ajo është e dokumentuar shumë vonë. Mungesa e dokumenteve të shkruara që nga koha antike dhe Mesjeta e bënë të vështirë fillimin e shkrimit të shqipes dhe dëshminë e përdorimit të një alfabeti të hershëm shqip. Shqipja apo paraardhësja e saj, ilirishtja, nuk e pati fatin të ketë një trashëgimi të nevojshme për alfabetizmin e saj, ashtu siç e patën gjuhët e tjera, si: latinishtja, greqishtja e disa gjuhë të tjera antike. Gjithashtu, popullit shqiptar gjithnjë i mungoi institucioni i shtetit, i cili do të mundësonte shkrimin e shqipes në shekujt antikë e të mesjetës. Tek në shekulli XV, arrijmë të kuptojmë se si dhe me çfarë alfabeti është shkruar gjuha jonë. Pikërisht këtë e kuptojmë me gjetjen e dokumenteve të para të gjuhës shqipe.

Këto dokumente ishin të shkruara me alfabet latin dhe atë grek, që do të thotë nuk ishin të shkruara me alfabet të gjuhës shqipe. Meqë gjuha shqipe ishte një gjuhë jashtëzakonisht e vjetër në krahasim me gjuhë e tjera indoevropiane, duhej patjetër ta ketë edhe alfabetin e saj. Sigurisht arsyet janë të shumta, përveç që është gjuhë e vjetër dhe tregon lashtësinë, ajo tregon edhe identitetin tonë kombëtar, pastaj ajo duhet

Krahas përdorimit të alfabetit latin dhe grek për shkrimin e gjuhës shqipe qenë përdorur edhe alfabeti arabo-turk nga bejtexhinjtë e klerikët myslimanë

t'i përmbush nevojat dhe kërkesat fonetike të gjuhës sonë.

Krahas përdorimit të alfabetit latin dhe grek për shkrimin e gjuhës shqipe qenë përdorur edhe alfabeti arabo-turk nga bejtexhinjtë e klerikët myslimanë, e ndonjëherë edhe ai cirilik-sllav. Në ndërkohë bëheshin përpjekje të mëdha të krijoheshin edhe alfabet origjinale të gjuhës shqipe, si ai i N. Veqilharxhit, Hoxha Tahsini, Dh. Todri, Kostë Berati etj.. Përpjeke të tilla qenë bërë edhe nga arbëreshët e Italisë që nga shekulli XVI e këndej.

Pra, që nga koha e shkrimeve të para të gjuhës shqipe e gjer kur lindi alfabeti i Stambollit, qenë zhvilluara aktivitete të shumta për alfabetizmin e gjuhës shqipe.



Përpara kongresit, gjuha shqipe shkruhej nga 6 e më shumë alfabetesh, ndërsa më 22 nëntor i vitit 1908 ajo tani më e kishte alfabetin e saj, unik dhe të vetëm.



Por, ngjarja më e rëndësishme dhe vendimtare ishte Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Kjo ngjarje konsiderohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar të shekullit XX.

PSE U ZGJODH QYTETI I MANASTIRIT SI QYTETI I SHKRONJAVE SHQIPE?

Manastiri është qytet i hershëm, që nga koha e mesjetës, i banuar kryesisht nga popullsia arbërore duke përfshirë edhe fshatrat përreth. Gjithashtu, Manastiri gjatë shekulli XIX ka qenë një nga vatrave kryesore të klubeve shqiptare, të cilat kishin synim përhapjen e arsimit shqip kudo ku kishte shqiptar.

Pas revolucionit xhonturk (1908), duke përfituar nga koncesionet e vogla që i bënë në fillim xhonturqit, Manastiri bëhet çerdhe e vërtetë e klubeve shqiptare, patriotëve shqiptarë dhe shtypshkronjave të librave në gjuhën shqipe. Në këtë qytet shqiptar u mbajt Kongresi i Manastirit (1908), i cili vendosi për një alfabet të njësuar të gjuhës shqipe. Mbas luftërave të përgjakshme ballkanike, Manastiri u pushtua nga hordhitë serbe të cilat bënë mizori të papara mbi popullsinë shqiptare të Manastirit. Manastiri po ashtu njihet edhe si një nga

qytetet shqiptare, i cili e ka mbështetur Kryengritjen e Ilindenit (Iliridës) (1903), e cila i siguroi Republikës së Krushevës një autonomi të shkurtër. Në këtë qytet janë takuar shpeshherë përfaqësuesit patriotë shqiptarë, si Çerçiz Topulli, Bajo Topulli, Mihal Grameno, Nazmi Bej Resnja me krerët e rezistencës maqedonase.¹

FILLIMI I KONGRESIT TË MANASTIRIT

Më 14 nëntor 1908, në Manastir, u mbledhën intelektualët shqiptarë nga të gjitha anët e Shqipërisë dhe komuniteti shqiptarë jashtë trevave të saj, për të nisur punën për krijimin e një alfabeti të njësuar për gjuhën shqipe. Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit, i ka zhvilluar punimet prej 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908, duke qenë kështu një konferencë e nivelit të lartë intelektual. Ajo u themelua për të vetmin qëllim, krijimin e alfabetit shqip, një alfabet të njësuar, i cili do të shënonte edhe fillimin e letërsisë mbarëshqiptare. Përpara Kongresit, gjuha shqipe shkruhej nga gjashtë e më shumë alfabete, ndërsa nga 22 nëntori i vitit 1908, ajo tanimë e kishte alfabetin e saj.

Historia e alfabetit të gjuhës shqipe është shumë e gjatë dhe mjaft e ndërlikuar. Por, zhvillimin më të hovshëm dhe të gjerë e përjetoi gjatë pjesës së dytë të shekullit XIX

dhe fillimit të shekullit XX. Krahës zhvillimeve të tjera që kishin të bënin me çështjet e tjera gjuhësore, kulturore e kombëtare, ideja për të krijuar një alfabet të njësuar ishte urgjente.

Kësaj ngjarje i paraprinë një sërë aktiviteteve, takimesh dhe diskutimesh gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila periudhë i solli shumëçka të re kulturës sonë kombëtare.

Në Kongresin e Manastirit erdhën 50 delegatë dhe 350 të ftuar të tjerë nga të gjitha viset ku jetonin shqiptarët, por e drejta e votës iu pranua vetëm 32 vetave, përfaqësues të të gjitha shoqërive dhe qyteteve.² Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Komisioni i përbërë prej njëmbëdhjetë anëtarësh kryesohej nga Gj. Fishta. Komisioni kishte për detyrë të studionte çështjet e alfabetit dhe të dilte me propozime. Në shqyrtim u morën tre alfabetet:

- “Alfabeti i Agimit”, i shoqërisë letrare “Agimi” të Shkodrës, i propozuar nga D. Mjeda;
- “Alfabeti i “Bashkimit”, i shoqërisë letrare “Bashkimi” i Shkodrës, i hartuar nga poeti P. Doqi
- “Alfabeti i Stambollit”, i hartuar nga Sami Frashëri.

Më 14 nëntor 1908 u mbajt mbledhja e parë plenare, në të cilën u pajtuan që baza e alfabetit të shqipes të ishte alfabeti latin e jo ndonjë alfabet me bazë tjetër. Madje u zgjodh edhe një komision (Komiteti i Kongresit) me njohësit më të mirë të gjuhës, të cilëve iu besua formimi i alfabetit të përbashkët të shqipes letrare. Komiteti prej njëmbëdhjetë anëtarësh bëri punë të jashtëzakonshme, e që puna e tyre nuk ishte aspak e lehtë, nuk mundi të merrte ndonjërin nga alfabetet ekzistuese për shkak se asnjëri nuk ishte pa të meta dhe ajo që e bënte më shqetësuese ishte përçarja eventuale në mesin e pjesëmarrësve. Kështu komiteti vendosi që të kërkonte zgjidhje duke marrë nga një tingujt-fonema të shqipes dhe duke gjetur për secilin shenjë grafike përkatëse.

Siç ndodh në çdo diskutim, edhe komiteti pati vështirësi në arritjen e një marrëveshje të shpejtë dhe të kënaqshme për të gjithë pjesëmarrësit. Këto mosmarrëveshje lidheshin pikërisht me tingujt e gjuhës shqipe që nuk i gjenin shenjë grafike tek alfabeti latin. Disa kërkonin që për çdo tingull të caktohej një shkronjë e vetme, kurse të tjerët ishin të mendimit se këta tinguj duhej të shkruheshin me dyshkronjësha. Në ditën e pestë, Komiteti i Kongresit komunikoi rezultatet e punës së bërë, duke deklaruar se alfabeti i Stambollit ishte i aftë që t'i kryente me sukses të gjitha funksionet e një alfabeti kombëtar, sepse i plotësonte kërkesat që shtriheshin para tij. Krahës këtij, për botimin e

librave brenda dhe jashtë Shqipërisë do të ishte në përdorim edhe një alfabet tjetër, latin (alfabeti i sotëm).³

Alfabeti që doli nga Kongresi i Manastirit shfrytëzonte të dy mundësitë ekzistuese për plotësimin e alfabetit latin dhe për zbatimin e tij në truallin e shqipe. Kështu në rend të parë u formuan dyshkronjëshat, duke marrë element të dytë shkronjën /h/ ose /j (khs.: /dh/, /th/, /sh/, /zh/, /xh/, /nj/, /gj/ ose me dyzimin e shkronjave /r/, /l/, /rr/, /ll/). Në masë shumë më të kufizuar u shfrytëzua mundësia e përdorimit të shenjave diakretike: nga shenjat /c/ dhe /e/ me ndihmën e shenjave diakretike u formuan shkronjat /ç/ dhe /ë/.⁴

Kongresi i Manastirit la në përdorim dy alfabetet e ndryshme. Pse ndodhi kjo? Së pari, mendimet e anëtarëve të Komisionit për një alfabet unik qenë të pamjaftueshme. Dhe, së dyti, intelektualët dhe masat e popullit nga të gjitha anët ku jetonin shqiptarët kishin kërkuar me anë telegramesh që të pranohej njëri ose tjetri alfabet (i Stambollit ose i “Bashkimit”).⁵ Pra, Kongresi la në funksion alfabetin e Stambollit dhe atë latin. E gjithë kjo u bë që mos të ketë përçarje brenda popullit shqiptar.

Alfabeti i Stambollit formalisht u la në funksion për shkak se atij iu vu përball alfabeti i sotëm, i cili ishte më i thjeshtë me vetëm 25 shkronja monografe, me kombinimin e të cilave mund të prezantoheshin të gjithë tingujt e shqipes. Kurse alfabeti i Stambollit kishte 36 shkronja të veçanta, dhe po aq tingujt fonema. Arsyeja tjetër që e bëri alfabetin latin, që të marrë shtrirje më të madhe qëndron në lehtësimin e përdorimit të tij. Veprat e shkruara dhe materialet e tjera botoheshin pa kurrfarë pengesash kudo nëpër Evropë, dhe përbërja strukturore e alfabetit të sotëm ishte e atillë që përfshinte 2/3 e alfabetit të Stambollit. Kështu ky alfabet ofronte zgjidhje më të mira dhe më të lehta se të gjithë alfabetet që ishin përdorur më parë. Kongresi i Manastirit, edhe pse la në përdorim dy alfabetet, ai e zgjodhi përgjithnjë çështjen e alfabetit të shqipes letrare kombëtare.

1 J. Rrota “Për historinë e Alfabetit Shqyp”, Shkodër, 1936.

2 F. Raka “Normëzimi i shqipes ndër shekuj”, Prishtinë, 2004.

3 F. Raka, “Normëzimi i shqipes ndër shekuj”, Prishtinë, 2004.

4 E. Lafe “Drejtskrimi dhe grafia e shqipes, Kongresi i Drejtskkrimit”, Tiranë, 1965.

5 F. Raka “Normëzimi I shqipes ndër shekuj”, Prishtinë, 2004.

Vazhdojnë sukseset dhe jehona e librit enciklopedik të përmasave gjithkombëtare

“BARDHËSITË E ATDHEUT”-

VEPRA MONUMENTALE QË KA RENDITUR SË MUROSURI KALANË E LIRISË DHE KRENARINË TONË KOMBËTARE ...

Gjeneral Rrustem Berisha*

Kjo vepër është produkt i kronistit të luftës, z. Afrim Mustafa, i cili me mund të madh ka arritur që 2225 dëshmorë të kombit t'i përjetësojë në një vepër kaq të madhe. Enciklopedia kombëtare e autorit Afrim Mustafa është një vepër që bënë fjalë për dëshmorët e kombit, e që pikërisht këta dëshmorë edhe Allahu në Kuranin famëlartë i ka përmendur, prandaj ky libër i tejkalon kufijtë e një libri të thjeshtë.

Para vetes kemi një nga veprat më të mëdha të shkruara ndonjëherë nga penda shqipe, kushtuar pikërisht atyre bijave dhe bijve të ushtrive çlirimtare, që për ne flijuan jetët e tyre, u bënë fanarë ndriçues në altarin e lirisë dhe përjetësisht u ngjiten majave të bardhësisë së atdheut, janë këto mijëra faqe të mbushura me dhembje dhe krenari, e dikur ishin mijëra kilometra rrugë lirie, në atë botë të mallkuar robërie.

Tani, brenda kësaj vepre të madhe, jo vetëm në peshë fizike ashtu të madhe, por në përmasa të përmbajtjes kombëtare, është pikërisht kjo vepër, që me të drejtë edhe nga të tjerë kritikë dhe lexues, por edhe nga vetë autori, është cilësuar si një Enciklopedi Gjithëkombëtare. Si e tillë, është një

Në aspektin luftarak, lufta jonë çlirimtare për liri, si një nga ngjarjet më sublime të historisë sonë, flet qartazi për përkushtimin dhe idealin e madh të dëshmorëve për liri.

vepër që në vete ka renditur së murosuri kalanë e lirisë me mijëra jetë martirësh e dëshmorësh të ujitura me mijëra litra gjaku, pa të cilët liria sot, nuk dot mund të paramendohej.

Memorizimi i kujtesës për dalzotësit e atdheut e kemi thënë edhe herë të tjera në ngjarje përkujtimesh dëshmorësh, por edhe në këtë ngjarje kushtuar kësaj vepre kaq ambicioze, në botimet në gjuhën shqipe, të bën të kuptosh një dimension të një bote krejtësisht tjetër, nga ku ata, dëshmorët, lundrojnë së jetuari në pavdekësi, duke qenë të gjallë dhe të pa vdekur në përjetësi e të lartësuar e skalitur në pedestal dhe kujdestar të përhershëm të lirisë sonë.

Në kryeveprën e të gjitha veprave, e gjejmë formulimin universal – kuranor, ku i Lartësuari, Krijuesi ynë na përkufizon qartësisht libërësisht, përkatësisht flet për përmasat e ndërlydhura të dalzotësve, për ngjizjen e lidhjes mes atdheut dhe Zotit të tyre, duke na treguar: “Mos i mendoni të vdekur ata (dëshmorët) që luftuan në rrugën e Zotit të tyre, ata janë të gjallë, por ju nuk e kuptoni gjallërinë e tyre.”

Në aspektin luftarak, lufta jonë çlirimtare për liri, si një nga ngjarjet më sublime të historisë sonë, flet qartazi për

Ky libër
vërteton
maksimën e
popullit:
“Kombi që nuk
i harron bijtë e
tij të rënë në
luftë nuk ka
vdekje kurrë” ,
ndërsa “Kombi
që i harron bijtë
e tij të rënë në
luftë nuk ka
lindje kurrë”

përkushtimin dhe idealin e madh të dëshmorëve për liri. Ata, dëshmorët, ushtarë lirie, i shndritnin rreshtat dhe marshet tona drejt lirisë, atëherë çlirimtarë dhe sot dëshmues të gjurmëve të tyre, sikur shkëlqimi i diellit drejt tokës së vdekur nga dimri. Sot dhe nesër, ne të gjallët e vuajtjeve të panumërta, jetojmë vetëm mbi flijimin e tyre, nga ku ne po ndërtojmë të ardhmen tonë në liri, ose thënë ndryshe, pa luftën tonë të drejtë dhe të domosdoshme, dhe pa sakrificën dhe gjakun e tyre, ne akoma sot do të ishim të robëruar.


Përjetësimi i dëshmorëve në vepra të tilla kulmore të shkruara, siç është kjo e llojit të veçantë; “Bardhësitë

e Atdheut”, e autorit Afrim Mustafa, dëshmon edhe një herë maksimën e popullit, citoj: “Kombi që nuk i harron bijtë e tij të rënë në luftë nuk ka vdekje kurrë” , ndërsa “Kombi që i harron bijtë e tij të rënë në luftë nuk ka lindje kurrë”, ndryshe thënë, në kuptimin ekzistencial të substancës kombëtare, mund të konstatojmë se, nuk ekziston popull i lirë, i cili jeton në paqe pa heronjtë e tij.

Miq të librit dhe leximit të veçantë!

Materia në përmbledhje kaq voluminoze, tregon saktësisht seriozitetin mbi 12-vjeçar të punës së autorit Mustafa për të treguar peshën dhe vlerën e patjetërsueshme që kanë lënë dëshmorët e lirisë për historinë tonë të shumë përvuajtur, por të lavdishme.

Në aspektin akademik, metodologjia e veprimit, në disa mijëra vizita të familjeve të dëshmorëve, biseda individuale, rrëfimet, intervistat, fotografitë, shkrimet publicistike, arkivat, grumbullimi, sistemimi, dhe në fund shkrimi autentik i kësaj kryevepre në kohëzgjatje hulumtuese shumëvjeçare, me aplikimin e shumë metodave të grumbullimit të të dhënave kualitative, përbën një nga veprat më serioze të kësaj natyre të shkruara deri më tani në hapësirat mbarshqiptare.



Pasqyrimi real i kësaj materie, me tematikë martirësh e dëshmorësh, me një kronologji në të tri periudhat për çlirim, në këtë përmbledhje të jashtëzakonshme për shumësinë e masakrave dhe dëshmorët e tri ushtrive çlirimtare, pashkëputur të krijon imazhin e plotë të përmasave të lirisë, të një veprë tipike serioze shkencore, në aspektin e dokumentimit faktik të sublimimit historik të kombit, mbi të kuptuarit e të qenët i flijuar dhe flijimtarë për atdhe.

“Bardhësitë e Atdheut” tregon se ata nuk u flijuan për veten e tyre, që ne vetëm t’u thurim tekste këngësh, poezi, emra sheshesh, rrugë e shkolla, dhe vargje të bukura nga poetët dhe shfaqje aktorësh. Ata me vetëdije u flijuan për secilin prej nesh, për lirinë tonë, për dinjitetin tonë, kulturën tonë, dhe ne tani shumë më shumë se kurrë duhet t’i kujtojmë.

Lavdi e përjetshme gjakut të derdhur për liri!

Lavdi të gjithë dëshmorëve të lirisë!

* Ish-komandant i brigadës 138” Agim Ramadani” në UÇK- Zona Operative e Dukagjinit, dhe ish-ministër i FSK-së.

Libri në qytetërimin islam

Haki Sahitaj



Një nga tiparet më të spikatura të ‘qytetërimit’ islam është shkalla dhe shumëllojshmëria e të mësuarit. “Të bësh shumë libra nuk ka fund”, kështu e përshkruan Eklisiastiu, 12:12, problemin me të cilin do të përballeshin myslimanët e ditur gjatë historisë së tyre: kishte shumë për të mësuar në një kohë shumë të shkurtër, dhe megjithatë që librat mund të përmbliidhen, praktikohen dhe të shkurtohen, njohuria nuk ndaloi së rrituri. Çdo brez prodhoi autorë ambiciozë me ide të reja ose mënyra origjinale të riciklimit të të vjetrave.¹

Libri nga që viti 1980 është bërë një subjekt studimi. Të gjitha studimet që lidhen me studimin e teksteve, bibliografisë, filologjinë apo historinë, të gjitha këto studime kanë ndihmuar edhe në çështje të cilat kanë të bëjnë me librat. Padyshim edhe një nga karakteristikat më të dalluara të çdo qytetërimi është shfaqja e librave. Megjithatë, në përgjithësi, librat kanë qenë objekte të anashkaluara për sa i përket studimeve rreth qytetërimit.² Sigurisht, për shumë studiues të librit, vetë qytetërimi lind me librin apo të shkruarit.³ Është e qartë se një libër nuk është thjesht një gjësend fizik. Padyshim që jeta e njerëzve ndikohet nga ky mjet i vjetër dhe bazë komunikimi. Qytetërimet dhe kulturat e planetit tonë,

mund të thuhet me siguri, nuk filluan të lulëzojnë dhe zgjerohen derisa u shpik libri.⁴

Megjithatë, libri është një përgjegjësi e madhe për t'u studiuar, ngaqë kërkon edhe një angazhim dhe shtirje të gjerë për të njohur shpikjen, mjetet, përmbajtjen dhe ndikimin e tij në mendimin dhe edukimin e një shoqërie.

Ka një maksimë e cila thotë se “librat ndjekin fenë”, dhe kjo maksimë arsyetohet më së miri me qytetërimin islam, do thoshte Diringer.⁵ Kjo pasi që libri ka qenë tejet i përhapur dhe ka luajtur një rol kyç në vetë përhapjen e Islamit. Për shkak të shtrirjes së Islamit në shumë popuj, edhe natyra e librit, mjeteve dhe stilit ka qenë tejet e larmishme. Por në qytetërimin islam, libri i ka tejkaluar thuajse të gjitha motivet të cilat kanë qenë karakteristike në qytetërimet e hershme. Me Islamin, libri merr një rol shumë më gjithëpërfshirës si për nga përmbajtja, po ashtu edhe për nga lexuesit. Librat në qytetërimin islam, Sigrid Hunke, do t'i krahasonte me përhapjen e një epidemie, e ngjashme me garat e sotme për makina, televizor apo gjëra të tjera teknike.⁶ Për myslimanët e hershem, aq rëndësi kishin librat sa libri ka shërbyer edhe si një mjet politik. Harun err-Rrashidi, kur pushtoi Amarinë dhe Ankaranë, nuk kërkoi asgjë tjetër pos dorëzimin e dorëshkrimeve të hershme greke. Madje mes princave kishte një garë kush mblidhte më shumë nga dorëshkrimet e hershme.⁷ Por ashtu si edhe në shumë qytetërimet të tjera, edhe në atë Islam, lidhja mes qytetërimit dhe librit ka qenë pjesë e anashkaluar.⁸ Madje siç ka shkruar edhe profesor Muhsin Mahdi, se shumë nga telashet që kanë pasur myslimanët me printimin dhe me rënien e produktivitetit ka qenë si pasojë e mospasjes së të dhënave rreth librave në qytetërimin islam. Ai thotë: “Bota islame në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në fillimin e shekullit të njëzetë harroi ngadalë se çfarë do të thoshte të vareshin nga shkrimet dhe kopjet e dorëshkrimeve për krijimin, përhapjen dhe transmetimin e njohurive.”⁹

Një nga konceptet themelor të botëkuptimit islam është ‘ilmi. Ky koncept përkthehet kryesisht si dituri, por në etimologjinë e fjalës dhe përdorimin që ka pasur përgjatë

**Qytetërimet
dhe kulturat e
planetit tonë,
mund të
thuhet me
siguri, nuk
filluan të
lulëzojnë dhe
zgjerohen
derisa u shpik
libri**

civilizimit islam, ky koncept është tejet i pasur për nga përmbajtja. Është një koncept të cilin Sardari, do ta përkthente si “njohuritë si dhe të gjitha komunikimet e njohurive; është kërkimi i dijes si dhe shpërndarje dhe transmetimi i njohurive; janë të dhëna, informacione, njohuri dhe urtësi të gjitha të bashkuara në një”. Megjithëse literaturat islame shfaqen në një gamë të gjerë gjuhësh dhe në mjedise të ndryshme kulturore, ato janë të bashkuara nga disa të përbashkëta, duke përfshirë themelet e tyre intelektuale dhe fetare. Libri në botën islame ishte më thellësisht i integruar me Islamin si fe dhe me gjuhën dhe shkrimin arab, të cilat ishin mjetet e hershme të komunikimit në botën islame.¹⁰ Feja islame, apo ndikimi i botëkuptimit islam në të kuptuarit e diturisë dhe shkrimit i ka mundësuar myslimanëve të formulojnë një literaturë e cila është e vështirë të ndahet nga pjesët e tjera të secilës shkencë.

Kurani u bë teksti shkollor i gjithë filozofisë së jetës së myslimanëve; teologjia, leksikografia, gjeografia, historiografia dhe misticismi dolën të gjitha nga një studim i thellë i formës dhe përmbajtjes së saj; madje edhe në veprat më laike mund të gjenden aludime për librin e shenjtë.¹¹

Po ashtu, i tërë procesi artizanal i lidhjes së librit, fillesën dhe lulëzimin e tyre ia kushtonin marrëdhënies që kishin myslimanët me librin e shenjtë, Kuranin.¹² Kjo edhe mund të ketë qenë arsyeja pse për myslimanët e hershem të mos heqësh dorë nga asnjë libër konsiderohej pjesa më e mirë e mençurisë, edhe nëse ishte një libër mbi një temë përtej interesit dhe kompetencës së pronarit.¹³

Ndërsa sa i përket gjuhës arabe, ajo ka qenë një faktor esencial në sigurimin e unifikimit të popujve me gjuhë, etni dhe kultura të ndryshme. Përveç se u bë gjuhë zyrtare e administrimit, arabishtja u bë edhe gjuhë e fesë dhe e të mësuarit gjithandej.¹⁴ Kishte një nxitje të madhe për ta mësuar arabishten, jo vetëm si një gjuhë adhurimi, por edhe mendimi dhe kulture. Shumë nga mendimtarët e së kaluarës kanë argumentuar se zotërimi i gjuhës së adhurimit është në të njëjtën kohë kuptimi i etikës dhe kulturës islame.¹⁵

Gjithsesi muslimanët gjithmonë e kanë transformuar dijen dhe jetën e tyre në përputhje me sistemin e tyre të mendimit dhe etikës. Megjithatë, dalja në skenë e qytetërimit perëndimor ka pasur efekte të cilat kanë bërë të harruara shumë nga këto parime.

dijen dhe jetën e tyre në përputhje me sistemin e tyre të mendimit dhe etikës. Megjithatë, dalja në skenë e qytetërimit perëndimor ka pasur efekte të cilat kanë bërë të harruara shumë nga këto parime. Libri, mendimi dhe shkrimi kanë qenë ndër këto elemente, të cilat kanë kaluar nën një ndikim perëndimor ose kanë kaluar në amulli të parimeve dhe koncepteve islame. Sot studimet që flasin për gjendjen e librit, kryesisht në vendet që kanë qenë qendra të qytetërimit islam, tregojnë se ekziston një ngecje e madhe për dallim nga zhvillimet e së kaluarës. Edhe pse në botën myslimane u ndërmorën iniciativa për të ndryshuar gjendjen, reformat që ndodhën patën një mori formash, qasjesh, shpejtësi dhe qëllime të ndryshme. Kjo tregohet edhe me sfidat për zhvillimin e printimit në vendet myslimane. Kushtet e paqëndrueshme politike, ekonomike, por edhe dilemat e

Një element tjetër shumë me rëndësi ka qenë edhe elementi i estetikës.¹⁶ Myslimanët jo vetëm që kanë qenë të kujdesshëm për të përdorur teknika të avancuar, por në shkrimet e tyre kanë synuar edhe standarde estetike. Një nga sfidat më të mëdha për botën islame gjatë periudhës së shpikjes së printimit ka qenë bartja e këtyre parimeve në teknikat e reja të shtypit. Muhsin Mahdi, ka analizuar për shembull reagimet e myslimanëve kur u shtyp për herë të parë Kurani me anë të printimit në Hamburg, më 1694.¹⁷

Deri më tani u përpoqëm të tregojmë se literatura islame ka disa specifika të cilat e dallojnë atë nga llojet e tjera të literaturave. Nuk duhet harruar se format apo përmbajtja e saj përgjatë historisë, krahas ndikimit fetar, ka pasur edhe ndikimet e veta politike, ekonomike e kulturore përgjatë gjithë historisë. Gjithsesi myslimanët gjithmonë e kanë transformuar

ndryshme etike rreth teknologjisë, kanë ndikuar që shtypi dhe përmbajtja e librave të jetë në një gjendje kaotike. Në qytetërimin e hershem islam, mund të flitet sa për sasinë, po aq edhe për përmbajtjen e librave. Ndërkaq sot, në pamje mund të duket një gjendje e mirë se kemi prodhuar shumë libra e traktate të ndryshme fetare, por pajtohem me George Atiyeh, i cili thotë se bollëku i traktateve fetare dhe letrave të bukura nuk ka shërbyer për të krijuar një shoqëri më koherente dhe kohezive.¹⁸

Ne mendojmë se e njëjta gjendje është karakteristike edhe për literaturën islame të shqiptarët. Kjo kur marrim parasysh se pjesa dërrmuese e botimeve përkthehet nga vendet arabe, si dhe po këto vende janë burim referencash thuajse për shumicën e librave me përmbajtje fetare. Duke qenë se librat shprehin edhe gjendjen kulturore, historike, por edhe konfigurimet psikologjike të një shoqërie, të gjitha këto ndikime përcillen edhe te ne. Pa harruar edhe shumë paqëndrueshmëri me të cilat është karakterizuar gjendja e shqiptareve në veçanti dhe asaj ballkanike në përgjithësi. Ne mendojmë se sot shtypi dhe libri islam ka nevojë për një kritikë duke marrë për parim konceptet islame të dijes, rrethanat kulturore dhe nevojat bashkëkohore të lexuesit. Libri si mjet i komunikimit dhe i dijes në kohën e sotme do të ketë më shumë efekt në kulturën islame, nëse ndjek linjat më të qarta intelektuale dhe fetare për shoqëritë bashkëkohore myslimane.

1 Chase F. Robinson, *Islamic Civilisation in Thirty Lives/The First 1000 Years* (London: Thames & Hudson, 2018), 10.

2 David Diringer, *The book before printing* (New York: Dover Publications Inc., 2013), vii.

3 Aleksandër Stipčević, *Historia e librit* (Tiranë: Toena, 2000), 3.

4 George N. Atiyeh, "Introduction" në *The Book in the Islamic World/The Written Word and Communication*, nga George N. Atiyeh (ed.) (Albany: State University of New York Press, 1995), xiii.

5 Diringer, *The book before printing*, 443.

6 Sigrid Hunke, *Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin* (Tiranë: 2007), 251.

7 Po aty, 243-244.

8 Atiyeh, "Introduction" në *The Book in the Islamic World*, xv.

9 Muhsin Mahdi, "From the Manuscript Age to the Age of Printed Books", në *The Book in the Islamic World*, nga George N. Atiyeh (ed.), po aty, 5.

10 Atiyeh, "Introduction" në *The Book in the Islamic World*, xiv.

11 Kathilen Kuiper (ed.), "Islamic Literatures" në *Islamic Art, Literature, and Culture* (New York: Britannica Educational Publishing, 2010), 44-45.

12 Philip K. Hitti, *Historia e Arabëve/Nga kohët më të hershme deri më sot* (Shkup: Logos-A, 2019), 411.

13 Franz Rosenthal, "Of Making Many Books There Is No End: The Classical Muslim View." në *The Book in the Islamic World*, po aty, 36.

14 Kuiper (ed.), "Islamic Literatures", 37.

15 Muhammad A. Hamdun, "What is 'Islamic' in Islamic Literature?" në *Islamic Thought and Culture*, Isma'il R. al-Faruqi (ed.) (Maryland: International Institute of Islamic Thought, 1982), 66.

16 Po aty, 69.

17 Mahdi, "From the Manuscript Age to the Age of Printed Books", 1.

18 Po aty, 250.

E drejta për shkollim dhe shamia

Mr. Lulzim Kastrati

Në këtë punim do të trajtohen dy të drejta themelore të njeriut, e drejta për shkollim dhe e drejta e besimit, si të drejta elementare për një jetë të dinjitetshme. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë ato të cilat i takojnë çdo njeriu pa përjashtim, pasi këto të drejta janë elementare për një jetë të dinjitetshme.

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t'i njohur të drejtat e tij themelore më elementare, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut na japin mundësinë të zhvillojmë dhe të përdorim tërësisht cilësitë tona njerëzore, inteligjencën tonë, talentin dhe vetëdijen tonë, si dhe të kënaqim kërkesat tona shpirtërore dhe nevojat e tjera.

Mosnjohja apo mohimi i të drejtave themelore të njeriut, ia mophon shoqërisë (individit) të drejtën për një jetë të dinjitetshme, dhe për këtë arsye është bërë përpjekje e vazhdueshme në nivel regional e ndërkombëtar, duke miratuar deklaratat e konventa, për të njohur e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo përpjekje që e vë qenien njerëzore në qendër të interesit, është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave të përkushtuara të së drejtës për jetë, si një e drejtë e paprekshme, dhe ofron një kornizë për

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut.

ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht. Gjatë shekullit XX, të drejtat e njeriut janë zhvilluar si formulime morale, politike dhe ligjore dhe udhërrëfyese për zhvillimin e një bote të lirë nga frika dhe skamja.¹

Përkufizimi për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që sot pranohet gjithnjë e më shumë, është ai që e botojnë Kombet e Bashkuara me titull “Të drejtat e njeriut - pyetje dhe përgjigje”, të vitit 1987. Sipas këtij përkufizimi, të drejtat e njeriut, në përgjithësi, mund të përcaktohen si të drejta që janë të qenësishme në natyrën tonë dhe pa të cilat ne nuk mund të jetojmë si qenie njerëzore.

Si pikë fillestare e konceptit të të drejtave të njeriut është koncepti mbi dinjitetin e lindur dhe të patjetërsueshëm të të gjithë



anëtarëve të familjes njerëzore, koncept i cili njihet në Deklaratën Universale dhe në Paktet Ndërkombëtare të viteve 1948, të cilat njëkohësisht njohën edhe idealin e qenieve të lira njerëzore për të gëzuar lirinë nga frika dhe skamja, dhe për të qenë të pajisur me të drejta të barabarta dhe të patjetërsueshme. Prandaj, të drejtat e njeriut janë universale dhe të patjetërsueshme, që do të thotë se aplikohen gjithkund dhe nuk mund t'i mohohen individit madje edhe nëse ai/ajo pajtohet për këtë.

E drejta për të qenë i lirë dhe e drejta e jetës vlerësohet si një ndër vlerat më të rëndësishme njerëzore, të lidhura ngushtë me dinjitetin dhe vlerën e jetës njerëzore.

Të drejtat e njeriut janë parime në bazë të së cilave individët mund të veprojnë, të nxjerrin ligje dhe në të njëjtën kohë të gjykojnë e të marrin vendime që mbështeten në to. Por, të drejtat e njeriut janë në të njëjtën kohë edhe vlera që shprehin dhe pasqyrojnë dëshirat dhe aspiratat njerëzore.

Si vlera, të drejtat e njeriut përfaqësojnë qëllimet dhe idealet më të larta, të cilat, ndonëse të përcaktueshme plotësisht, i japin kuptim jetës shoqërore. Gjatë gjithë historisë së tyre, të drejtat e njeriut janë përcaktuar dhe kanë mishëruar vlerën e dinjitetit të secilit, të lirisë, barazisë dhe drejtësisë.

E DREJTA PËR SHKOLLIM

Njëra nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është edhe e drejta për shkollim. Arsimiti është një e drejtë e pamohueshme, është një nga të drejtat themelore të individit. Duke ia mundur këtë të drejtë, atij i mundësohet e drejta që t'i ushtroj të drejtat e tjera, pasi nëpërmjet ushtrimit të kësaj të drejte, individit ka mundësi të ushtrojë të drejtat e tjera, siç janë ato civile, politike, ekonomike, kulturore. Për të realizuar këtë të drejtë, arsimi duhet të jetë i mundshëm, i arritshëm, i pranueshëm dhe i përshtatshëm. Në këtë mënyrë, arsimi e pajis individin me njohuri, shprehje dhe shkathtësi që e ndihmojnë për të bërë zgjedhjet e duhura në jetë.

E drejta për shkollim ka rëndësi të madhe për njeriun si qenie njerëzore dhe si qenie politike e shoqërore. Kjo ka rëndësi të madhe edhe për shoqërinë përkatëse, ngase paraqet parakushtin themelor për zhvillimin e saj të gjithanshëm, sidomos në kushtet e zhvillimit të hovshëm teknologjik dhe kushtet e kompjuterizimit, që e kanë përfshirë botën. Nëpërmjet kësaj të drejte sigurohen elementet e së drejtës së njeriut që, duke u shkolluar, ta zhvillojë personalitetin e tij dhe të krijojë mundësi për

Liria e besimit,
e ndërgjegjes
dhe e fesë
ngërthen të
drejtën për të
pranuar dhe
për të
manifestuar
fenë

përmbushjen e nevojave, por edhe sendërtimin e të drejtave të tij politike e personale.²

Kur një shoqëri ka bindje të atilla që duhet respektuar njëri-tjetrin, patjetër se edhe mirëqenia brenda saj do vijë në shprehje. Por, që të arrihet kjo, patjetër se duhet pasur një sistem edukativo-arsimor të mirëfilltë, sepse ai është indikator kryesor në krijimin e rrethanave të formimit dhe emancipimit të një shoqërie multi-kulturore.

Të drejtën për shkollim e gjejmë në të gjitha konventat ndërkombëtare, në Kushtetutën dhe Ligjin për Arsim të Kosovës.

Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, neni 26, Pika 1, e këtij neni, i cek disa të drejta të njeriut për shkollim, se çdo njeri ka të drejtë në shkollim pa përjashtim; shkollimi fillor duhet të jetë pa pagesë dhe i detyruar; shkollimi profesional në dispozicion për të gjithë dhe shkollimi i lartë i barabartë për të gjithë me kriter të vetëm,

meritën. Kjo deklaratë kërkon nga shtetet që të ofrojnë për individin arsimin i cili ndihmon në zhvillimin e personalitetit, në respektimin e të drejtave të njeriut, që nxitë në tolerancë, miqësi ndërmjet individëve, popujve, grupeve racore e fetare.

Protokolli i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e drejta për arsimim: "Askujt nuk mund



t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike”.³

Kur është fjala për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe kjo kushtetutë nuk ka mundur t’ju ik ndikimeve të deklaratave për të drejtat e njeriut që brenda saj t’i njoh dhe t’i mbroj të drejtat e njeriut. Kësaj problematike i është dedikuar kapitulli II, që mbanë emërtimin “TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE”. Ky është kapitulli më i vëllimshëm dhe përmban gjithsej 42 nene, duke i detajzuar këto të drejta me ligjet e saj.

Njëerën nga të drejtat themelore që i garanton kushtetuta, është edhe e drejta për shkollim:

“Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike”.

Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj”.⁴

Ligji për Arsimim Parauniversitar në Republikën e Kosovës thotë: “Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social”.⁵

LIRIA E BESIMIT

Besimi apo feja është njëri nga elementet i cili e ka përcjell njerëzimin vazhdimisht që nga kohërat e lashta apo prej kur ekziston njerëzimi, dhe historikisht asnjëherë nuk është gjetur shoqëri apo popull pa besim apo fe. Kjo dëshmon se besimi në diçka që quhet Perëndi, Zot apo qenie absolute është i mbjellë në shpirtin e njeriut, dhe shumë herë gjatë jetës, njeriu e ndjen nevojën që të mbështetet dhe t’i drejtohet këtij Zoti. Prandaj, mohimi apo kufizimi pa të drejt i kësaj të drejte është mohim i një elementi shumë të rëndësishëm të individit, mohim i ndjenjës shpirtërore.

Me lirinë e besimit kuptojmë të drejtën e individit për të besuar një fe ose një tjetër, ose për të mos besuar asnjë, si dhe të drejtën që lirisht e botërisht të shprehë bindjet e veta fetare,

përkatësisht mos të shprehë kurrfarë bindjesh fetare. Kjo njëkohësisht nënkupton të drejtën e njeriut që lirisht të ndjekë ritet dhe ceremonitë e fesë të cilën e beson.⁶

Komiteti për të Drejtat e Njeriut thekson rrethin e gjerë të aktiviteteve që bien brenda fushëveprimit të së drejtës për të manifestuar religjionin apo besimin.

“Observimi dhe ushtrimi i religjionit apo besimit mund të përfshijë jo vetëm aktet ceremoniale, por gjithashtu dhe zakonet e tilla siç është observimi i rregullave dietale, veshja e rrobave dalluese apo mbulesave të kokës, pjesëmarrja në ritualet e bashkuar në fazën e caktuar të jetës, dhe përdorimi i një gjuhe të caktuar, që sipas zakonisht flitet në atë grup”.⁷

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë. “Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar”.

Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ndërthrin të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtar i një bashkësie ose grupi fetar.

Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj”.⁸

Ngjashëm me kushtetutën, edhe ligji për liritë fetare në Kosovë mbron lirinë e besimit.

“Çdo njeri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, qoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive”.⁹

Liria fetare e tejkalon lirinë e ndërgjegjes dhe përfshinë përmbajtje të tilla rregullative, që nuk kanë për qëllim që të tjerëve t’u kumtohet bindja personale fetare. Ajo përfshinë edhe veprimet të cilat, sipas pikëpamjes së bashkësisë së caktuar fetare, u takojnë obligimeve të besimtarëve të vet. Duke u nisur nga kjo, kushtetuta ia garanton secilit lirinë që fenë apo bindjen e vet ta manifestojë nëpërmjet shprehjes fetare, kryerjes së ceremonive fetare, ndjekjes së shërbimit apo mësimi fetar.¹⁰

E drejta e shkollimit dhe liria e besimit dhe manifestimi i atij besimi është i garantuar në instrumentet - dokumentet ndërkombëtare, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në ligjet e saj. Në të gjitha këto garantohet kjo e drejtë, dhe kufizimi i saj (manifestimi i besimit) sipas këtyre mund të bëhet vetëm me ligj dhe vetëm nëse është e domosdoshme me qëllim të mbrojtjes së:

1. Sigurisë; 2. Rendit publik; 3. Shëndetit; 4. Të drejtave të të tjerëve.

Kufizimin e të drejtave themelore, Kushtetuta e parasheh edhe në nenin 55: Kufizimi i të drejtave dhe lirive të përmendura mund të bëhet vetëm me ligj (paragrafi 1);

Të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm deri në masën që është e pashmangshme për arritjen e qëllimit (paragrafi 2);

Kufizimi është i mundshëm vetëm nëse është parashikuar për qëllimet për të cilat kushtetuta e lejon kufizimin (paragrafi 3);

Kufizimi duhet të reduktohet në minimumin, i cili e përmbush qëllimin për të cilin kushtetuta e lejon mundësinë e kufizimit të së drejtës (paragrafi 4);

Natyrisht, gjatë vendosjes së kufijve për të drejtat themelore, duhet pasur kujdes që të vendoset një raport optimal ndërmjet të drejtave themelore dhe të mirave të tjera juridike. Kjo për arsye se kufizimi i të drejtës themelore duhet të jetë i përshtatshëm që t'i mbrojë të mirat e tjera juridike, por nuk bën të shkojë më tutje se ajo që është e domosdoshme. Ai duhet të jetë proporcional, që t'i përgjigjet rëndësisë së të drejtës themelore, që do të thotë se edhe kufizimet e së drejtës themelore duhet t'i kenë kufijtë e tyre.¹¹

Është e arsyeshme që t'i hedhim një vështrim të shkurtër edhe nenit 56 të Kushtetutës mbi të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ku paragrafi 2 i këtij neni ndalon shmangien nga e drejta e lirisë së besimit (shmangie nga neni 38) edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme:

“Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38 të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash”.¹²

Në të vërtetë, liria e shprehjes fetare, e bindjes dhe e ndërgjegjes bën pjesë në kuadër të të drejtave absolute të mbrojtura, dhe kjo është e parashikuar nga regjimi i shmangies në gjendje të jashtëzakonshme (neni 56 paragrafi 2), por tash mbetet i paqartë raporti ndërmjet dispozitës kushtetuese, e cila e ndalon shprehimisht shmangien nga neni 38, përkatësisht nga liria e shprehjes fetare, e besimit dhe e ndërgjegjes, dhe nga ana tjetër, po ashtu dispozita e përmendur kushtetuese (neni 38, paragrafi 4), që lejon kufizimin e kësaj lirie në rrethana të rregullta për shkaqet e përmendura në kushtetutë. Për këtë arsye shtrohet pyetja se a është e mundur që në rrethana të rregullta të kufizohen liritë nga të cilat nuk lejohet shmangia as në gjendje të jashtëzakonshme.¹³

Përfundimisht, edhe pse duket se ekziston një mospajtim ndërmjet neneve të kushtetutës të nenit 38 me nenin 56, ajo që mund të kuptohet është se kufizimi i të drejtave themelore mund të bëhet vetëm me ligj.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, në vitin 2010 nxori udhëzimin administrativ nr. 6/2010, Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta”.

Neni 4 pika 1.13 e këtij udhëzimi, e ka paraparë si veprim të ndaluar “Bartjen e uniformës fetare”.

Drejtoritë e shkollave, në bazë të këtij udhëzimi administrativ u detyruan që vajzat me shami t'i largonin nga shkolla, duke ju mohuar të drejtën e arsimimit për shkak të bindjeve fetare, por njëherësh duke ju shkelur edhe të drejtën e lirisë së besimit (fesë).

Nga e ter kjo mund të konkludojm se kufizimi i të drejtës për shkollim dhe lirisë së besimit me një udhëzim administrativ është në kundërshtim dhe jo në përputhshmëri me kushtetutën dhe aktet-dokumentet ndërkombëtar dhe jo ligjor.

Drejtorët e shkollave nga të cilët janë larguar vajzat me shami, kanë bërë edhe shkelje të vetë këtij udhëzimi administrativ.

Udhëzimi administrativ, me nenin 6 parasheh Masat edukative - disiplinore të cilat mund të shqiptohen ndaj nxënësve të cilët kanë bërë veprime të ndaluara. Sipas po këtij udhëzimi administrativ, drejtori i shkollës mund t'i shqipton vetëm këto masa disiplinore: Vërejtje, vërejtje me shkrim, masën disiplinore pezullim nga garat dhe masën disiplinore pezullim nga shkolla për 3 ditë, ndërsa masën disiplinore pezullim deri në 1 muaj mund ta sjellë vetëm drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA-së), kurse masën disiplinore pezullim mbi një muaj, duke siguruar arsimimin alternativ për nxënësin e pezulluar, dhe vetëm për rastet e rënda të parapara me udhëzim administrativ, e shqipton vetëm Kuvendi Komunal.

1 Kuptimi i të drejtave të njeriut - Doracak mbi arsimimin për të drejtat e njeriut, ETC-Grac, 2003, fq. 18.

2 Dr. Kurtsh Salihu, “E drejta kushtetuese”, Prishtinë, 2004, fq. 232.

3 Protokoll nr.11, neni 2.

4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 47.

5 Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 3 paragrafi 1,2,3.

6 Dr. Kurtsh Salihu, “E drejta kushtetuese”, Prishtinë, 2004, fq. 226.

7 Gudmundur Alfredsson & Asbjørn Eide, Deklarata universale mbi të Drejtat e Njeriut (Standardi i arritjes së përbashkët), fq. 368.

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 38, paragrafi, 1 dhe 2.

9 Ligji për liritë fetare në Kosovë, neni 1 paragrafi 1(1).

10 Dr. Enver Hasani & Dr. Ivan Qukalović, Komentar - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 136.

11 Dr. Enver Hasani & Dr. Ivan Qukalović, Komentar - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 214-215.

12 Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, neni 56, paragrafi 2.

13 Dr. Enver Hasani & Dr. Ivan Qukalović, Komentar - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 136.

Si të sillemi në rrjetet sociale?

Hfz. Mehas Alija



Shikuar nga prizmi i Sheriatit islam, Sdijetarët myslimanë kanë lejuar përdorimin e rrjeteve sociale, me kusht që përdoruesi t'ju përmbahet rregullave dhe bontonit islam. Shfrytëzimi për të mirë dhe përdorimi i drejtë i rrjeteve sociale konsiderohet vepër e mirë dhe sipas rregullave të jurisprudencës islame, hynë në kategorinë e mubahit (të së lejuarës).¹ Kurse esencën e mubahut e paraqet vetë Allahu i Lartë në Kuranin fisnik, ku thotë: “Të pyesin ty se çështje e lejueshme, thuaju: “Ju lejohet juve çdo gjë që është e mirë...”² Në vazhdim, në disa pika, do të sjellim disa mësimet për një përdorim të lejuar, hallall, të këtyre rrjeteve sociale:

QËLLIMI I MIRË DHE I SINQERTË PËR PËRDORIMIN POZITIV TË RRJETEVE SOCIALE

Dije se për të gjithë veprimtarinë, qoftë fetare apo të natyrave profane, nijeti i sinqertë është parakusht për pranimin e veprës. Pra, që vepra të konsiderohet e hairit, pozitive dhe e pranuar te Zoti, kërkohet qasja korrekte dhe qëllimi i pastër i përdorimit të këtyre rrjeteve. Në hadi-thin e Muhamedit a.s. thuhet: “Vërtet, veprat vlerësohen sipas qëllimeve (nijeteve) dhe çdo njeriu i takon ajo që ka pasur për qëllim.”³

RUAJTJA E DEVOTSHMËRISË DHE BINDJA SE ALLAHU SHEH DHE DËGJON

Personi i cili i frikësohet Zotit, i respekton rregullat e vendosura prej Tij. Zoti në Kuranin famëlartë thotë: “Më i ndershmi prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më

Në rrjetet sociale duhet të shmangen të gjitha diskutimet që nuk ofrojnë zgjidhje të përbashkëta dhe që nuk sjellin përfundime të vlefshme e të dobishme

shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”⁴

Një mysliman që është i vetëdijshtëm për Allahun xh.sh., i Cili është i Gjithëditur dhe me Diturinë e Tij e ndjek atë në çdo situatë, e ka të vështirë që rrjetet sociale t'i përdor për qëllime të këqija dhe negative kur ai të jetë i vetmuar dhe larg njerëzve. Zoti i Madhërishëm thotë: “Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç'pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.”⁵

DYSHIMI NDAJ TË TJERËVE PA NDOJË DËSHMI TË QARTË

Një nga rregullat e jetës, por edhe të fikhut islam thotë: “Njeriu është i pafajshëm, derisa të vërtetohet e kundërta, gjegjësisht derisa të vërtetohet fajësia.” Faji në jurisprudencën islame mund të ngritet vetëm përmes dëshmisë të qartë. Askush nuk mund të fajësohet

me diç që është e dyshimtë apo pa ndonjë dëshmi 100% të sigurt. Interneti dhe rrjetet sociale janë vendi ku mund të rrjedhin një mori informacionesh pjesërisht të verifikuara. Në mesin e këtyre informacioneve, ka që janë të paqarta, të pasigurta dhe të dyshimta, të cilat mund të konsiderohen si të gjymta dhe jo të plota. Ekzistojnë grupe të caktuara që plasojnë me qëllim informacione gjysmake, në mënyrë që të shkaktojnë huti dhe dyshime, si dhe të terrorizojnë intelektualisht kundërshtarët e tyre. Për këtë arsye, besimtari duhet të ketë kujdes dhe t'ju shmanget këtyre dyshimeve në rrjetet sociale, ashtu që të mos bëhet pjesë e fushatës virtuale që përhap mundim dhe terrorizëm intelektual. Allahu i



Madhërishëm në Kuranin fisnik thotë: “O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat.”⁶

SPIUNIMI I TË TJERËVE DHE GJURMIMI I TË METAVE TË TYRE

Rregullat dhe standardet që vlejné dhe respektohen në jetën reale, në përditshmëri, për të mos spiunuar dhe për të mos gjurmuar e hulumtuar për të metat e të tjerëve, nuk zbatohen siç duhet edhe në botën virtuale. Përkundrazi, duhet pasur më shumë kujdes në respektimin e rregullave të mirësjelljes, sidomos në botën virtuale, digjitale, pasi që shpejtësia e lajmit dhe e komunikimit në rrjetet sociale mundëson qasjen e lehtë deri te të dhënat personale dhe private, me ç'rast ka mundësi më lehtë të vije deri tek abuzimi dhe keqpërdorimi i tyre. Allahu i Lartë në Kurani fisnik për spiunimin thotë: “...dhe mos e spiunoni njëri-tjetrin.”⁷ Po ashtu, Muhamedi a.s. në lidhje me gjurmimin dhe zbulimin e të metave të të tjerëve është shprehur: “O njerëz, ju që keni besuar vetëm me gjuhë dhe imani juaj akoma nuk ka depërtuar në zemër, mos përgojoni myslimanët dhe mos kërkoni të gjeni të metat e tyre, sepse nëse dikush mundohet të zbulojë të metat e tyre, Allahu do t’ia zbulojë atij të metat e veta dhe nëse Allahu i zbulon të metat e dikujt, Ai e turpëron atë publikisht që ta shohë kushdo, edhe nëse ai e ka fshehur atë në pjesën më intime të shtëpisë së tij.”⁸

PËRGOJIMI DHE BARTJA E FJALËVE NGA TË TJERËT

Përgojimi (gibeti) nënkupton sjelljen e individit që përcjell dhe rrëfen detajet dhe sekretet e të tjerëve, si dhe diskuton me palën e tretë për problemet që nuk u përkasin atyre. Këtu përfshihet edhe përcjellja dhe bartja e fjalëve të huaja. Sa u përket rrjeteve sociale, kjo ndodh kur njerëzit tallen dhe përfolën nëpër mure të profileve, në faqe interneti, portale,

grupe dhe biseda etj.. Nuk kursehen nga përgojimi pjesëtarët nga rrethi i ngushtë shoqëror e familjar, por edhe njerëz dhe personalitete publike, duke harruar se kjo i dëmton rënd, si në personalitet, ashtu edhe në imazh dhe, më e keqja, humbet kohë e vlefshme me gjëra të tilla të ulëta. Allahu i Madhërishëm ka paralajmëruar se një veprim i tillë është i shëmtuar dhe ka kërkuar që të hiqet dorë nga thashethemet dhe përgojimi, duke thënë: “Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun!”⁹

ZILIA PËR SUKSESIN E TË TJERËVE

Zilia apo smira vjen si rezultat i mosdurimit dhe mos akceptimit të suksesit të tjetrit. Tashmë, zakonisht, në rrjetet sociale njerëzit publikojnë dhe shpërndajnë lajmet, aktivitetet dhe sukseset e tyre me miqtë virtualë. Besimtari mysliman e ka të ndaluar që të ketë zili për suksesin e tjetrit, për atë që sheh dhe lexon në muret e profileve të njerëzve të tjerë. Ai e di se një gjë e tillë është e ndaluar dhe se i Dërguari a.s., në lidhje me këtë temë ka thënë: “Mos jini ziliqarë për njëri-tjetrin.”¹⁰ Po ashtu, ai ka thënë: “Ruajuni zilisë! Ajo i djeg të mirat, ashtu si i djeg zjarri drunjtë!”¹¹

DEBATET DHE DISKUTIMET E PANEVOJSHME

Në rrjetet sociale duhet të shmangen të gjitha diskutimet që nuk ofrojnë zgjidhje të përbashkëta dhe që nuk sjellin përfundime të vlefshme e të dobishme, pavarësisht natyrës së temës për të cilën diskutohet apo debatohet, qoftë ajo fetare, politike, kulturore, shoqërore apo ekonomike. Diskutimet e këtilla, pa një qëllim sqarues dhe pa një edeb në qasje, janë të panevojshme dhe të pafrytshme. Në lidhje me këtë, Muhamedi a.s. na ka mësuar kështu: “Mos u grind me vëllain tënd.”¹²

Në raste debati dhe diskutimi, si nëpër media vizive, ashtu edhe në ato të shkruara dhe rrjete sociale, duhet të tregohet një kulturë e lartë mirëkuptimi, me mundësinë për t'i dhënë edhe përparësi tjetrit dhe për t'ia respektuar mendimin. Zoti i Lartë thotë: “Kush bën durim dhe falë, s’ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë (i lavdishëm).”¹³

SHARJA, PËRDORIMI I FJALËVE BASTARDE DHE NXITJA E URREJTJES

Një person me moral dhe sjelle të bukur kujdeset për fjalorin që përdor me secilin njeri dhe në secilën situatë, madje edhe gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Nuk ka dyshim se Islami, si një fe e moralit dhe mirësjelljes, i ka ndaluar sjelljet e pahijshme dhe të neveritshme, në mesin e të cilave bënë pjesë mallkimi, sharja, ofendimi, nënçmimi i tjetrit. Të gjitha këto gjëra konsiderohen mëkat. Muhamedi a.s. në një hadith ka thënë: “Sharja e myslimanit është një mëkat i madh (fusuk).”¹⁴ Ja edhe dy hadithe të tjera që flasin mbi këtë temë: “Besimtari nuk është mallkues, as ofendues dhe as i pistë me gjuhë.”¹⁵ Po ashtu: “Besimtari nuk është njeri që i lëndon të tjerët me fjalë, as nuk mallkon e as nuk shan. Ai nuk është gojëndyrë.”¹⁶ Si përdorues të internetit, bartim përgjegjësi që hapësirën ku veprojmë ta bëjmë të sigurt, pa postime dhe komente të dhunshme, diskriminuese dhe fyese. Në raste të këtilla, duhet të raportohen përmbajtjet e tilla te përgjegjësit e platformave.¹⁷

TË QËNDRUARIT LARG IMORALITETIT

Shoqëria bashkëkohore vlerësohet si një shoqëri kryesisht materiale, ku dominojnë pasionet dhe dëshirat, andaj dhe nuk duhet habitur se përse rrjetet sociale janë të vërshuara me përmbajtje të pamoralshme (imorale). Për më tepër, zhvillimi i internetit ndihmoi në rritjen dhe zhvillimin e industrisë pornografike. Ky biznes, pra me përmbajtje devijante dhe të pamoralshme, u zhvillua aq shumë dhe pati fitime të mëdha, sa që, revista e famshme “Forbes”, e shpalli vitin 2018, si vitin e industrisë pornografike, e cila vlente më shumë se 100 miliardë dollarë.¹⁸ Pasur parasysh këtë, për një besimtar dhe besimtare, është detyrë fetare dhe morale që të qëndrojnë larg këtyre materialeve devijante, të cilat mund të

Informacionet të cilat i marrim nga rrjetet sociale dhe që nuk jemi të sigurt për saktësinë e tyre, duhet të shikohen dhe verifikohen mirë, pavarësisht sinqeritetit dhe besueshmërisë së personit që bënë transmetimin e tyre.

postohen në profile, grupe apo faqe të ndryshme të rrjeteve sociale. Ajo që duhet bërë është pastrimi i listës së miqve dhe të faqeve që frekuentohen, e që përmes tyre ka mundësi të vihet në kontakt me përmbajtje të tilla. Po ashtu, duhet të ketë sa më shumë frekuentim të faqeve me përmbajtje edukative, morale dhe kulturore. Sot në rrjetet sociale i ke hapur të gjitha dyert, si të udhëzimit, ashtu edhe të devijimi. Kurani fisnik na thërret të qëndrojmë larg rrugëve që shpijnë në amoralitet dhe devijimit. Ja se çfarë thotë Allahu xh.sh.: “Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinase), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”¹⁹ E, Muhamedi a.s. na ka mësuar se edhe syri bën mëkat, edhe veshi bën mëkat, sikur edhe organet e tjera që nuk kursehen nga këto materiale dhe objekte imorale.²⁰

GËNJESHTRA DHE PARAQITJA ME PROFILE TË RREJSHME

Gënjeshtra në Islam është rreptësisht e ndaluar dhe kundërshtohet plotësisht me të

vërtetën. I Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., në shumë hadithe ka theksuar se, assesi, nuk mund të bashkohet Islami me gënjeshtrën dhe mashtrimin. Në një prej haditheve të tij thuhet: “Shenjat e mynafikut (dyfytirëshit) janë tri: Kur flet gënjën, kur premton, nuk e përmbush premtimin dhe kur i besohet diçka, tradhton.”²¹

Kur bëhet fjalë për rrjetet sociale, mënyra më e përhapur e gënjeshtrës dhe e mashtrimit shfaqet përmes paraqitjes së njerëzve me profile jo të sakta. Nga të dhëna zyrtare, njoftohemi se vetëm në Facebook ekzistojnë rreth 4% e profileve fiktive, që i bie rreth 88 milionë profile. Arsyet se pse krijohen këto profile mund të jenë të natyrave të ndryshme, por kryesisht dominojnë ato për qëllime të komunikimit anonim, për t’u zbavitur me lojërat online, për t’ju shmangur përgjegjësisë, për shfaqje të reklamës, propagandës, spiunimit, tradhtisë, etj.. Paraqitja e rrejshme në rrjetet sociale, duke krijuar profile fiktive, është një akt mashtrimi dhe bie ndesh me bontonin islam dhe edukatën që promovoi Muhamedi a.s., i cili, për mashtrimin, thotë: “Kush na mashtron, ai nuk është prej nesh.”²² Më e keqja ndodh kur dikush, në emër të fesë dhe të thirrjes islame, paraqitet me emra dhe profile të rrejshme!

VERIFIKIMI I INFORMACIONEVE

Informacionet që qarkullojnë në internet dhe sidomos në rrjetet sociale ka mundësi që të jenë të sakta dhe të pasakta. Për këtë arsye, informacionet të cilat i marrim nga rrjetet sociale dhe që nuk jemi të sigurt për saktësinë e tyre, duhet të shikohen dhe të verifikohen mirë, pavarësisht sinqeritetit dhe besueshmërisë së personit që bënë transmetimin e tyre. Personat e tillë mund të jenë të drejtë dhe të sinqertë, por mund të jenë edhe mashtrues dhe jo të sinqertë. Sa për ata që mashtrojnë dhe janë të pandershëm, për lajmet e tyre, Zoti urdhëron dhe thotë: “O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë!”²³ Ndërsa, arsyeja se pse duhet të verifikohen lajmet dhe informacionet që na vijnë nga persona të besueshëm dhe të ndershëm është se këta, ndoshta nga injoranca dhe nga pa vetëdija, apo edhe të ndikuar nga vërshimi i madh i informacioneve në botën virtuale, mund t'i transmetojnë dhe t'i ndajnë me të tjerët.

POSTIMI I DETAJEVE NGJA JETA PRIVATE PERSONALE DHE FAMILJARE

Rrjetet sociale sot, për shumë përdorues të tyre, janë kthyer në “dritare të hapura”, ku të tjerët mund të shikojnë më shumë se sa duhet nga jeta jonë private, familjare dhe shoqërore. Intimiteti familjar dhe shoqëror ka më pak rëndësi se sa përfitimi i disa llajkave dhe shikimeve. Një numër i madh i përdoruesve të rrjeteve sociale, pa i llogaritur mirë pasojat, postojnë dhe ndajnë me të tjerët detaje nga jeta e tyre private, duke postuar ushqimin e mëngjesit, pastaj të drekës e të darkës, ndejat dhe shëtitjet familjare, madje edhe punët dhe sexhdetë e bëra për hir të Zotit. Shikuar nga prizmi dhe bontoni islam, kjo çështje nuk duhet të merr përmasa të tilla, sa që edhe çështjet private të dalin nga “katër muret” e shtëpisë dhe ambientit familjar. Janë disa aspekte jetësore që duhet të mbeten në domenin privat, brenda intimitetit familjar e shoqëror dhe mos të publikohen pa nevojë në rrjetet sociale. Në lidhje me këtë, Muhamedi a.s. na mëson: “Publikimi i detajeve nga jeta private është e ndaluar (haram).”²⁴

KALIMI I KOHËS NË RRJETET SOCIALE

Shfrytëzimi dhe përdorimi i rrjeteve sociale për qëllime të mira dhe pozitive, sipas këndvështrimit islam, bie në kategorinë e veprave të lejueshme (mubah), sikurse është dëgjimi i radios, gjumi, ngrënia, shëtitja, etj.. Mirëpo, nëse përdoruesi i rrjeteve sociale e tepron, duke harxhuar kohën pa masë apo duke lënë pas dore disa detyrime të tjera (farz), sikur që janë namazet ditore, detyrimet familjare apo puna, atëherë përdorimi i tyre shndërrohet në vepër të ndaluar (haram). Zoti i Madhërishtëm në Kuranin fisnik urdhëron e

thotë: “Dhe mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”²⁵ Pra, myslimani i vërtetë i shfrytëzon në mënyrë racionale të gjitha të mirat dhe veprat e lejueshme (mubah), në këtë rast edhe rrjetet sociale, me bindjen se në Ditën e Llogarisë do të pyetet për secilin moment të jetuar në këtë botë. Pejgamberi a.s., në një prej këshillave të tij të bukura, thotë: “Shfrytëzoi pesë gjëra para pesë të tjerave: Rininë para se të arrijë pleqëria, shëndetin para se të arrijë sëmundja, pasurinë para se të vijë varfëria, kohën e lirë para se të zihesh me punë dhe jetën para se të vijë vdekja!”²⁶ Është e mirë që herë pas here të bëhet një tërheqje nga rrjetet sociale dhe të bëhet një plan i matur mbi kohën që do të kalohet në to. Nuk është e thënë që çdo ditë, në çdo moment, të shqetësohemi me fotografitë apo mendimet e të tjerëve!²⁷

Këto ishin disa udhëzime në lidhje me përdorimin e drejtë të rrugëve moderne të komunikimit, respektivisht të rrjeteve sociale. Njëkohësisht pamë pikëpamjen islame për atë se cila është dispozita fetare e rrjeteve sociale, e komunikimit virtual. Gjithashtu, qëllimi ynë nuk ishte që të ngremë gishtin tregues lart, në shenjë qortimi apo kërcënimi, për të bërë që ju të hidhni mënjatë përdorimin e këtyre mjeteve, por deshëm të japim disa këshilla dhe të sinjalizojmë drejt një përdorimi më të shëndoshë dhe të arsyeshëm të rrjeteve sociale.

1 Jusuf Dzafic, “Islam i društvene mreže”, publikuar në revistën periodike “Muallim”, nr. 74, viti 2018.

2 El Maide, 4.

3 Imam Buhari, *Es-Sahih*, nr. 1.

4 El Huxhurat, 13.

5 Kaf, 16.

6 El Huxhurat, 12.

7 El Huxhurat, 12.

8 Ebu Davudi, *Es-Sunen*, nr. 4880.

9 El Huxhurat, 12.

10 Hadith më i gjatë, shih Buhari, *Es-Sahih*, nr. 6064-6066.

11 Ebu Davudi, shih në: *Rijadus-salihin*, nr. 1569 (versioni elektronik).

12 Hadithin e shënojnë imam Tirmidhi, *Es-Sunen*, nr. 1995; Buhari, *El-Edeb el-mufred*, nr. 394. etj.

13 Esh Shura, 43.

14 Ahmed, *El-Musned*, nr. 3647, 3903, 4126, 4345; Buhari, *Es-Sahih*, nr. 48, 6044, 7076.

15 Ahmedi, Taberani; shih në veprën dr. Muhamed Ali el Hashimi, “*Muslimani Ideal*”, Prishtinë, 2008, f. 237.

16 Buhari, *El-Edeb el-mufred*, nr. 395.

17 “*Ein gesunder Umgang mit Social Media*”, publikuar në linkun: <https://magazin.sofatutor.com/schueler/ein-gesunder-umgang-mit-social-media-so-klappts/> (Tetor, 2022).

18 Ibid., Jusuf Dzafic, “*Islam i društvene mreže*”.

19 El Isra, 32.

20 Shih tek Imam Muslimi.

21 Buhari, *Es-Sahih*, nr. 33; Muslim, *Es-Sahih*, nr. 219-221;

22 Ahmed, *El-Musned*, nr. 5113; Muslim, *Es-Sahih*, nr. 294.

23 El Huxhurat, 6.

24 Ahmed, *Musned*, nr. 11235; El-Bejheki, *Es-Sunen*, nr. 14099.

25 El En'am, 141.

26 Nesaiu, *Es-Sunen*, nr. 11832; Hakimi, *El-Mustedrek*, nr. 7846.

27 Shih në “*Ein gesunder Umgang mit Social Media*”, linku i lartshënuar.

Fenomeni i bullizmit në mjediset shkollore në Kosovë

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Çështja e shpërfaqjes së bullizmit në ambientet e shkollave në Kosovë është bërë një ndër çështjet më të diskutuara së fundi në shoqërinë kosovare. Ndryshimet dhe zhvillimet sociale të cilat kanë ndodhur, si dhe trendët e globalizimit, kanë bërë që krahas tyre të jenë të pranishëm edhe një mori të fenomeneve sociale, të cilat dikur ose kanë qenë të pakta ose thjesht kanë qenë latente. Në anën tjetër, shkolla konsiderohet si “institucion me organizim të veçantë, detyrë themelore e së cilës është realizimi i qëllimeve dhe detyrave të procesit të edukimit”.¹

Në fakt, shkolla është agjensi i dytë i socializimit menjëherë pas familjes, dhe si e tillë ajo ka ndikim në formësimin dhe ndërtimin e personalitetit të individit, e edukon, mëson, ngrit në piedestalet më të larta individin, krijon botëkuptimin kulturor se bota është ngjyra-ngjyra dhe jo vetëm bardhë e zi, si dhe luan rol me rëndësi në përgatitjen e tij/saj për tregun e punës. Gjatë shkollimit, individit përmes komunikimit, bashkëpunimit në grupe, interaktivitet, krijon një raport socializues dhe kulturor me grupmoshat. Krahas kësaj, shpeshherë nxënësit edhe bullizohen në forma dhe mënyra të ndryshme. Andaj, kemi parë që bullizmi është bërë një dukuri negative e shoqërisë, e cila është shfaqur dukshëm së fundi në mjedisin kosovar. Bullizmi është formë e ngacmimit, i cili vë në siklet tjetrin ose tjetrën dhe ai mund të manifestohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Ai ndodhë atëherë kur një person ushtron një pushtet mbi tjetrin/ren me dashje dhe në mënyrë të përsëritur.

TIPAT - LLOJET E BULLIZMIT


Ngacmimi fizik ose ‘drejtpërdrejt’ e lëndon një individ në një mënyrë të prekshme, por veprimet ‘indirekte’ si vjedhja ose dëmtimi i sendeve të tyre mund të lëndojnë atë



emocionalisht. Kjo vlen edhe për bullizmin verbal, i cili përfshin sharje ose fyerje ose poshtërim në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthort. Ngacmimi relacional ose social i referohet sjelljeve që prishin marrëdhëniet e viktimave me bashkëmoshatarët e tyre (cituar nga Crick dhe Grotpeter, 1995), të tilla si përjashtimi social ose përhapja e thashethemeve. Ngacmimi mund të motivohet nga raca, feja, kultura, gjinia ose seksualiteti, madje ky i fundit mund të përfshijë edhe akte ose kërkesa seksuale.² Po ashtu, bullizmi mund të jetë edhe bullizëm virtual, ku nxënësit ose fëmijët ngacmohen përmes qasjes virtuale, përmes shantazheve, përqeshjes, ngacmimit, dhunës virtuale apo formave të tjera.


BULLIZMI DHE MJEDISI SOCIAL NË SHKOLLAT E KOSOVËS

Fenomeni i bullizmit së fundi është rritur dukshëm në shoqëri, sidomos në ambientet shkollore, ku raportohet për prezencën e këtij fenomeni, edhe pse në fakt të dhënat janë të pakta për shkak të mungesës së hulumtimeve, por edhe raportimeve nga vetë viktimat. Studimet vëzhguese kanë konstatuar se bashkëmoshatarët kanë qenë dëshmitarë të rreth 85 deri në 88% të situatave të bullizmit, por kanë ndërhyrë shumë rrallë, vetëm në 10 deri në 25% të situatave të bullizmit³. Në rastin e Kosovës, shohim që të dhënat janë të pakta në këtë drejtim, megjithëse sipas një hulumtimi të bërë nga organizatave jo qeveritare, Pyper, del se bullizmi është goxha i pranishëm në mjediset shkollore, sidomos atë të mesëm, gjë që ndërlidhet ngushtë me moshën pubertetit dhe zhvillimin psiko – motorik të adoleshencës. Këto të dhëna janë paraqitur, si vijon:



Grafikoni 1:

Prezenca e bullizmit në institucionet arsimore sipas hulumtimit të Pyper-it⁴



Grafikoni 2: Llojet e bullizmit të pranishëm në mjediset shkollore sipas hulumtimit të Pyper-it⁶.

Vërehet se “prej të gjitha institucioneve arsimore, pjesëmarrësit konsiderojnë se dukuria e bullizmit më së shumti është e pranishme në shkollat e mesme (58.31%) dhe shkollat fillore (31.94%) si dhe në një përqindje më të vogël në universitet/kolegj (4.37%). Po ashtu, vlen të theksohet se prej të gjitha llojeve të pranishme të bullizmit në Kosovë, bullizmi verbal (55.79%) është konsideruar si lloji më prezent i bullizmit nga pjesëmarrësit, duke lënë pas atë kibernetik (25.16%), si dhe fizik (17.91%)”⁵, të dhëna këto të cilat i kemi paraqitur në grafikonin e mëposhtëm, si vijon:

Nga këto të dhëna del se bullizmi si fenomen social është i pranishëm në çdo hapësirë edukative-arsimore, si në ciklin e nivelit të ulët, po ashtu edhe në atë të lartë, por ajo që është më shqetësuese është prezenca e tij në ciklin e nivelit fillor me 31.94% dhe atij të mesëm 58.31%, gjë që paraqet një problem serioz për nxënësit në këto cikle.



SHKAQET E BULLIZMIT

Shkaqet e bullizmit në mjediset shkollore mund të jenë të ndryshme dhe kjo varet dukshëm edhe nga rrethanat sociale. Studimet nënvizojnë se megjithatë ka disa faktorë në këtë segment. Ma (2001), zgjeroi njohuritë rreth ciklit të bullizmit të viktimave dhe “argumentoi se gjinia, statusi efektiv socio-ekonomik, shëndeti fizik, të gjitha kontribuuan në ciklin e bullizmit të viktimës. Ndonëse kujdesi prindëror, statusi i tyre socio-ekonomik, numri i vëllezërve e motrave, sistemi familjar dhe kushtet akademike u konsideruan se kontribuojnë gjithashtu në një masë të madhe në ciklin e bullizmit të viktimave, studiuesit treguan se këta faktorë nuk kanë asnjë efekt të mundshëm për nxënësit e asnjë klase”.⁷ Gjithashtu, sipas *Fingerprint for Success*, e cila është një platformë zhvillimi profesional dhe personal për individë, disa nga faktorët kryesorë të shpërfaqjes së bullizmit janë:

- *Ngacmimi i vetes* - Dikush që bullizon të tjerët mund të ketë përjetuar ngacmim/bullizëm - ndoshta nga prindërit e tyre, nga vëllezërit e motrat e tyre abuzues/e, apo edhe nga dikush në lagjen e tyre. Ngacmuesve shpesh u mungon empatia.

- *Kërkimi i vëmendjes sociale nëpërmjet vetmisë*: Bullistët janë shpeshherë të vetmuar. Ata/ato nuk kanë miq të vërtetë.

- *Frustrimi ose xhelozia* - Bullistët mund të ngacmojnë njerëzit që po bëjnë një punë më mirë se ata/ato në diçka tjetër, qoftë në nota, arritje atletike ose promovime në punë. Bullizuesit, synojnë të minojnë aftësitë e personit tjetër me akte agresioni vetëm për të barazuar fushën e lojës.

- *Turpi* - Kjo ndodh kur personi që ngacmon ka turp nga intelektu i ulët ose mungesa e aftësisë për të pasur sukses në çdo gjë që përpiqet.

- *Mosmarrëveshjet* - Shpesh në diskursin online, një mosmarrëveshje e thjeshtë mund të shndërrohet nga një person si “urrejtje”.

PASOJAT E BULLIZMIT

Sipas ueb faqes elektronike ‘stopbullying.gov’ efektet e bullizmit mund të jenë:

- *Efektet psikologjike* - depresioni, ankthi, vetëvlerësimi i ulët, sjellja vetë-dëmtuese (veçanërisht për vajzat), përdorimi dhe varësia e alkoolit dhe drogës, agresioni dhe përfshirja në dhunë ose krim (veçanërisht për djemtë);

- *Efektet fizike* - efektet fizike të ngacmimit mund të jenë të dukshme dhe të menjëhershme, siç është lëndimi nga sulmi fizik.

Institucionet fetare luajnë një rol me rëndësi në preventivën e bullizmit në ambientet shkollore.

- *Efektet akademike* - hulumtimet kanë treguar vazhdimisht se ngacmimi mund të ketë një ndikim negativ në rrugën e fëmijëve dhe adoleshentëve drejt shkollës.⁸

ROLI I INSTITUCIONEVE FETARE NË PREVENTIVËN E BULLIZMIT

Institucionet fetare luajnë një rol me rëndësi në preventivën e bullizmit në ambientet shkollore. Ndër këto institucione padyshim se janë edhe objektet e kultit, të cilat përmes shërbimeve dhe ligjëratave javore, liderët në komunitetin fetar mund të kultivojnë si mesazhet tolerante të besimeve të tyre fetare përmes:

- *Modelimit dhe mesazheve*;
- *Krijimi i një strehe të sigurt*;
- *Ndihma për familjet që të përballen me bullizmin*;
- *Mentorimi i të rinjve në komunitet*.⁹

Në kontekstin kosovar, marrë parasysh numrin e të rinjve që frekuentojnë objektet e kultit, sidomos ato islame, ligjëratat javore mund të jenë të dobishme për ngritjen e vetëdijes shoqërore për bullizmin, si masë preventive ndaj këtij fenomeni.

- 1 Krasniqi, Islam & Deva-Zuna, Afërdita: “Një shkollë pa dhunë - Si ta bëjmë”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2012, fq. 36.
- 2 James, Alana: “School Bullying”, (Goldsmiths, University of London, NSPCC) – NSPCC, London, 2010, fq. 5, shih: https://www.researchgate.net/publication/264166903_School_bullying.
- 3 Danuza, Teuta: “Bullizmi në Shkollë”, Migron, Prishtinë, 2021, fq. 44.
- 4 Pyper “Bullizmi i pranishëm në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë”, Hulumtim i zhvilluar botuar në: www.telegrafi.com me 19.02.2022, shih: <https://telegrafi.com/bulizmi-pranishem-ne-te-gjitha-nivelet-e-sistemit-arsimor-ne-kosove/> dhe qasur me datë: 17.10.2022.
- 5 Po aty.
- 6 Pyper “Bullizmi i pranishëm në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë”, Hulumtim i zhvilluar botuar në: www.telegrafi.com me 19.02.2022, shih: <https://telegrafi.com/bulizmi-pranishem-ne-te-gjitha-nivelet-e-sistemit-arsimor-ne-kosove/> dhe qasur me datë: 17.10.2022.
- 7 Jan, Afroz & Husain, Shafqat: “Bullying in Elementary Schools: Its Causes and Effects on Students”, Journal of Education and Practice, Issue 18, 2015, fq. 45.
- 8 Stopbullying.gov I: “The Consequences of Bullying.”, FACT SHEET, USA, 2017, fq. 2. This product was created under Abt Associates, Contract No. HHSH250201600025G funded by the Maternal and Child Health Bureau, Health, <https://www.stopbullying.gov/sites/default/files/2017-10/consequences-of-bullying-fact-sheet.pdf>
- 9 Stopbullying.gov II: “Understanding the Roles of Faith Leaders in Community-Wide Bullying Prevention Efforts”, FACT SHEET - The Consequences of Bullying, USA, 2017, fq. 2. This product was created under Abt Associates, Contract No. HHSH250201600025G funded by the Maternal and Child Health Bureau, Health, <https://www.stopbullying.gov/sites/default/files/2017-10/consequences-of-bullying-fact-sheet.pdf>.

Laiciteti i institucioneve publike arsimore

Mimoza Sinani

Diversiteti fetar dhe kulturor i një shoqërie duhet kuptuar si një pasuri që duhet përqafuar dhe promovuar. Qëllimet dhe objektivat të cilat duhet t'i orientojnë shoqëritë e sotme demokratike duhet të jenë multikulturalizmi dhe gjithëpërfshirja.

Qëndrimet e një pjese të klasës sonë intelektuale, qoftë ajo akademike apo politike, flasin për një mentalitet përjashtues që mendon se ka të drejtë t'i imponohet individit në mënyrë arbitrare dhe e shikon atë ose si subjekt që duhet t'i nënshtrohet verdiktit të saj, ose të vetëpërrjashtohet. Kjo shtresë i referohet një amalgame ligjesh të kulturave juridike perëndimore dhe mundohet t'i injekttojë ato në shoqëri, pa i studiuar mirë dhe pa i përshtatur me traditat dhe kushtet aktuale të vendit.

Politikanët vendimmarrës nuk duhet të imponojnë modele arbitrare në marrëdhëniet fe-shoqëri, pa u kujdesur për një konsensus që vjen përmes debatit të mirëfilltë publik dhe konsultimit me shoqërinë civile. Ky konsensus duhet arrihet nëpërmjet një procesi të hapur dialogues, ku palët dialogojnë dhe nuk e stigmatizojnë njëri-tjetrin.

Dallimet ndërmjet koncepteve 'laik' dhe 'shekullar'

Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe thotë se: "Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare",¹ ndërsa në gjuhën angleze thuhet: "The Republic of Kosovo is a secular state and is neutral in matters of religious beliefs",² pra, Kosova është shtet shekullar.

Në fjalorë të ndryshëm anglisht-shqip, fjala angleze "secular" përkthehet si "laik", mbasi këto nocione kanë një sinonimi mes tyre. Por, nga pikëpamja përmbajtësore dhe ideologjike ato kanë konotacione të ndryshme. Në mjaft raste këta dy terma ngatërrohen me njëri-tjetrin dhe në

Laicizmi dhe shekullarizmi nuk janë besime apo ideologji, por struktura legislative. Ato nuk mund t'i identifikojmë me ndonjë ideologji apo pikëpamjeje kundrejt botës.

vend të laicizmit përdoret shekullarizmi dhe anasjelltas.

Vetë laicizmi dhe shekullarizmi nuk janë besime apo ideologji, por struktura legislative. Ato nuk mund t'i identifikojmë me ndonjë ideologji apo pikëpamje kundrejt botës, sikurse janë për shembull: materializmi, realizmi, natyralizmi, ekzistencializmi etj.

Shpeshherë shekullarizmi kuptohet si ndarja e shtetit nga feja, por në fakt, në shekullarizëm kemi të bëjmë me një bashkëpunim të shtetit me shoqërinë civile dhe institucionin e fesë.

Një botëkuptim të këtillë të shekullarizmit politik e kemi në Angli, Amerikë, etj., kurse laicizmi, veçanërisht ai francez, nënkupton ndarjen e shtetit nga feja, por jo edhe të fesë nga politika dhe shoqëria. Me laicizëm ndalohet të ketë 'fe shtetërore' dhe 'shtet fetar'. Laicizmi i vërtetë arriti të instalohet vetëm në Francë, që njihet edhe si vendi i celulës së përhapjes së laicizmit, apo ndryshe edhe si djepi i laicizmit, që ishte produkt i Revolucionit Francez.

PËRJASHTIMI NËN PETKUN E LAICIZMIT

Shkolla publike është vendi ku fëmijët socializohen dhe laiciteti garantohet nga mungesa e promovimit në programet mësimore të superioritetit të një feje ndaj një tjetre.

Largimi i besimtareve të fesë islame nga institucionet arsimore të vendit, për shkak të mbajtjes së shamisë, përbën një shqetësim të madh. Laiciteti është kuptuar si një hapësirë publike, ku gjithçka duhet të zhvishet nga dimensionin fetar. Individi, që të marrë pjesë në hapësirën publike, duhet të heqë dorë nga besimi i tij, apo i saj fetar dhe ky laicizëm përjashtues në institucionet publike arsimore rrezikon të zhvlerësojë në sistemin e edukimit një ndër vlerat më kryesore, siç është ajo e respektit për kulturën, fenë dhe mendimin e tjetrit.

Në rastin e vajzave që largohen nga shkolla, sepse mbajnë shami, njerëzit pozicionohen në dy taborë të kundërt: ‘ne’ dhe ‘ata’. Këto raste janë bërë objekt i debateve mediatike. Opinioni publik, në përgjithësi, e ka mbështetur dëshirën e vajzave që të shkollohen në sistemin e arsimit publik, ndërsa administratat e shkollave kanë mbajtur një qëndrim të ngurtë, të justifikuar me rregulloren e shkollës që nuk lejon mbajtjen e “simboleve fetare”. Shamia myslimane nuk përbën simbol të Islamit. Feja islame nuk ka asnjë simbol të njohur zyrtarisht si i tillë. Simboli është diçka konkrete që shpreh përmbajtjen e domethënies së një ideologjie. Ai i ka të përcaktuara karakteristikat e veta dalluese: ngjyrën, formën, përmasat. Ndërsa shamia myslimane nuk ka ndonjë formë, ngjyrë, apo përmasë të përcaktuar etj. Ajo është element i besimit dhe gëzon atributin e një detyrimi fetar të panegociueshëm. Në besimet e tjera simbolika të tilla nuk e gëzojnë këtë status.

Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit të Kosovës, me të cilin nxënëseve u ndalohet bartja e ‘uniformës fetare’ në objektet e institucioneve arsimore, u perceptua si ruajtje e laicizmit të Kosovës. Asnjë kushtetutë e vendeve që pretendojnë të jenë demokratike nuk mund ta kundërshtojë ose të mos e marrë parasysh parimin madhor të së drejtës së besimit. Liria e besimit është vlerë më madhore sesa laiciteti i institucioneve publike arsimore.

Shoqërisë sonë nuk i vjen asnjë e mirë nga etiketimi i pabazë dhe i pavend i besimtarëve të fesë islame dhe përjashtimi i tyre i padrejtë nga hapësira publike. Në vend të ngritjes së kufijve ndarës për ‘tjetrin’ të ndryshëm nga ‘unë’, duhet të promovohet, përkrahet dhe stimulohet bashkëbisedimi komunikues dhe integruar.

KEQKUPTIMI I KONCEPTIT TË LAICITETIT

Ekziston një keqkuptim i thellë i konceptit të laicitetit si një qëndrim antifetar, apo kundër fesë.

Ky është një konceptim që laicitetin e kupton si ateizëm, ose si agnosticizëm. Laikja nuk është ateizëm, por është një ndarje e shtetit nga feja. Laiciteti qëndron në garantimin e bashkëjetesës fetare, por ky nuk duhet kuptuar si një laicitet që ngrihet mbi fobinë ndaj fesë.

T’i ndalosh besimtarët të shfaqin besimin e tyre në hapësirën publike, do të thotë të sillesh si një aktor antifetar dhe ateist (ose agnostik) dhe jo si një aktor laik. Rrjedhimisht, laicizmi nuk duhet të perceptohet si një mekanizëm i ndërtuar për të përjashtuar besimet nga mjediset publike por



si një rregullator që ruan balancat e diversitetit fetar.

Laiciteti do të thotë ndarje e shtetit nga feja dhe jo luftë e shtetit me fenë. Kjo ndarje nënkupton që shteti nuk përkrah apo nuk mbështet asnjë pikëpamje fetare. Pra, shteti është neutral në çështjet e religjionit dhe të besimit dhe kjo nënkupton gjithashtu edhe trajtimin e barabartë të

të gjithë qytetarëve të tij, pa marrë parasysh fenë e tyre dhe numrin e tyre në një komunitet, duke e respektuar plotësisht lirinë e mendimit.

Laiciteti nënkupton lehtësira të barabarta për të gjitha fetë, pa përqafuar dhe pa predikuar asnjërin prej tyre. Kjo do të thotë që institucionet shtetërore nuk duhet të vendosin simbole fetare në hapësirën e tyre. Sa i takon qytetarëve, ata gjenden në pozita krejt të ndryshme nga shteti dhe pushtetet publike në përgjithësi. Ata janë njerëz të lirë, të cilëve kushtetuta ua lejon dhe ua njeh të drejtën e lirisë së besimit. Njëherazi, u garanton atyre që ta shprehin besimin e tyre lirshëm në publik, gjithmonë duke respektuar edhe të drejtat e të tjerëve. Shteti, duke qenë laik, është i detyruar të shfaqë paanshmërinë e tij, por nga ana tjetër, qytetarët janë të lirë të përzgjedhin besimin fetar apo bindjet e tyre jofetare.

MORALI FETAR ËSHTË ZGJIDHJA E TË GJITHA VËSHTIRËSIVE

Vetëm vlerat e fesë sigurojnë përsosjen e moraleve të shoqërive dhe individëve. Rrugëzgjidhja për zgjidhjen e problemeve të shumta nuk gjendet në ndalimi i fesë, por krejt e kundërta: ajo duhet kërkuar të përpjekjet për përhapjen e virtyteve fetare.

Njerëzimi nuk duhet të ketë kurrë frikë nga feja, por nga mungesa e saj. Morali fetar i sjell shoqërisë paqe, mirëqenie, drejtësi dhe tolerancë. Në një shoqëri ku ndjenja e fesë është e fortë, nuk mund të ketë dhunë, degjenerim apo frikë. Inkorporimi i fesë hyjnore në sistemin arsimor është i domosdoshëm. Lënda fetare është pjesë përbërëse e planprogramit mësimor në shkollat shtetërore të dyzet shteteve të Evropës dhe shpresojmë që së shpejti ajo të bëhet pjesë përbërëse e planprogramit mësimor edhe në shkollat tona, këtu në Kosovë.

1 https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves.pdf

2 <https://aceproject.org/ero-en/regions/europe/KS/constitution-of-the-republic-of-kosovo/view>



Kampionati Botëror “Qatar 2022”, spektakël sportiv apo mundësi e njohjes me Islamin

Kasim Gërbeshi

SI U CAKTUA KATARI NIKOQIR I KAMPIONATIT BOTËROR DHE CILAT JANË SPECIFIKAT?

Në kongresin e FIFA-së, të mbajtur në Francë, në vitin 2010, u hodh shorti për nikoqirin e Kampionatit Botëror 2022, ku me shumicën e votave, shteti i Katarit fitoi të drejtën, andaj kompeticioni më i madh botëror i futbollit, është duke u zhvilluar në shtetin e gadishullit arabik, në Katar.¹

Sipas shumë ekspertëve të sportit, njëkohësisht zyrtarëve të shtëpisë më të madhe të futbollit – FIFA-së dhe shumë mediave botërore, temperaturat e lartat janë një nga problemet më të mëdha për zhvillimin e Kampionatit Botëror në këtë shtet.²

Mirëpo, investimi marramendës i shtetit të Katarit, për të realizuar një kompeticion siç është Kampionati Botëror, me anë të instalimeve të ventilatorëve apo klimatikëve të ndryshëm, do të arrijë edhe në zvogëlimin e vapës së madhe.³



Përveç kësaj, kryeministri i atëhershëm i Katarit, sheikh Hamad bin Jassim al-Thani, premtoi se do të ndërtojë 7 stadione të reja, pasi që një stadium, i cili i plotësonte kriteret e FIFA-s, e posedonin edhe më herët.

Njëri nga 8 stadiumet e ndërtuara, (stadiumi 974) është i ndërtuar i tëri nga kontejnerët, njëkohësisht është përfolur që do t'i dhurohet në formë dhurate shtetit të Kosovës, e që ka nevojë të madhe për një stadium me standarde të atij llojit.

SI MUND TË SHËRBEJË NJË KAMPIONAT SPORTIV, SI RAST NJOHJE ME ISLAMIN?

Duke pasur parasysh që Katar është një shtet islam, atëherë që nga ceremonia e hapjes së këtij kampionati, mbizotëronte një aromë fetare, ku edhe filloi me citimin e ajetit të 13-të, të sures Huxhurat: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur, e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”

Pjesë e ceremonisë hapëse, ishte edhe aktori i njohur, Morgan Freeman, ku gjatë fjalimit të tij, përçoi mesazhe për unitet dhe bashkim.

“Ne mblidhemi këtu si një fis i madh dhe Toka është tenda në të cilën jetojmë të gjithë” - ishin disa nga fjalët e aktorit të njohur amerikan.

Ghanim al-Muftah, ambasadori i Kampionatit Botëror, një djalosh me aftësi të kufizuar, ishte gjithashtu pjesë e ceremonisë hapëse, i cili, nën hijen e ajetit, bënte thirrje për pikat e përbashkëta e universale ndërmjet njerëzve dhe detyrimin e njohjes ndërmjet tyre.

Para se të fillonte ky kompeticion, zyrtarët e lartë të Katarit, kanë paralajmëruar shtëpinë e madhe të futbollit – FIFA-n, se disa veprime do të ndalohen, ndër to: prija e alkoolit, veprimet e shthurura e perversiteti amoral, provokimet e

ndryshme, sharja apo fjalët ofenduese, mos respektimi i vendeve të adhurimit, muzika shurdhuese dhe fotografimi i njerëzve pa lejen e tyre. Këto ndalesa të vendosura nga Katari, janë të aprovuara edhe nga shtëpia e madhe e futbollit - FIFA.⁴ Vendimet e tilla natyrisht se nuk është që iu kanë pëlqyer një pjesë të madhe të ithtarëve të këtij sporti, meqë ata nuk janë mësuar me respektimin e një disipline të tillë.

Megjithatë, presidenti i tanishëm i FIFA-s, Gianni Infantino, ka mbajtur një konferencë për media, një ditë para se të fillonte kompeticioni, duke u arsyetuar dhe duke thënë se duhen respektuar këto rregulla.

Infantino e filloi konferencën duke thënë: “Përpara se të fillojmë t’u japim mësimë morale njerëzve, unë mendoj se për atë që ne evropianët kemi bërë 3000 e fundit, duhet të kërkojmë falje për 3000 vjetët e ardhshme.”⁵

Ai ka arsyetuar vendimin e ndalimit të pirjes së alkoolit në ambientet e stadiumit, duke thënë: “Nëse nuk mund të pish birrë për tri orë, mendoj se mund të mbijetosh. Ka shumë vende që ndalojnë alkoolin në stadione, siç është Franca, por duke qenë se Katari është një vend mysliman, ky është një problem.”⁶

Në shtetin e Katarit, ekziston ligji për tolerancën fetare, i cili dënon ofendimin e Islamit, Krishterimit dhe Jehudizmit.

Qarkullimi i teksteve që provokojnë mosmarrëveshje fetare ose përmbajnë materiale që shpifin njërin nga këto tri fe, është një veprë e dënueshme. Qeveria e Katarit monitoron dhe censuron faqet e internetit, gazetatat, revistat dhe librat nëse ato veçse shfaqin përmbajtje që konsiderohen nënçmuese të këtyre feve.

Gjatë Kampionatit Botëror, vërejmë se ka një rend, i cili në thelb ka promovimin e vlerave të Islamit, ngaqë në dhomat e hoteleve të ndryshme në Katar, gjithandej ekziston nga një barkod (QR Code), nëpërmes të cilit shpërfaqen disa mësimë të shkurta fetare, hadithe profetike dhe një përmbledhje e shkurtër rreth fesë islame.

Zyrtarët shtetëror kanë urdhëruar që në çdo xhami afër stadioneve të thërritet ezani nga zërat më të bukur të myezinëve të shtetit të tyre, në mënyrë që zëri i tyre të jetë një arsye që tifozët e huaj të mahnitën nga zëri i bukur dhe të shprehin interesim për fenë islame. Përveç kësaj, janë vendosur zmadhues të zërit në çdo cep të 8 stadioneve ku zhvillohen ndeshjet e Kampionatit Botëror.

Gjithashtu, një ekip i madh i të punësuarve do të jenë pritës të mysafirëve në qendrën e tifozëve (Qatar Guest Center), të cilët janë të përgatitur për të prezantuar Islamin, në mënyrë që popujt e ndryshëm ta njohin më mirë fenë islame dhe t'i



largojnë paragjykimet dhe perceptimet e gabuara ndaj kësaj feje dhe myslimanëve në përgjithësi, njëkohësisht janë ftuar edhe shumë dijetarë, të cilët do të organizojnë tribuna e tryeza të ndryshme me tematika islame.⁷

Përveç kësaj, nën patronatin e Ministrisë së Vakëfit në Katar, është organizuar një ekspozitë për prezantimin e historisë dhe qytetërimit islam, e cila është e përkthyer në disa gjuhë të ndryshme.

Rezultatet e këtij organizimi, janë duke reflektuar pozitivisht që nga dita e parë.

Shkëmbimet e kulturave janë përhapur apo zgjeruar me metoda të ndryshme, duke mbuluar botën me kulturë, shkencë, emigrim dhe metoda të ndryshme bashkëkohore. Pas kësaj, mund të themi se një nga metodat e shkëmbimeve apo njohjeve të kulturave të ndryshme, mund të jenë edhe organizimet sportive, siç është edhe formati i Kampionatit Botëror. Nëse jo të tjerët para tij, ky kampionat nuk konsiderohet vetëm ngjarje e thjesht sportive, për më tepër është organizim ndërkulturor e civilizues, që në një botë të rrëmbyer nga stuhia e mosdurimit të tjetrit, duket se formati i tillë do të jetë tejet i bukur.

1 <https://www.fifa.com/about-fifa/organisation/fifa-council/media-releases/fifa-council-appoints-qatar-as-host-of-the-fifa-club-world-cup-in-2019-and-2020>

2 <https://www.reuters.com/lifestyle/sports/players-risk-suffering-heat-stroke-qatar-during-world-cup-says-physiologist-2022-11-17/>

3 <https://www.qatar2022.qa/en/news/qatars-revolutionary-stadium-cooling-technology>

4 <https://sportstar.thehindu.com/football/fifa-world-cup/news/qatar-world-cup-2022-stadiums-fans-code-of-conduct-fifa-strict-rules-shirts-alcohol-vuvuzelas/article66163522.ece>

5 <https://www.youtube.com/watch?v=Xq5RzV8dj8Y>

6 <https://www.youtube.com/watch?v=Xq5RzV8dj8Y>

7 <https://economictimes.indiatimes.com/news/india/fifa-world-cup-2022-hate-preacher-zakir-naik-in-qatar-to-give-talks-during-wc/videoshow/95651189.cms>

MYFTIU TËRNAVA: “DHUNA NDAJ KUJTDQ QOFTË ËSHTË E PAPRANUESHME, E AQ MË TEPËR NDAJ NJË TË MOSHUARE, NJË NËNE A NJË GJYSHEJE”

Dhe në shenjë mëshire, shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.” (El-Isra, 24)

Publikimi i pamjeve të dhunimit ndaj një të moshuarje në një institucion kujdesi për të moshuarit, na la të gjithëve të shtangur e me një shije të hidhur pezmi e indinjate. Dhuna ndaj kujtdo qoftë është e papranueshme, e aq më tepër ndaj një të moshuarje, një nëne a një gjysheje, e cila në rrethanat në të cilat e ka përplasur jeta ka përfunduar në atë institucion. E kemi për detyrë e obligim, e kemi farz para Zotit, para shoqërisë, e për të mirën e pasardhësve, që ta arsimojmë e edukojmë shoqërinë, të kultivojmë ahlak, mirësi, mirëkuptim e ngrohtësi. Një shoqërie të arsimuar apo një brezi të arsimuar gjithësesi se i duhen edhe ndërgjegjja, ndjesia shpirtërore, ndjesia për familjen, komunitetin e shoqërinë. Këto veti e këto premisa i arrijmë vetëm atëherë kur ta kemi kuptuar drejt rolin e familjes, rolin e shpirtërores, humanes, rolin e ahlakut e edebit në ndërtimin, rritjen dhe formësimin e shoqërisë. Krijuesi i gjithësisë na udhëzon që ta duam e ta respektojmë njëri-tjetrin, të kujdesemi për njëri-tjetrin, ta ruajmë e të kujdesemi për të varfrin dhe për të gjithë ata që kanë nevojë. Këto mësim e premisa na i kanë lënë amanet peygamberët e Zotit, na i kanë mësuar e transmetuar ulematë e dijetarët e ndershëm dhe ndër shekuj i ka kultivuar edhe populli ynë në mënyrën më të mirë të mundshme, ani pse është përballur me vështirësitë nga më të mëdhatë. Pa dashur që të zgjatem, dua të them se nëse duam



një shoqëri të edukuar e me ndjesi e përgjegjësi, siç na ka mësuar Krijuesi ynë, me profesionalizëm të përgjegjshëm e me ndërgjegje e korrektësi, nevojitet që t'i kthehemi familjeve, fëmijëve e komuniteteve tona, që t'i mësojmë në shtëpitë, shkollat e xhamitë tona, se si praktikisht duhen respektuar e dashur ata, se si duhet të jemi të mëshirshëm e zemërmirë ndaj tyre, gjithnjë duke kultivuar e forcuar besimin në Krijuesin e gjithësisë. Të gjithë ne duhet të kontribuojmë e të angazhohemi për edukimin e shoqërisë.

Zoti na ndihmoftë e na mëshiroftë!

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë

MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË PIRINAZ DHE XHAMISË SË ÇARSHISË NË PRISHTINË

Më 4 nëntor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, pa nga afër punimet në renovimin e xhamisë “Pirinaz” në Prishtinë. Myftiu Tërnavë tha se deri më tani, renovimi i kësaj xhamie është duke shkuar sipas planit të paraparë, për çka u nda i kënaqur me ecurinë e punëve.

Kurse, më 8 nëntor 2022, Myftiu Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka parë nga afër punimet në restaurimin e xhamisë “Sulltan Murat – Xhamia e Çarshisë” në Prishtinë. Ai u njoftua nga përgjegjësit për restaurimin rreth ecurive dhe mbarëvajtjes së punëve, për të cilat thanë se janë duke shkuar me një ritëm të mirë, përkundër sfidave të më hershme. Myftiu Tërnavë, me këtë rast, tha se restaurimi i saj, do ta bëjë atë që të jetë në funksion të besimtarëve tanë, marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka kjo xhami për vendin tonë. (R.S.)



MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË QENDRORE NË PRISHTINË

Më 8 nëntor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka parë nga afër punimet në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite, në shoqërim të Myftiut Tërnavë ishte edhe këshilltari për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë, Bunyamin Albayrak. Myftiu Tërnavë u shpreh i kënaqur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e punëve, duke u shprehur kështu se gjithçka në ndërtimin e kësaj xhamie është duke shkuar sipas planit të paraparë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMIN E XHAMISË “BESIMI” NË BRUKSEL, NUHI EF. SHAQIRIN

Më 15 nëntor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës Ekrem ef. Simnica, pritën në takim imamin e xhamisë “Besimi” në Bruksel, Nuhi ef. Shaqirin. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë shprehu falënderime për imamin Nuhi ef. Shaqiri, por edhe për tërë diasporën që pa kursyer asnjëherë kanë ofruar dhe ende po ofrojnë ndihmë për Kosovën. Myftiu Tërnavë çmoi lart punën dhe angazhimin e kësaj xhamie. Ai edhe një herë përsëriti faktin se Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës vazhdimisht ka mbështetur dhe mbështet mërgatën tonë kudo që gjenden ata. Nga ana e tij, imami Nuhi ef. Shaqiri, falënderoi



Myftiun Tërnavë për pritjen, si dhe e njohu atë me aktivitetet dhe gjendjen e mërgatës sonë në Bruksel. Ai tha se si imam i xhamisë “Besimi” mbetet i përkushtuar që edhe më tej të vazhdojë bashkëpunimi i mirë ndërmjet tyre dhe BIK-ut.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TAKIMIN E NËNTË TË LIDERËVE ISLAMË BALLKANIKË QË U MBAJT NË BULLGARI

Më 26 nëntor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeimami, Vedat ef. Sahiti, zv.kryeimami, Fatmir ef. Iljazi dhe asistenti i kabinetit, Besir Neziri, morën pjesë në takimin e krerëve të bashkësive islame të Ballkanit, i cili u mbajt në qytetin Varna të Bullgarisë.

Myftiu Tërnavë në kumtesën e tij me titull “Kontributi i Bashkësisë Islame të Kosovës për paqe dhe siguri për të gjithë” mes të tjerash theksoi se liderët dhe ulemaja jonë fetare kanë luajtur rol të rëndësishëm në edukimin dhe fisnikërimin shpirtëror të popullatës tonë, ndërsa institucionet tona fetare historikisht ishin bartëse dhe promovuese të vlerave humane, siç janë: toleranca, mirëkuptimi, bashkëjetesa dhe harmonia ndërfetare e ndëretnike.



Në këtë takim morën pjesë liderët fetarë nga Turqia, Bullgaria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Sllovenia.

Në fund të takimit u miratua deklarata e përbashkët tetë pikëshe, ku liderët fetarë ftuan për paqe dhe siguri në botë.

Kurse, të nesërmen, Myftiu Naim ef. Tërnavë, bashkë me kryetarin e Dijanetit të Turqisë, dr. Ali ef. Erbash dhe me krerët e bashkësive islame të Ballkanit, kanë vizituar Myftininë e qytetit Shumen të Bullgarisë.

Ata u njohën për së afërmi me historikun, punën dhe angazhimin e kësaj Myftinie.

Më pas, ata vazhduan vizitën në xhaminë "Sherif Halil Pasha" dhe në Medresenë e Mesme "Nuvvab" të Shumenit, ku edhe morën pjesë në programin kulturor me rastin e shënimit të 100-vjetorit të themelimit të kësaj Medreseje.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË PRITJEN SHTETËRORE NGA PRESIDENTI I SHQIPËRISË, Z. BAJRAM BEGAJ

Me rastin e "28 Nëntorit", Festës së Flamurit, dhe 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në pritjen shtetërore, i cili u mbajt në Pallatin e Brigadave në Tiranë, organizuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i kishte ftuar në interes të kombit dhe të ardhmes, të gjithë aktorët politikë e institucionalë, liderët fetarë të trojeve shqiptare, shoqërinë civile e mediat, duke bërë thirrje që t'i përkushtohemi vizionit për Shqipërinë e gjeneratës tjetër, vendin e projektuar për të qenë anëtare në Bashkimin Evropian.



DEPARTAMENTI I GRUAS I BIK-UT ORGANIZOI TRIBUNË PËR SENSIBILIZIMIN DHE NDËRGJEGJËSIMIN MBI KANCERIN E GJIRIT

Më 1 nëntor 2022, Departamenti i Gruas që funksionon në kuadër të BIK-ut, ka përmbyllur me një tribunë aktivitetet e saj për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin mbi kancerin e gjirit. Të pranishmeve me një fjalë rasti iu drejtua udhëheqësja e DG-së, znj. Vaxhide Bunajku, e cila mes të tjerash tha: "Rruga drejt shëndetit është krejtësisht individuale dhe jo vetëm, për të duhet të kujdesemi në çdo formë dhe në çdo situatë". Më pas dr. Ilir Kurtishi, onkolog, foli në detaje për simptomat, shkaqet, parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundje. Në këtë tribunë po ashtu u ritheksua rëndësia e shëndetit mendor në ballafaqim me kancerin e gjirit në një ligjëratë nga psikologja, Gyltene Derguti. Kurse për ruajtjen e shëndetit në përgjithësi nga aspekti



fetare ligjëroi dr. Florentina Tërmmkolli. Në Kosovë çdo vit zbulohen rreth 400 raste të reja me kancer të gjirit.

KUZHINAT HUMANITARE POPULLORE NË MITROVICË DHE PEJË USHQEJNË ÇDO DITË NGA 500 PERSONA

Shoqata Humanitare Bamiressë “Bereqeti”, përmes kuzhinave popullore në Mitrovicë dhe në Pejë, ushqen në baza ditore mbi 500 qytetarë të vendit me kushte jo të favorshme ekonomike.

Kuzhinat humanitare popullore në këto dy qytete për çdo ditë me dashuri dhe vullnetin më të mirë përkujdesen që të servojnë ushqimet e llojllojshme për qytetarët që kanë nevojë për ushqim, duke ua servuar të gatshëm, por edhe duke ua mundësuar t’ua dërgojnë personave të tjerë të familjes.

Që nga viti 2013, kuzhina humanitare popullore në Mitrovicë, funksionon në kuadër të Këshillit të Bashkësisë Islame të këtij qyteti, e cila përmes donatorëve të ndryshëm dhe bizneseve lokale arrin që të jetë pranë këtyre qytetarëve.

250 persona për çdo ditë shërbehen me ushqim të gatshëm nga kuzhinierët e kësaj kuzhine në Mitrovicë, e cila gjendet në qendër të qytetit.

Kurse, që nga viti 2016, ekziston edhe kuzhina e ngjashme humanitare popullore në qytetin e Pejës, e cila së fundmi është bërë edhe me objekt të ri, duke i plotësuar të gjitha kushtet për funksionim.

Kjo kuzhinë ushqen për çdo ditë nga 300 persona, të cilëve u mundësohet të ushqehen në objektin e kësaj kuzhine, por edhe duke marrë ushqimin me vete për personat e tjerë.

Kuzhina e cila përkujdeset për një numër të konsideruar të personave me kushte jo të mira ekonomike, funksionon në kuadër të Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë, e që mbijeton



falë bamirësve dhe bizneseve lokale që duan të mbajnë në këmbë këtë vepër humanitare.

Shoqata Humanitare “Bereqeti” që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, synon që të rrisë numrin e personave që mund të ushqehen në këto kuzhina, por njëkohësisht është e angazhuar edhe në krijimin e kuzhinave të tilla në qytete të tjera të Kosovës.

Kuzhinat e tilla janë mirëseardhura për familjet me kushte të rënda ekonomike, duke u siguruar ushqim atyre, por edhe duke ua servuar të gatshëm për ta. “Bereqeti” së bashku me donatorët synon që asnjë prej qytetarëve të Kosovës të mos mbetet i uritur dhe të ketë shqetësimin ushqimin.

PËRFUNDON PUNIMET FORUMI PËR DIALOG I BAHREJNIT: “LINDJA DHE PERËNDIMI PËR BASHKËJETESËN NJERËZORE”

Më 4 nëntor 2022, me prezencën e mbretit të Bahrejnit, Hamad bin Isa al Khalifa, Shejhul Al-Az’harit, Ahmed al-Tajib dhe Papa Françeskut, përfundoi punimet Forumi i Bahrejnit. Mbreti i Bahrejnit, z. Khalifa, tha se Papa Françesku dhe Shejhul Al-Az’har, Ahmed Al-Tayeb, punuan për të pasuruar Forumin e Bahrejnit, duke theksuar rolin e udhëheqësve fetarë në adresimin e sfidave me të cilat përballen shoqëritë. Ai theksoi rolin ndikues të liderëve fetarë.

Më pas, fjalën e mori Shejh Al-Az’har, Ahmed al-Tajib. Ai tha se nuk ka nevojë të përsëriten rastet e luftës që po përjeton njerëzimi sot në Lindje dhe Perëndim, dhe se mungesa e drejtësisë ndërkombëtare, të cilën Krijuesi e vendosi ligj është kyç për stabilitetin e shoqërive dhe arritjen e ekuilibrit njerëzor si trup dhe shpirt në këtë Tokë.

Pas tij fjalën e mori Papa Françesku, ku mes të tjerash tha: “Disa njerëz me ndikim po bëjnë një luftë për interesat e tyre private, duke ringjallur gjuhët e lashta dhe duke rivizituar sferat e ndikimit dhe blloqet kundërshtarë. Për fat të keq, Lindja dhe Perëndimi janë gjithnjë e më shumë si dy dete



antagoniste, por ne jemi këtu së bashku sepse jemi të vendosur të lundrojmë në të njëjtin det dhe zgjedhja jonë është rruga e takimit në vend të shtegut të konfrontimit, dhe rruga të dialogut të cilit i referohet ky forum.”

Në emër të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavës, në këtë forum mori pjesë shefi kabinetit, mr. Besim ef. Mehmeti.

NË ABU DHABI U MBAJT “FORUMI I ABU DHABIT PËR PROMOVIMIN E PAQES”

Më 8 nëntor 2022, në Abu Dhabi, kryeqytetin e Emirateve, zhvilloi punimet “Forum i Abu Dhabit për promovimin e paqes, sesioni i nëntë”. Ky forum organizohet nën patronatin e Qeverisë së Emirateve, përkatësisht MPJ-së dhe zgjat 3 ditë. Këtë vit temë boshte ka “Konflikti i globalizuar dhe paqja universale – kërkesat dhe partneritetet”. Forumi u hap me lexim të Kuranit, për të vazhduar me fjalën hapëse të Nehjan bin Mubarak al Nahjanit, ministër i Tolerancës në EBA. Ai u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve, duke theksuar përkushtimin e qeverisë së EBA-së për manifestim të përhapjes së tolerancës. Ai theksoi se shoqëritë tolerante janë shoqëri përparimtare, në të cilat të gjithë njerëzit jetojnë në paqe dhe respekt të ndërsjellë, gjë që reflektohet në jetesën më të mire për gjithë qytetaret e atij vendi.

Dijetari i mirënjohur i botës islame, Abdullah bin Bejja, njëherësh kryetar i Forumit dhe kryetar i Këshillit të Fetvasë së EBA-së gjatë fjalimit të tij u fokusua në obligimin e përqendrimit dhe forcimit të paqes, duke luftuar çdo lloj të konflikti dhe luftës.

Në hapje folën edhe sekretari gjeneral i Ligës së Botës Islame, dr. Abdulkerim



al Isa, cili ftoi të pranishmit për aktivizim më intensiv në promovimin e paqes, duke cekur si një nga iniciativat më të reja, atë të fundit R20, e themeluar ne qytetin Bali të Indonezisë para disa ditëve nën ombrellën e shteteve të G20. Gjatë këtyre ditëve Forumi do të diskutojë rreth temave të shumta të cilat kanë për qëllim përforcimin e paqes globale dhe shuarjen e konflikteve, si dhe analizën e faktorëve që kërcënojnë paqen si dhe luftimin e islamofobisë në vende të ndryshme të botës. Në këtë sesion të pranishmëve ju drejtua edhe sekretari i OBI-së, ambasadori Husein Ibrahim Taha, ambasadori Rashad

Husein, ambasadori i Përgjithshëm për Lirinë Fetare në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara, si dhe rabini Ephraim Mirvis, kryerabini i Kongregacioneve të Bashkuara Hebraike të Komonuelthit. Në këtë forum po marrin pjesë përfaqësues dhe lider të feve abrahamike të shumë shteteve nga e mbarë bota, duke përfshirë ministra, myftinj, udhëheqës të bashkësive islame, ulema, kardinalë, ipeshkëv dhe priftërinj, kurse nga Kosova morën pjesë përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, dr. Islam Hasani, dekan i FSI-së dhe mr. Besim Mehmeti, shef i kabineti të Myftiut të Kosovës.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI

Prishtinë, 15 nëntor 2022

Me dhembje të madhe mësuam lajmin për shpërthimin në rrugën Istiklal të Stambollit, në të cilin humbën jetën 6 persona dhe u plagosën 53 të tjerë.

Zoti i mëshiroftë të vdekurit, ndërsa familjarëve të tyre u shprehim ngushëllimet më të sinqerta, duke lutur Zotin që t'ua lehtësojë dhembjen, ndërsa të plagosurve u urojmë shërim sa më të shpejtë.

Jemi pranë dhe solidarizohemi me popullin vëlla turk.

Zoti qoftë me ju!

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Terëna



FILLOI PUNIMET TRAJNIMI PËR PROGRAMIN E RI ME ARKËTARËT E ADMINISTRATËS SË BIK-UT

Më 15 nëntor 2022, në kuadër të modernizimit të administratës së Bashkësisë Islame të Kosovës, Drejtoria e Financave të BIK-ut, ka filluar trajnimin me arkëtarët e këshillave të Bashkësisë Islame dhe të institucioneve të saj për programin e ri të centralizuar, i cili do të fillojë të aplikohet nga fillimi i vitit 2023. Ky trajnim do të udhëhiqet nga drejtori i Drejtorisë së Financave, z. Tanseli Rogova, së bashku me Petrit Morinën, dhe konsulentët profesionalë të fushës së kontabilitetit dhe financave. Pjesë e këtij trajnimi do të jenë arkëtarët e këshillave të BI-së, Medresesë, FSI-së dhe konviktit të vajzave. Në hapje të këtij trajnimi që i pranishëm edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përgëzoi Drejtorinë Financiare për punët dhe



aktivitetet që po i zhvillon për mbare-vajtjen dhe modernizimin e programeve që kanë të bëjnë me aspektin financiar, duke premtuar kështu përkrahje të vazhdueshme, me

qëllim të ngritjes dhe zhvillimit në këtë aspekt. Ky trajnim vazhdoi edhe në dy seanca të tjera, më 17 dhe 22 nëntor si dhe një i tillë do të mbahet edhe në muajin dhjetor. (R.S.)

NDËRROI JETË IMAMI NGA PRIZRENI, BEHLUL EF. HOXHA (1964-2022)

Behlul ef. Hoxha lindi më 22.06.1964, në Prizren, nga babë Abdyrrahimi dhe nënë Ylkija. Shkollën fillore e mbaroi në 'Mustafa Baku', në Prizren, në vitin 1979. Shkollën e mesme e mbaroi në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë, në vitin 1984. Ndërsa, studimet universitare i mbaroi në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, ku diplomoi më 06.06.2013.

Prej fillimit të karrierës së tij, mulla Behluli ishte punëtor i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe krejt ymrin ia dedikoi popullit, xhamisë, fesë e atdheut.

Ai shërbeu në detyrën e imamit, hatibit dhe mualimit në xhaminë 'Mahmud Pasha', në Prizren, gjatë viteve 1983-1984, kurse prej vitit 1984 transferohet në të njëjtën detyrë në xhaminë e fshatit Vlashne. Me një ndërprerje njëvjeçare (15.06.1987 – 15.06.1988), për shkak të shërbimit ushtarak, mulla Behluli shërbeu në këtë detyrë deri në ditën kur ndërroi jetë.

Mulla Behluli për më se katër dekada kontribuoi në vetëdijësimin fetar të xhematit, përfshirë talebet e mektebit. Ka qenë ndër njerëzit më të respektueshëm dhe si i tillë ishte mik i secilës familje në Vlashne, Kobajë e Murademë.

U varros më 09.11.2022 në varrezat e qytetit të Prizrenit, me nderime të larta fetare e qytetare, me një pjesëmarrje të madhe të shumë besimtarëve e personaliteteve publike, nga të gjitha trojet shqiptare.

Namazin e xhenazës ia fali anëtar i Kryesisë së BIK-ut, Reshat ef. Mexhiti.

Behlul ef. Hoxha, ka lënë bashkëshorten, dy djemë e një vajzë, si dhe shumë nipër e mbesa.

Allahu e mëshiroftë dhe e gradoftë me Xhenetin Firdevs, në shoqëri me pejgamberët e Zotit, të sinqertët, shëhidët dhe të mirët, sa shoqëri e mirë janë ata! (Orhan Bislimaj)



PROMOVHET BOTIMI I PËRKTHIMIT TË KURANIT NË SHQIP NGA FATON OSMANI

Më 23 nëntor 2022, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në ambientet e saj ka promovuar përkthimin e Kuranit nga publicisti dhe diplomati, Faton Osmani, i cili e ka përkthyer Kuranin në gjuhën shqipe nga versioni i përkthyesit të spikatur në gjuhën angleze, Marmaduke Pitckthall. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përgëzoi për punën Faton Osmanin, duke thënë se po e rendit emrin e tij në mesin e përkthyesve të Kuranit. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës ka qenë, është dhe do të jetë e përkushtuar në përkrahjen e iniciativave të tilla që kanë për qëllim përhapjen e Islamit. Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora, vlerësoi lart përkthimin e Faton Osmanit, duke thënë se këtë përkthim në gjuhën shqipe të Kuranit e ka bërë të veçantë ruajtja e rimave, aq sa i është dhënë



mundësia. Përkthimin e Faton Osmanit e vlerësoi lart edhe studiuesi i letërsisë, Besnik Jaha, i cili foli për vlerat e larta letrare dhe estetike të tij. Ndërsa, përkthyesi, Faton Osmani, për punën e tij 12-vjeçare në përkthimin e Kuranit, tha se ka përdorur edhe përkthime të tjera, duke përfshirë këtu edhe përkthimet në gjuhën shqipe. Përkthimi i Pikallit i realizuar në vitet e 30-ta

konsiderohet si njëri ndër përkthimet më të mira në gjuhën angleze. Këtë përkthim asokohe e kishte miratuar me vendim të posaçëm një komision i profesorëve të universitetit të Az'harit. Kurani në gjuhën shqipe për herë të parë u përkthye nga akademiku Feti Mehdiu, dhe u botua në vitin 1985, e më pas vijuan edhe përkthimet e Mulla Sherif Ahmetit dhe Hasan Nahit.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 24 nëntor 2022, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Myftiu Tërnavë në hapje të kësaj mbledhje fillimisht falënderoi Zotin e Madhëruar për mirësitë e shumta që na i ka dhuruar, e më pas falënderoi edhe anëtarët e Kryesisë dhe të gjithë punëtorët e BIK-ut për kontributin që janë duke dhënë në ngritjen e fjalës së Zotit xh.sh.. Kryesia e BI-së në këtë mbledhje, në rendin e ditës diskutoi për përgatitjet për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të BI-së së Kosovës, pastaj aprovimin e projekt-buxhetit të këshillave të BI-së dhe të Kryesisë për vitin 2023, si dhe shqyrtoi lëndë të ndryshme dhe mori vendime në bazë të kompetencave që i takojnë.



SEKRETARI I KRYESISË SË BIK-UT, AHMET EF. SADRIU PRITI NJË DELEGACION NGA EBA

Më 25 nëntor 2022, sekretari i BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, priti një delegacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe, të kryesuar nga dr. Halid al Haxheh, sekretar gjeneral i organizatës "International Charity Organization" nga EBA me seli në Agjman, si dhe drejtorin e zyrës për Kosovë, z. Naser Gashin. Sekretari Sadriu, falënderoi mysafirët për ndihmën e Qeverisë së EBA-së që i ka ofruar Kosovës para dhe pas luftës, si dhe i njohu mysafirët me aktivitetet dhe punën e BIK-ut.

Nga ana e tij, dr. Al Haxheh, premtoi vazhdimin e përkrahjes së BIK-ut në projekte të ndryshme. Ai theksoi se jemi ndarë shumë të kënaqur me rezultatet dhe zhvillimin e arritur nga ju që nga paslufta. Delegacioni po qëndron në vizitë treditore në Kosovë me ç'rast kanë pasur rastin të vizitojnë disa komuna gjithandej Kosovës.



Xhelozia e shejtanit

Shëtiti shejtani në "rrugicat" e djallëzisë,
me dinakëri i vendos kurthe njerëzisë,
ai asht betu se kurrë s'do të pushojë,
me të gjitha format njeriun ta mashtrojë.

Për t'ia arrit kësaj, punon ditë e natë,
me "mjeshtërinë" e tij që e ka zanat.
Turma njerëzish për nga ai shtrijnë hapin,
"Likes" të panumërta atij i japin.

Me gjithë këtë arritje s'ngopet shejtani,
bahet xheloz se po ia kalon 'insani'.
E thotë me vete shejtani dinak,
se djallëzitë e njeriut po i hyjnë në 'hak'.

Njeriu djallëzor përpara po ecë,
ustai i tij një hap mbrapa ngeç.

E kjo shejtanit aspak s'i pëlqen,
e pyet me habi: "Njeriu kta ...ku i gjenë?!"
A thu nga rruga ime ka deviju,
që mu si 'usta' më ka anashkalu."

Në punë djallëzore i ligu ka ecuri,
për këtë arritje djalli ka zili.

Për prishjen e moralit s'kursehet i ligu,
çdo gja e mirë nga bota e tij iku.
I duket shejtanit se mbrapa ka mbet,
ndonji metodë të re mundohet me gjet.

E mendja djallëzore shpeshherë i thotë:
"Me njeriun e lig nuk ia del dot,
nëse donë që puna me të shku mbarë,
nga "insani" i tillë 'kurse' me marrë!"

Të gjitha këto, shejtani i mendon,
"ortakut" të tij suksese i uron!
Se punë të tilla që njeriu i ban,
kanë vetëm një "logo" që i thonë: shejtan.

E për atë që dy pikë mend i kanë mbet,
t'i përdorë si duhet sa nuk i kanë tretë,
për ruajtjen e mirësisë në gara le të jetë!

Burhan Fili

Morali

Pahitet morali,
Si varka që lëkundet
Nga valët e trazuara të detit.

Të këqijat ngjiten
Në varg luleshtrydesh.

Mëkatet trashen e fryhen,
Sikur flluskë sapuni,
Deri në aktin pëlçitës.

Pendimi humb diku
Shtigjeve të pashkelura
Të shpirtit.

Pastaj...
Morali hidhet
Në fyt të xingonës së errët.

Bilall Maliqi, Preshevë



BOTIME TË REJA

Shtëpia botuese "Dituria Islame" sapo ka nxjerr në qarkullim botimet e saj më të reja:

1. VEHBI S. GAVOÇI, "NYJA E BESIMIT, SIPAS TAHAVIUT"
2. IMAM VEHBI ISMAILI, "MUHAMEDI A.S. - PROFETI ISLAM"
3. RESUL EF. REXHEPI, "TEMA ISLAME - 2"
4. ISA TËRSHANI, "NGA MINBERI I XHUMASË (HYTBE)"

Botimet mund t'i siguron në librarinë "Dituria Islame" në Prishtinë (rruga Bajram Kelmendi nr. 182. në selinë e Kryesisë së BI-së së Kosovës).

